



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



Tema

DREJTIMET KRYESORE TË HUAZIMEVE TË SOTME NË GJUHËN SHQIPE

**(VENDI I TYRE NË FJALORËT E VITEVE
1954, 1980, 2002 DHE 2006)**



PUNOI:
Ma. sc. Shpresa DORDA

UDHËHOQI:
Prof. Dr. Shezai RROKAJ

TIRANË 2015



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



DREJTIMET KRYESORE TË HUAZIMEVE TË SOTME NË GJUHËN SHQIPE

*(VENDI I TYRE NË FJALORËT E
VITEVE 1954, 1980, 2002 DHE 2006)*

PUNOI:

Ma. sc. Shpresa DORDA

UDHËHOQI

Prof. dr. Shezai RROKAJ

TIRANË 2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE



DOKTORATË

Përgatitur nga: Ma.sc. Shpresa DORDA

Për marrjen e gradës shkencore: “DOKTOR”

Specialiteti: GJUHËSI

Fusha e veçantë: LEKSIKOLOGJI

Titulli: Drejtimet kryesore të huazimeve të sotme në gjuhën shqipe

(Vendi i tyre në fjalorët e viteve 1954, 1980, 2002 dhe 2006)

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Shezai RROKAJ

Mbrohet në dt. ____ . ____ . 2015 përpara jurisë së përbërë nga:

1. _____ Kryetar
2. _____ Anëtar
3. _____ Anëtar (oponent)
4. _____ Anëtar (oponent)
5. _____ Anëtar

Tiranë, 2015

Përmbajtja

Falenderime	9
HYRJE	10
KREU I	14
1.1 Mendimet e gjuhëtarëve për konceptin e huazimit	14
1.2 Huazimi si dukuri gjuhësore	14
1.3 Shqipja dhe gjuhët në kontakt	16
1.4 Ndikimi i historisë në gjuhë	17
1.5 Faktorët që ndikojnë në futjen e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe të sotme	17
1.5.1 Globalizmi	17
1.5.2 Emigrimi	18
1.5.3. Arsimimi jashtë vendit	18
1.5.4 Politika e shkollimit dhe punësimit	18
1.5.5 Folësi dygjuhësh midis dygjuhësisë dhe diglossisë	19
1.5.6 Martesat e përziera	19
1.6 Gjuha shqipe ka huazuar dhe po huazon fjalë të huaja	20
1.7 Pasojat që kanë huazimet në komunikim	21
1.8 Rrugët e futjes së huazimeve në shqipe	22
1.9 Huazimi në këndvështrimin sociolinguistik	23
1.9.1 Arsyet e përdorimit të huazimeve nga shqipfolësit	24
KREU II	
2.1 Huazime të hershme në periudhën antike	25
2.1.1 Grupimi i fjalëve të huaja në periudhën antike	25
2.1.2 Huazime nga greqishtja e vjetër	25
2.1.3 Fjalët nga latinishtja	26
2.1.4 Huazime në tekstet e vjetra të gjuhës shqipe	27
2.2 Huazime gjatë periudhës së Rilindjes deri në vitet '90	27
2.2.1 Parashtesat dhe prapashtesa nga gjuhët romane	28
2.2.2 Huazimet sllave në gjuhën shqipe	28
2.2.3 Parashtesat e sllavishtes në gjuhën shqipe	28
2.2.4 Huazime nga turqishtja	29
2.2.5 Parapashtesa me burim nga turqishtja	29
2.2.6 Huazime nga greqishtja	29
2.2.7 Huazime nga italishtja	30
2.2.8 Huazimet nga frëngjishtja	30

2.3	Huazimet në gjuhën shqipe pas viteve '90	30
2.3.1	Huazime sllave	31
2.3.2	Huazime turke	31
2.3.3	Huazime nga anglishtja	31
2.3.4	Huazime nga italishtja	32
2.3.5	Huazime nga greqishtja e re	32
2.3.6	Huazime nga frëngjishtja	33
2.4.	Ndërkombëtarizma	33
2.4.1	Terma ndërkombëtarë nga burimi grek	33
2.4.2	Terma ndërkombëtarë me një element grek e një latin	33
2.4.3	Terma ndërkombëtarë nga burimi roman	33
2.4.4	Terma ndërkombëtarë nga burimi anglez	33
KREU III		
3.1	Rëndësia e pastërtisë së gjuhës shqipe	34
3.2	Mendimet e intelektualëve shqiptarë për huazimet ndër vite	35
3.2.1	Mendimet e poetëve shqiptarë për huazimet të shprehura në vargje	35
3.2.2	Mendimet e disa gjuhëtarëve shqiptarë për pastërtinë e shqipes	37
3.3	Zëvendësimi i fjalëve të huaja të panevojshme në shqipe	38
3.3.1	Llojet e shqipërimit të huazimeve dhe kriteret që duhen zbatuar	39
3.4	Qëndrimet kryesore të studiuesve kundrejt huazimeve	40
3.5	Si t'i parandalojmë fjalët e huaja të panevojshme	41
KREU IV		
4.	Shqipja përballë huazimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni	43
4.1	Gjendja e gjuhës shqipe dhe huazimet në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni	43
4.2	Shembuj huazimesh të panevojshme nga gazetat e tri vendeve	44
4.3	Mënyrat e depërtimit të huazimeve në shqipen e tri vendeve	47
KREU V		
5.	Shqipfolësit mes fjalës së huaj dhe shqipe	49
5.1	Pyetëtori	49
5.2	Analiza e rezultateve të pyetëtorit	50
5.2.1	Ku i hasim më shpesh fjalët e huazuara	50
5.2.2	Sa arrijnë t'i kuptojnë fjalët e huaja shqipfolësit?	51
5.2.3.	Sa kanë arritur t'u gjejnë gje gjëset në shqipe huazimeve?	52
5.2.4	Fjalët më pak të njohura nga të intervistuarit	52
5.3	Çfarë duhet të bëjmë sipas përfundimeve që nxjerrim nga pyetëtori	52

KREU VI

6. Disa fusha ku kanë depërtuar huazimet	54
6.1 Terminologjia administrativo-juridike	54
6.2 Terminologjia gjuhësore	60
6.3 Terminologjia e kulinarisë	60
6.4 Terminologjia sportive	63
6.5 Terminologjia informatike	65
6.6 Terminologjia ekonomike	68
6.7 Ndërtime të huaja në antroponime	71
6.8 Ndërtime të huaja tek emërtimet në radio dhe televizione	71
6.9 Libra në shqip të titulluar me fjalë në gjuhë të huaj	71

KREU VII

7.1 Llojet e huazimeve	72
7.2 Huazimi brenda sistemit të shqipes	74
7.3 Zhvillimi i huazimeve në shqipe	75
7.4 Rrafshet gjuhësore ku kanë depërtuar huazimet	76
7.4.1 Depërtime të trajtës së huaj në rrafshin morfologjik	77
7.4.2 Depërtime të strukturës së huaj në rrafshin sintaksor	79
7.4.3 Depërtime të fjalës së huaj në rrafshin leksikor	80
7.4.4 Depërtim të prapashtesave të huaja në fjalëformim	80
7.4.5 Depërtime të trajtës së huaj në terminologji	80
7.4.6 Depërtime të strukturës së huaj në frazeologji	81

KREU VIII

8. Fjala e huaj në këndvështrimin e medias së shkruar	82
8.1 Fjalë të huaja në gazetën “Tema”, 18-25 qershor 2000	82
8.2 Fjalë të huaja në gazetën “Tema”, 23 qershor 2011	83
8.3 Fjalë të huaja në gazetën “Shqip”, 25 qershor 2006	85
8.4 Fjalë të huaja në gazetën “Shqip”, 25 qershor 2011	87
8.5 Përfundimet nga vëzhgimi i gazetave	89

KREU IX

9. Krahasimi i fjalësit të huaj nëpërmjet fjalorëve të viteve 1954, 1980, 2002 dhe 2006	90
9.1 Fjalët e huazuara në gjuhën shqipe sipas reflektimit në fjalorët e viteve 1954, 1980, 2002 dhe 2006	141
9.1.1 Fjalë të cilat ndodhen në të katër fjalorët	141
9.1.1.1 Fjalë të cilat ndodhen në të katër fjalorët dhe kanë krijuar çerdhe fjalësh	141

9.1.1.2 Fjalë të cilat ndodhen në të katër fjalorët dhe nuk kanë krijuar çerdhe fjalësh	142
9.1.2 Fjalë të cilat nuk ndodhen tek asnjëri nga fjalorët	142
9.1.2.1 Fjalë të cilat nuk ndodhen në asnjë nga fjalorët dhe kanë krijuar çerdhe fjalësh	142
9.1.2.2. Fjalë të cilat nuk ndodhen në asnjë nga fjalorët dhe nuk kanë krijuar çerdhe fjalësh	142
9.1.3 Fjalë të cilat nuk ndodhen në fjalorin e vitit 1954, por janë në tre fjalorët e tjerë	142
9.1.4. Fjalë të cilat nuk ndodhen në fjalorët e viteve 1954, 1980 dhe 2002, por ndodhen vetëm në fjalorin e vitit 2006	143
9.1.5 Fjalë të cilat ndodhen në fjalorin e vitit 1954 dhe 2006, kurse në fjalorët e viteve 1980 dhe 2002 jo	143
9.1.6 Fjalë të cilat janë të përfshira në fjalorin e vitit 1954, por jo në tre fjalorët e tjerë	143
9.1.7 Fjalë të cilat nuk ndodhen tek fjalorët e viteve 1954, 1980, por gjenden tek fjalorët e viteve 2002, 2006	143
9.1.8. Fjalë të cilat ndodhen tek fjalorët e viteve 1954, 1980, por nuk gjenden tek fjalorët e viteve 2002, 2006	144
9.1.9 Fjalë të cilat nuk kanë një zhvillim të rregull duke u bazuar nga mënyra se në cilin fjalor janë vendosur e në cilin jo	144
9.1.10. Fjalë të cilat ka ndryshim të një tingulli nga pasqyrimi në fjalorin e vitit 1954 dhe në fjalorin e vitit 2006	145
9.1.11 Fjalë të cilat kanë të njëjtën formë, por u ndryshon kuptimi nga një fjalor në tjetrin	145
9.1.12 Fjalë të cilat kanë shtuar çerdhen e fjalës ose e kanë pakësuar atë	146
9.1.13 Fjalë të cilat u ka ndryshuar numri i kuptimeve nga njëri fjalor tek tjetri	147
9.1.14 Fjalë të cilat janë reflektuar ndryshe në fjalorë të ndryshëm	147
9.2 Shqyrtimi i fjalëve të huazuara sipas mënyrës së ndërtimit	147
9.2.1 Huazime të ndërtuara me parashtesë shqipe dhe temë të huaj	147
9.2.2 Huazime të ndërtuara me një temë shqipe dhe një temë në gjuhë të huaj	147
9.2.3 Huazime të ndërtuara me dy tema në gjuhë të huaj	147
9.2.4 Huazime të ndërtuara më parashtesë dhe një temë në gjuhë të huaj	147
9.3 Fjalë të huazuara sipas mënyrës së zëvendësimit me fjalë të gjuhës shqipe	148
9.3.1 Fjalë të huazuara të cilat zëvendësohen plotësisht me fjalë shqipe	148
9.3.2 Fjalë të huazuara të cilat zëvendësohen pjesërisht ose jo në të gjitha kuptimet me fjalë shqipe	148

PËRFUNDIMET	149
SHTOJCË 1	155
1. 1 Pamje të përballjes së gjuhës shqipe me gjuhën e huaj në një rrugë të qytetit të Tiranës	155
1.1.1 Mjedise të emërtuara në shqip dhe gjuhë të huaj	155
1.1.2 Mjedise të emërtuara në shqip	161
1.1.3 Mjedis i emërtuar në tri mënyra	161
1.1.4 Mjedise të emërtuara në gjuhë të huaj	162
SHTOJCË 2: Pyetësor	167
BIBLIOGRAFIA	171
LITERATURA E VJELJES SË HUAZIMEVE	175

Falenderime

Për realizimin e kësaj teme doktorale dua të falënderoj udhëheqësin tim, prof. dr. Shezai Rrokaj, i cili pranoi të më drejtonte dhe më ndihmoi për strukturimin e temës. I jam mirënjohëse për sugjerimet që më ka dhënë për çështje të ndryshme dhe mënyrën e këndvështrimit të tyre, literaturën e pasur që më ka nxitur ta përdor, më ka siguruar, si dhe shpjegimin e paqartësive e pyetjeve të cilat më lindën gjatë punimit të temës. Puna dhe mbështetja e tij e pakursyer ka qenë gjithmonë e pranishme edhe në temat me të cilat jam prezantuar nëpër konferenca e seminare, edhe në ato momente ku hasa vështirësi në vazhdimin apo përfundimin e punimit.

Dëshiroj të falënderoj dhe familjen time, të cilës i kam munguar me shërbimet e mia si zonjë shtëpie, nënë e bashkëshorte gjatë pjesëmarrjeve nëpër konferenca apo kohën e gjatë që më ka marrë hulumtimi i literaturës dhe shkrimi i gjithë temës.

HYRJE

Gjuha shqipe në formësimin e saj të tanishëm është kushtëzuar si nga faktorët historikë, shoqërorë, ekonomikë, politikë, ashtu dhe nga faktorët e brendshëm të zhvillimit të saj. Një kahje e rëndësishme e zhvillimit të gjuhës është përballja me huazimet, ku ato herë kanë përfituar nga ky pasurim i ndërsjellë mes gjuhësh në kontakt, e herë janë mbivendosur fjalëve e pasojat janë të dukshme në rrjedhën e zhvillimit të gjuhës pritëse. Edhe gjuha shqipe ka një qasje të ngjashme. Marrëdhënia e saj me gjuhë fqinje e jo vetëm me to, kanë bërë që fytyra e saj të jetë rezultat dhe pasqyrë e kësaj dukurie.

Qëllimi i punimit është të japë një trajtim sa më gjithëpërfshirës të huazimeve të sotme në gjuhën shqipe, duke bërë një përmbledhje sa më të plotë të huazimeve të viteve të fundit, por edhe një historik të shkurtër të huazimeve që nga koha kur daton e shkruar gjuha shqipe.

Objekt studimi i kësaj teme janë huazimet e futura në gjuhën shqipe pas viteve '90, duke parë edhe zhvillimin që ato kanë pësuar me kalimin e viteve, cilat prej këtyre huazimeve kanë krijuar çerdhe fjalësh, cilat nuk janë zhvilluar më tej, cilat janë futur të reja e cilat janë rikthyer në gjuhë pas disa dekadash të shmangura. Nga ana tjetër kemi vënë në dukje gjuhët dhënëse të fjalëve të huaja, që kanë depërtuar më shumë, si ka reaguar gjuha shqipe ndaj tyre, cilët faktorë favorizojnë shtimin e fjalëve të huaja në shqipe dhe rrugët që mund të ndjekim për t'i minimizuar prurjet e reja dhe zëvendësimin e huazimeve ekzistuese. Gjithashtu kemi studiuar rrugëtimin e një grupi huazimesh në gjuhën shqipe, përkatësisht 808 të tilla, duke vëzhguar si janë reflektuar në fjalorët e viteve 1954, 1980, 2000 dhe 2006.

Në punim kemi përdorur disa metodat si: hulumtimi i studimeve të mëparshme për huazimet, anketime, vëzhgime dhe interpretime. Jemi përpjekur të sjellim një pasqyrë sa më të qartë të huazimeve në gjuhën shqipe ku metoda mbizotëruese është ajo e hulumtimit dhe vjeljes së huazimeve, ndërsa një vend me rëndësi në trajtimin e kësaj teme ka zënë edhe metoda e anketimit/pyetësorit rreth shtrirjes dhe ndikimit të huazimeve në shqipe.

Procesin e vjeljes së huazimeve e kemi mbështetur:

- 1. Në gjuhën e shkruar, si p.sh gazetat dhe fjalorthë me fjalë të huaja të viteve të mëparshme.*
- 2. Gjuhën e folur, si p.sh bisedat e përditshme të shqipfolësve, kryesisht mes të rinjve, folësit e lajmeve, prezantuesit e emisioneve, debatet televizive apo radiofonike, dhe emërtimet e objekteve, dukurive që hasim në përditshmërinë tonë etj.*

Gjatë punimit, fjalët e huaja, kur janë dhënë si shembuj për të konkretizuar çfarë kemi thënë për çështje të ndryshme, nuk i kemi dalluar nëse janë huazime para viteve

'90 apo të mëvonshme, por i kemi parë si fjalë të huaja, të cilat përdoren së bashku me shqipen dhe efektin që ato përcjellin me këtë bashkëpërdorim. Ndërsa tek fjalësi me 808 fjalë të huaja kemi bërë dallimin se në cilat periudha është përdorur fjala, duke u mbështetur në fjalorët e cilave viteve është përfshirë e në cilët jo.

Punimin e kemi mbështetur në hulumtimet e mëparshme të studiuesve, të cilët i kanë parë huazimet në disa aspekte të veçanta, si: në planin historik, huazimet e ardhura vetëm nga njëra gjuhë, fjalë të huaja të futura në shqipe nga disa gjuhë dhe ku ndryshojnë nga njëra-tjetra, zhvillimi i huazimeve në gjuhën shqipe, reagimi i shqipes ndaj tyre, rrafshet gjuhësore ku kanë depërtuar, qëndrimet e gjuhëtarëve ndaj huazimeve etj. Disa nga studimet kryesore për huazimet që kemi përdorur në punim janë: Gjovalin Shkurtaj "Kultura e gjuhës" dhe "Shqipja e sotme", Emil Lafe "Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë" dhe "Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare", Vesel Nuhii "Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe", Jani Thomai "Për pastërtinë e fjalorit të gjuhës sonë letrare", Shezai Rrokaj "Çështje të gjuhës shqipe" dhe "Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme", Hajri Shehu "Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze" dhe "Rreth anglicizmave në mjetet e informimit masiv", Aleksandër Xhuvani "Për pastërtinë e gjuhës shqipe" dhe "Vepra I", Shaban Demiraj "A ka ndikime të huaja në strukturën morfologjike të shqipes" etj.

Në kreun e parë kemi trajtuar huazimin si dukuri gjuhësore, duke dhënë arsyet pse huazojnë gjuhët në përgjithësi dhe, në veçanti, pse ka huazuar dhe po huazon gjuha shqipe. Gjithashtu do të shtjellojmë faktorët, të cilët ndikojnë në këtë proces, si: emigrimi, arsimimi jashtë vendit i të rinjve, politika që po ndjek shteti për shkollim e punësim në Shqipëri, folësi dygjuhësh, globalizmi, martesat e përziera dhe pasojat që shkaktajnë këto huazime në komunikim. Huazimet i kemi parë edhe në këndvështrimin sociolinguistik, ku kemi shtjelluar arsyet se pse shqipfolësit parapëlqejnë të përdorin fjalët e huaja në vend të fjalëve shqipe.

Më pas në kreun e dytë kemi shtjelluar historikun e huazimeve duke listuar që nga huazimet e trashëguara nga ilirishtja si: huazimet e greqishtes së vjetër, latinishtes duke vazhduar me huazimet e periudhës së rilindjes si: huazimet nga sllavishtja, turqishtja, italishtja, frëngjishtja dhe tek huazimet pas viteve '90 që janë futur të reja apo vazhdojnë të përdoren që nga koha kur janë futur në shqipe, deri në ditët e sotme. Për secilën nëndarje e kemi konkretizuar duke dhënë shembuj fjalësh të huazuara.

Në kreun III kemi shtjelluar disa çështje, si: rëndësia e pastërtisë së gjuhës shqipe, cilat janë mendimet e gjuhëtarëve, poetëve shqiptarë për pastërtinë e saj, mënyrat e shqipërimit të huazimeve dhe cilat janë rrugët që mund të ndjekim për të ndaluar futjen e huazimeve të panevojshme në gjuhë.

Në kreun IV huazimet i kemi vëzhguar jo vetëm në shqipen e shkruar në Shqipëri, por një vështrim të shkurtër i kemi bërë edhe huazimeve të gjuhës shqipe në Kosovë dhe Maqedoni, duke parë ku kanë pikëtakime e ku dallojnë nga njëra-tjetra. Si material burimor kemi përdorur gazetën "Shqip" 14 qershor 2012 dhe gazetën "Panorama" 25

korrik 2012 në Shqipëri; gazetën “Bota sot” 15 qershor 2012 dhe gazetën “Express” 15 qershor 2012 në Kosovë; gazetën “Koha” 31 gusht 2012, “Zhurnal” 31 gusht 2012 dhe gazetën “Lajm” 31 gusht 2012 Maqedoni. Nga këto gazeta kemi marrë shembuj huazimesh të panevojshme të cilat i kemi dhënë në fjali, njëkohësisht dhe mënyrën e zëvendësimit të tyre me fjalë shqipe.

Në kreun V për të kuptuar se si e shikojnë apo e ndiejnë veten shqiptarët përballë huazimeve, sa i kuptojnë ato, a janë në gjendje t’u gjejnë gjegjëse në shqip dhe ku i hasin më shpesh, kemi hartuar një pyetësor me 100 fjalë të huaja, të vjela nga gazeta, emisionet televizive, radiofonike dhe bisedat e përditshme. Pyetësorin e plotësuan shqipfolës të moshave, zonave dhe arsimimeve të ndryshme, prej të cilit morëm një rezultat më të qartë rreth huazimeve aktuale në gjuhën shqipe.

Fjalët e huaja kanë depërtuar në shumë aspekte jetësore të shqiptarëve, të cilat i kemi trajtuar në kreun VI. Për ta konkretizuar kemi përzgjedhur terminologjinë e disa fushave, si: terminologjia administrative-juridike, terminologjia gjuhësore, e kulinarisë, e sportit, teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë. Shembujt e huazimeve që kemi marrë nga secila fushë i kemi dhënë në fjali për të marrë kontekstin ku përdoren, përveç terminologjisë gjuhësore, për të cilën nuk e pamë të arsyeshme t’i jepnim shembujt në fjali, meqë punimi është i kësaj fushe dhe vetëm termi është i mjaftueshëm. Tjetër dukuri që kemi paraqitur janë edhe emrat e njerëzve, emërtimet e emisioneve televizive apo emërtimet e televizioneve dhe radiove, të cilat shkruhen e shqiptohen në gjuhë të huaj.

Në kreun VII, sipas mënyrës së futjes në gjuhë dhe shtrirjes së tyre, huazimet i kemi klasifikuar në disa lloje, si: të drejtpërdrejta, të tërthorta, grafike, leksikore, ndërtime, të pjesshme, gojore, shkrimore, etj. Gjithashtu kemi trajtuar rastet kur fjalët apo ndërtimet e huaja kanë depërtuar në rrafshin morfologjik, leksikor, sintaksor, fjalëformim, terminologji dhe frazeologji.

Gjatë vëzhgimit të gazetave të përditshme, kemi vënë re se ato përmbajnë sasi të mëdha fjalësh të huaja. Për të kuptuar nëse këto fjalë po shtohem apo po pakësohem me kalimin e viteve, në kreun VIII kemi marrë dy të përditshme në mënyrë rastësore të viteve të fundit dhe të disa viteve më parë, përkatësisht gazetën “Tema” të viteve 2000, 2011 dhe gazetën “Shqip” të viteve 2006, 2011. Nga vëzhgimi i gazetave nxorëm të gjitha fjalët e huaja dhe përfundimet që nxorëm i kemi dhënë në mënyrë të përmbledhur në tabela e grafikë.

Me kalimin e kohës fjalët ndryshojnë në gjuhë, e huazimet nuk bëjnë përjashtim, prandaj në kreun IX për të parë se çfarë ndodh me fjalët e huaja, kur futen në gjuhë dhe rrugëtimin e tyre, kemi hulumtuar rreth 808 fjalë të huazuara si janë reflektuar në fjalorët e gjuhës shqipe të viteve 1954, 1980, 2002 dhe 2006. Ndër to janë disa fjalë të cilat janë zhvilluar më tej duke krijuar çerdhe fjalësh, disa të tjera kanë dalë nga përdorimi duke mos u përfshirë në fjalorët e viteve të mëvonshme dhe disa janë rikthyer

në përdorimin e përditshëm pas disa viteve. Nga mënyra se si janë reflektuar në fjalorë kemi bërë disa grupime të këtyre fjalëve.

Si shtojcë, në fund do të paraqesim me anë të fotove emërtimet e mjediseve publike të një rruge në qytetin e Tiranës, konkretisht rrugën “Abdyl Frashëri”, duke parë si është raporti i mjediseve të emërtuara në gjuhën shqipe në krahasim me ato të emërtuara në gjuhë të huaj.

KREU I

1.1 Mendimet e gjuhëtarëve për konceptin e huazimit

Përballja e parë me fjalët e huaja ka qenë nga leksikografët në shekullin XVIII. Kur mblidhnin materialin për fjalorë, ata nuk dinin si t'i klasifikonin këto fjalë, pasi mendimet e para të tyre ishin të ndryshme. Hugo Schuchardt¹ ishte i mendimit se nuk ka gjuhë që është plotësisht e papërzier. Antoine Meillet² huazimin e quan dukuri të natyrshme, kryesisht huazohen elemente leksikore dhe thuhet nuk ka gjuhë pa huazime. Schönfelder³ thoshte se përzierja e gjuhëve bëhej me ndikim të njëanshëm ose bilateral të dy apo të më shumë gjuhëve. Ky ndikim shprehej jo vetëm në leksik, por edhe në përmbajtjet fonetike, morfologjike dhe sintaksore.

Pra, deri në shekullin e 19-të është përdorur termi *gjuhë të përziera*, por më vonë u hodh poshtë pasi fjala “përzierje” nuk dukej e përshtatshme, dhe filloi të përdorej termi *huazim gjuhësor*. Bloomfield-i huazimin gjuhësor e përcaktonte si marrje të elementeve gjuhësore dhe dallonte dy tipa huazimesh: atë *kulturor* (kur elementet e huazuara vinin nga një gjuhë tjetër e largët) dhe *dialektor* (kalimi i fjalëve nga një dialekt në tjetrin).⁴

Megjithatë, ajo që pranohet botërisht në rrethin e gjuhëtarëve është fakti se asnjë gjuhë nuk është e kulluar, e pastër nga fjalët e gjuhëve fqinje, gjuhët e popujve me të cilët ka pasur kontakte për arsye të ndryshme, apo e gjuhëve me ndikim të fuqishëm ekonomik, politik e shoqëror, siç është anglishtja sot.

1.2 Huazimi si dukuri gjuhësore

Folësit e një vendi, me anë të fondit të pasur të fjalëve që disponon gjuha e tyre, arrijnë të ndërtojnë ura komunikimi mes njëri-tjetrit. Tashmë jemi të vetëdijshëm se pas viteve ‘90 pjesë e fjalorit të përditshëm të shqipfolësve janë bërë edhe shumë fjalë të marra nga gjuhë të tjera si anglishtja, italishtja, greqishtja, frëngjishtja etj. Gjuha, nga e cila i marrin fjalët e huaja folësit shqiptar, varion nga historia jetësore e gjithsecilit, d.m.th. në cilin vend ka studiuar, punuar apo ka pasur marrëdhënie për një periudhë të caktuar kohore dhe pikërisht nga ajo/ato gjuhë, ai/ajo përfshin në leksik fjalë të këtyre gjuhëve.

¹ Hugo Schuchardt, *Slavo – Deutes und Slavo – Italianisches*, Graz, 1884 sipas Vesel Nuhui, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 15.

² Antoine Meillet, *Linguistique historique et linguistique générale*, Paris, 1921 dhe 1936 sipas Vesel Nuhui, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 17.

³ Karl-Heinz Schönfelder, *Probleme der Wölker und Sprachmischung*, Halle, 1956, sipas Vesel Nuhui, Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe, f. 17.

⁴ Vesel Nuhui, *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 2013, f. 18.

Në periudhën e parë të kalimit nga mbyllja e gjithanshme në periudhën e sistemit qeverisës diktatorial, në fillimin e lidhjeve të para me vendet e tjera në periudhën e sistemit qeverisës demokratik, si në çdo fushë tjetër, edhe gjuha pati tronditjen e vet gjuhësore, kur trysnia e gjuhëve ardhëse, si anglishtja e italishtja, ishin më të forta se aftësia e gjuhës pritëse për të qëndruar e fortë ndaj tyre. Faktorët që kanë ndikuar për depërtimin e fjalëve të huaja në shqipe janë disa, si⁵:

1. Frekuenca dhe forca e trysnisë së gjuhës ardhëse, nga njëra anë, dhe e qëndresës së gjuhës pritëse, nga ana tjetër.
2. Kohëzgjatja e përballjes së ndërsjellë të tyre.
3. Synimi i folësve të gjuhëve përkatëse.
4. Shkalla e zotërimit të gjuhës pritëse nga folësi në gjithë shtrirjen e arealit gjuhësor.
5. Nevoja shoqërore e gjuhës pritëse për lëndë gjuhësore të gjuhës ardhëse për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë ndaj hapjes globale.
6. Niveli i njësimit të standardit të gjuhës pritëse për të mënjeluar kakofoninë gjuhësore që krijohet midis këtij të fundit dhe prurjeve dialektore e të dyja bashkë ndaj huazimeve në ekspansion.
7. Përkujdesja e institucioneve që merren me mësimin, pasurimin dhe ruajtjen e gjuhës, letërsisë dhe të kulturës kombëtare etj.

Çdo folës ka lirinë për të përzgjedhur fjalë që nuk janë pjesë përbërëse e gjuhës së tij dhe t'i përdorë gjatë komunikimit për të përmbushur nevojat që nuk ia jep gjuha shqipe. Megjithatë, gjatë këtij procesi duhet të kihet parasysh saktësia kuptimore dhe gramatikore e këtyre fjalëve. Çfarë do të thotë se nuk mund ta marrim fjalën e huaj pa e përshtatur në kontekstin që duam ta përdorim, dhe pa e përshtatur saktësisht me gramatikën e shqipes. Ndërsa Roberto Gusmani thotë se “tek huazimet riprodhohen vetëm disa aspekte të modelit e pikërisht referenciale të të shenjuarit”,⁶ pra fjala e huazuar nga gjuha që e marim mund të mbartë disa kuptime, por në shqipe mund të përdoret vetëm në një kontekst të caktuar.

Sipas vëzhgimeve të bëra, saktësia e sipërpërmendur në futjen e një fjale të huaj në leksik varet nga disa situata, si:

1. Në cilën shkallë e njeh folësi gjuhën e tij amtare, d.m.th. kur kërkon të marrë një fjalë nga një gjuhë tjetër a është plotësisht i bindur se gjuha e tij nuk e ka këtë fjalë.
2. Sa e njeh gjuhën e huaj nga e cila po merr fjalën, d.m.th. a ia di saktësisht kuptimin asaj fjale, në mënyrë të tillë që edhe kur ta përfshijë me fjalë të shqipes ta përdorë në mënyrë të drejtë, pa ia shtrembëruar kuptimin.

⁵ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë 2014, f. 36.

⁶ Kristina Jorgaqi, *Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde*, SF 1998 1-2, f. 86. sipas Roberto Gusmani, *Saggi sull'interferenza linguistic*, I, Firenze, 1981

3. Folësi huazues a është njohës i mirë i rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore, i veçorive gramatikore të gjuhës amë, që kur të fusë një fjalë të huaj në përdorimin e tij vetjak t'ua përshtatë saktë këtyre rregullave.
4. A e shikon si mundësi të parë të krijojë një fjalë nga vetë burimi i shqipes d.m.th. dialektet, të folmet krahinore etj., apo parapëlqen ta marrë tek një gjuhë tjetër.

Dukuria e huazimit është e mirëpranuar nga të gjithë dhe shihet shpesh herë si domosdoshmëri në komunikim, por deri aty ku kjo përdoret me logjikë dhe në dobi të komunikimit e pasurimit të gjuhës, pa shkuar në shpërdorim të kësaj lirie që ka secili folës dhe të kalojmë në dëmtim të gjuhës me futjen e fjalëve të huaja vend e pa vend.

1.3 Shqipja dhe gjuhët në kontakt

Huazimi ka ardhur si nevojë e njerëzimit për të komunikuar mes folësve të shteteve të ndryshme. Dallimi i gjuhëve nga njëra-tjetra ka të bëjë: 1. Me sasinë e fjalëve të huazuara, pasi disa gjuhë janë më shumë marrëse dhe disa më shumë dhënëse në varësi të hapësirave gjeografike ku përdoret gjuha, 2. Sa i fuqishëm politikisht dhe sa ndikuese është ekonomia apo dhe kultura e atij shteti që përdor gjuhën. Gjuhët të cilat u përkasim vendeve të zhvilluara e me kulturë të madhe janë në pozicionin për t'u dhënë fjalë gjuhëve të tjera, që u përkasin popujve më të vegjël, më pak të zhvilluar dhe me kulturë më të vogël.

Është e natyrshme që shqipfolësit kërkojnë ta pasurojnë fjalorin e tyre për të përmbushur sa më mirë nevojat e tyre të komunikimit, por nga vëzhgimet tona kemi dalë në përfundimin se shkojnë më lehtë të marrin fjalë nga një gjuhë e huaj, të cilën mund ta zotërojnë mjaftueshëm, mirë apo shumë mirë duke vënë në dyshim saktësinë kuptimore dhe gramatikore të përdorimit të huazimit në varësi të zotërimit të gjuhës së huaj, se sa të kërkojnë tek gjuha amë. Kjo varet edhe nga niveli i njohjes së shqipes nga folësi. Për këtë arsye duhen parë me sy kritik fjalët e huazuara, nëse përdoren në mënyrë të drejtë sipas rregullave të gjuhës ose jo.

Depërtimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe kushtëzohet nga:

1. Nevoja që ka shoqëria, e për pasojë edhe gjuha e saj, për të gjetur një emërtim për sende e koncepte të ndryshmet, të cilat ajo nuk i ka.
2. Trysnia që ushtrojnë popujt e tjerë në realitete të ndryshme, të tilla si: ekonomia, shoqëria, kultura etj.

Në periudha kalimtare, siç ka qenë dhe vazhdon të jetë gjuha shqipe pas viteve '90 e deri sot, trysnia e gjuhëve të tjera për të futur fjalë në gjuhën shqipe është më e madhe, sesa forca e shqipes për t'u bërë qëndruesë këtyre huazimeve. "Në këtë fazë folësit e gjuhës, të përballur me realitete të papritura, që lëkundin status quo-në e tyre në kufijtë e mbijetesës, nuk mund të kenë vetëdije të qetë gjuhësore në mbrojtje të gjuhës amtare.

Pragmatizmi për mbijetesë rrit nevojën për një komunikim global utilitar që shtrihet përtej caqeve të idiomës kombëtare”.⁷

1.4 Ndikimi i historisë në gjuhë

Në gjuhën e një vendi lënë gjurmët e veta edhe ngjarjet historike, të cilat kanë formësuar qenësinë e tij në vite, me të gjitha përjetimet njerëzore individuale e kolektive. Sigurisht shqipja nuk bën përjashtim nga kjo dukuri, prandaj disa nga këto momente kyçe të Shqipërisë të cilat kanë dhënë ndikimin e tyre në gjuhë po i listojmë më poshtë:

- Pushtimet territoriale që ka pasur Shqipëria disa herë nga shtete të ndryshme. Mund të përmendim pushtimin turk, nga gjuha e të cilit kemi huazuar mjaft fjalë. Për shkak të kohëzgjatjes së madhe të këtij pushtimi, një pjesë e këtyre fjalëve janë ngulitur në gjuhë, duke i rezistuar edhe kohës.
- Një tjetër ndikim kanë dhe sistemet qeverisëse, si p.sh. periudha 50-vjeçare e diktaturës ka lënë mjaft fjalë të atij sistemi dhe të atyre pak vendeve me të cilat bashkëpunoi.
- Vendosja e sistemit qeverisës demokratik ka pasur ndikimin e tij duke futur fjalë të huaja nga gjuhë të ndryshme në fushat ekzistuese jetësore, por edhe të tjerat që lindën më pas. Në shqipe u futën fjalë e terma të panjohur ose të njohur nga shqipfolësit, por të ndaluar më parë nga sistemi qeverisës, dhe disa të tjera depërtuan e u vendosën si sinonime me fjalë të shqipes duke konkurruar njëra-tjetrën.

1.5 Faktorët që ndikojnë në futjen e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe të sotme

Në më shumë se dy dhjetëvjeçarët e fundit gjuha shqipe po përballlet me huazime nga gjuhë të ndryshme, të cilat janë rrjedhojë e disa faktorëve, si: globalizmi, emigrimi, arsimimi jashtë vendit, politikat e shkollimit dhe e punësimit, folësi dygjuhësh dhe martesat e përziera. Në vijim po shpjegojmë secilin prej tyre.

1.5.1 Globalizmi

Tashmë pranohet nga të gjithë se globalizmi ka depërtuar në të gjitha fushat e jetës dhe nuk kishte se si gjuha të bënte përjashtim. Rritja e shpejtësisë dhe komoditetit të lëvizjes ka rritur shpeshtësinë e lëvizjes së njerëzve nga njëri vend në tjetrin. Gjithashtu, rritja e komunikimit me anë të teknologjive të fjalës së fundit, rrjeteve sociale, bashkëpunimet ekonomike, shoqërore, kulturore etj. mes shteteve të ndryshme ka çuar që edhe huazimet t’i shohim si rrjedhojë e këtij globalizmi e të shkëmbimeve mes shteteve. Kontaktet e njerëzve me kombësi të ndryshme, e rrjedhimisht me gjuhë të ndryshme, ndikojnë në rritjen e fjalëve të huaja në gjuhët respektive.

Por, përveç shkëmbimit të fjalëve mes gjuhëve, në disa vende dhe gjuhë, për arsye të ndryshme dhe në një periudhë të caktuar kohe ka ndodhur formimi i një gjuhe tjetër.

⁷ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe* 3, Tiranë 2014, f.37.

Kjo gjuhë ka lindur si nevojë komunikimi midis folësve prej vendesh me gjuhë të ndryshme. Kjo lloj gjuhe quhet *lingua franka* dhe *lingua franka* bëhet ose njëra nga gjuhët që kanë më shumë prestigj në rajon, ose njëra nga gjuhët që krijohen në mënyrë të pavetëdijshme për të mundësuar komunikimin, përzierja mes dy a më shumë gjuhësh. Në Shqipëri si *lingua franka* ka shërbyer greqishtja në periudhën pas pushtimit turk, sepse ishte gjuha zyrtare e Perandorisë Bizantine, gjuha e kishës ortodokse josllave, gjuhë e kulturës dhe e tregtisë. Ndërsa në kohën e sotme si gjuhë *lingua franka* shërben anglishtja për të gjithë globin⁸, e ku përfshihet edhe shqipja.

1.5.2 Emigrimi

Vendi ynë është në zhvillim e sipër dhe, si i tillë, e ka akoma të pamundur të ofrojë të ardhme të sigurtë dhe të kënaqshme për pjesën dërrmuese të popullsisë së saj. Për këtë arsye mjaft të rinj zgjedhin për t'u larguar nëpër shtete të tjera, me synimin për të siguruar një të ardhme më të mirë apo për të realizuar një ëndërr që vendi i tyre nuk ua mundëson dot për momentin.

Jo vetëm të rinjtë e shkolluar, por edhe shtresat e tjera të popullsisë kanë emigruar për arsye ekonomike. Në këtë mënyrë ata bëhen shkak, që duke filluar nga ata vetë dhe familjarët e tyre më pas, të përdorin fjalë të gjuhës së vendit ku ata jetojnë e punojnë gjatë një periudhe të caktuar kohe. Përgjithësisht kjo lloj kategorie huazon fjalë nga gjuha e folur, pasi vetëm atë arrin të përvetësojë deri diku, për të ndërtuar marrëdhëniet e thjeshta të komunikimit në përditshmërinë e tyre, ndërsa përvetësimi i gjuhës së shkruar na ka rezultuar i rrallë nga vëzhgimet tona.

1.5.3. Arsimimi jashtë vendit

Një elitë e shoqërisë shqiptare ka zgjedhur si investim për të ardhmen arsimimin e fëmijëve jashtë vendit në universitete më të mira. Këta të rinj, pasi përfundojnë studimet dhe vendosin të kthehen në Shqipëri, kthehen duke marrë me vete jo vetëm njohuritë e degës ku janë diplomuar, por edhe njohuri shumë të mira të gjuhës së atij shteti. Këto fjalë apo shprehje, dashur pa dashur, bëhen pjesë e leksikut të tyre dhe i përziejnë me ato të gjuhës shqipe gjatë akteve të komunikimit. Jo rrallëherë dëgjojmë shprehje shqip, me fjalë të huaja të vendosura tek-tuk, p.sh. me fjalë të anglishtes e bëra *copy paste* (*kopi pejst*) - e *kopjova*, *ka nevojë gjithmonë për një push nga unë* – *ka nevojë gjithmonë për një shtytje nga unë* etj.

1.5.4 Politika e shkollimit dhe punësimit

Kohët e fundit në Shqipëri, një ndër kriteret kryesore për t'u punësuar është zotërimi i një apo disa gjuhëve të huaja. Prandaj, për t'u ndier i plotësuar në tregun e punës, duhet të zotërosh mirë në të folur e në të shkruar të paktën një gjuhë të huaj. Për këtë arsye shumë prindër i drejtojnë fëmijët e tyre, qysh në një moshë të vogël, të mësojnë gjuhë të tjera, përgjithësisht anglishten e frëngjishten, por si perspektivë po shohin edhe mësimin e gjuhës kineze, meqë një pjesë e mirë e tregtisë botërore po bëhet atje. Edhe

⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë 2002, f. 319

për të mbrojtur një titull shkencor është ndër kriteret e domosdoshme të kesh mbrojtur një gjuhë të huaj.

Pra, pjesa më aktive e shoqërisë, brezi i të rinjve, zotëron të paktën një gjuhë të huaj dhe sigurisht që do të vazhdojnë t'ua transmetojë edhe brezave të ardhshëm ose minimalisht fëmijëve të tyre. E gjithë kjo shtresë shqipfolësish që njeh gjuhë të huaja, për arsye nga më të ndryshmet, i përdor jo vetëm aty ku duhet t'i përdorin, në komunikimin me të huaj apo gjatë leximit të literaturës së huaj, por edhe në komunikimin me bashkëkombasit shqiptarë, duke përzier jo rrallëherë edhe brenda një fjalie fjalë të disa gjuhëve.

1.5.5 Folësi dygjuhësh midis dygjuhësisë dhe diglosisë

Pjesa aktive e shqipfolësve, si: studentët, mësuesit, punonjësit e administratës, politikanët, gazetarët, intelektualët dhe fëmijët, janë një tjetër faktor për futjen e fjalëve të huaja, meqë me detyrim apo me vullnetin e tyre të lirë, po mësojnë të zotërojnë të paktën një gjuhë të huaj përveç shqipes. Në këtë mënyrë, shtohet numri i folësve dygjuhësh apo edhe shumëgjuhësh. Gjithashtu, shtohet dhe mundësia që secili folës të përdorë në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme, fjalë prej këtyre gjuhëve paralelisht me fjalët e shqipes apo ta heqin fjalën e shqipes duke parapëlqyer fjalën e huaj. Në rastin më të mirë përdoret saktë nga ana kuptimore apo si sinonim p.sh. *ishte atraktiv e tërheqës*, por ka dhe raste ku përdoret krejt pa vend, duke sjellë dhe probleme në komunikim, p.sh. *erdha sa për të të salutuar* - *erdha vetëm për të të përshëndetur*.

Në vendin tonë dygjuhësia/shumëgjuhësia është individuale, sepse dy apo më shumë gjuhë i zotërojnë grupe individësh jo e gjithë popullsia. Njëra gjuhë, që quhet ndryshe dhe gjuha e “zemrës”, është gjuha amtare, kurse tjetra/të tjerat mësohen si gjuhë të huaja për nevoja studimi, punësimi apo komunikimi me të huajt.

Për aq kohë sa gjuha e dytë e huaj është akoma dukuri e një grupi individësh dhe nuk kemi gjendjen e dygjuhësisë kolektive kemi të bëjmë me ***dukurinë e bilingualitetit*** dhe jo ***bilinguizëm***. Mendojmë se kjo dukuri po shkon drejt ***diglosisë***, pasi po shtohet numri i shqipfolësve me të paktën një gjuhë të huaj e herë-herë edhe në ***diglosi të çalë***, pasi gjuha e huaj nuk zotërohet plotësisht tek shqiptarët që jetojnë në Shqipëri apo gjuha shqipe harrohet deri diku nga shqiptarët që jetojnë në vende të tjera e kthehen në Shqipëri. Gjithashtu kemi të bëjmë me një ***bilingualitet pasiv***, pasi ka njohuri të gjuhës së huaj, por nuk e përdorin kudo, por vetëm kur i duhet, dhe ***bilingualitet të folur***, sepse kemi të bëjmë kryesisht me folës, të cilët mësojnë vetëm ta flasin gjuhën e huaj ose vetëm pak ta lexojnë, si nevoja mbijetese në vendin ku punojnë dhe nuk e shohin të arsyeshme apo nuk kanë mundësi të mësojnë shkrimin e saj.

1.5.6 Martesat e përziera

Në familjet që krijohen nga dy persona me kombësi të ndryshme, rrjedhimisht me gjuhë të ndryshme kemi problemin e përzierjes së kodeve të dy gjuhëve të prindërve për fëmijët. Në këto familje përgjithësisht mbizotëron gjuha e nënës. Në rastet kur gjuha e nënës është e njëjtë me mjedisin shoqëror, gjuha e babait quhet *alogjene*.

Ndërsa rastet kur gjuha e babait është ajo që përdor dhe shoqëria përreth, atëherë gjuha e nënës është alogjene dhe mbetet në hije deri diku, pasi ndikimi i mjedisit rrethues është mbizotërues. Në vendin tonë këto lloj martesash nuk janë shumë të përhapura dhe përbëjnë raste sporadike e, si të tilla, nuk kanë shumë ndikim në gjuhë.

1.6 Gjuha shqipe ka huazuar dhe po huazon fjalë të huaja

Gjuha shqipe klasifikohet ndër ato gjuhë që marrin fjalë nga gjuhët e tjera për disa arsye, si: a) është gjuhë e një vendi të vogël nga numri i popullsisë e i varur ekonomikisht e politikisht nga shtete më të fuqishme, b) hapësira gjeografike ku shtrihet Shqipëria është mes dy vendeve me kulturë të madhe, si Italia e Greqia.

Gjuha jonë është gjuha e një populli që ka luftuar shumë për të mbijetuar dhe për të ruajtur kufijtë e tij territorialë, njëkohësisht për të ruajtur edhe gjuhën si një element identiteti kombëtar. Për ta arritur këtë është bërë një punë shumëvjeçare nga shkrimtarë, studiues, gjuhëtarë e dashamirës të shqipes.

Shqipja është e hershme në të folur, por daton vonë dokumentimi i saj në të shkruar, dhe për këtë arsye mjaft fjalë e shprehje të bukura kanë humbur. Gjithsesi, kemi mundësinë nëpërmjet shkrimeve të shkrimtarëve të vjetër, si: Buzuku, Bogdani, Budi, Matrënga etj., të bëjmë studime gjuhësore krahasuese ndërmjet gjuhës që përdorim sot dhe asaj të hershme. Nga mënyra se si janë shkruar, leksiku i pasur që kanë përdorur këta shkrimtarë, tregojnë për cilësinë dhe konsolidimin e gjuhës, duke pasur parasysh kohën dhe kushtet në të cilat ajo është shkruar. Në ndryshim me atëherë, gjuha shqipe sot po turbullohet nga mjaft botues, nga fjalët e strukturat e huaja të panevojshme.

Shumë fusha të ndryshme të jetës shoqërore pas viteve '90 pësuan ndryshime si pasojë e hapjes me vendet e tjera. E njëjta gjë ndodhi edhe me gjuhën, në të cilën u dyndën fjalë të huaja nga të mundnin. Deri sot huazimet e fjalëve dhe strukturat e huaja janë futur në numër të konsiderueshëm, sa mund të themi me siguri se shqipfolësit po përdorin njëkohësisht disa sisteme gjuhësore. Kjo vjen si rezultat i ndikimit të gjuhëve në kontakt për shkak të fqinjësisë, por edhe gjuhës së vendeve të fuqishme ekonomikisht e politikisht.

Por tani, pas dy dekadash hapjeje me botën, duhet të fillojnë të ngulim këmbë me të gjitha mënyrat dhe format që kemi në dorë, për të bërë një klasifikim të fjalëve të huaja d.m.th. të mbajmë ato që e ndihmojnë shqipen të pasurojë leksikun, duke e bërë sa më funksionale për kohën, dhe pjesën tjetër ta largojmë duke bërë qëndresë të fortë ndaj tyre. "...Folësit do të fillojnë të reagojnë me vetëdijen e vetëmbrojtjes, do të shtien në punë kujtesën e përbashkët për të kërkuar brenda gjuhës që përdorin gjegjëset e tyre dhe, vetëm kur bëhet i pamundur zëvendësimi, atëherë do të pranojnë t'i përdorin, duke ua nënshtruar sistemit të gjuhës së tyre. Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekënd dhe masës së folësve që e përdorin, aq më shumë rritet qëndresa ndaj trysnisë së huazimeve".⁹

⁹ Shezai Rrokaj, *Përse përdorim fjalën e huaj në vend të fjalës shqipe*, 23 tetor 2013. Gazeta "Panorama"

1.7 Pasojat që kanë huazimet në komunikim

Prania e huazimeve në gjuhën shqipe dhe përmasat e mëdha që kanë marrë, tashmë janë pranuar, shtjelluar e faktuar nga studime të ndryshme. Më shumë nga të gjithë problemat e këtyre fjalëve të huaja e vuan folësi njëgjuhësh, folësi që flet vetëm gjuhën amtare. Për të shpjeguar rëndësinë e kësaj dukurie po paraqes skemën e Jakobsonit sipas të cilës jepet si funksionon një akti gjuhësor dhe si bashkëveprojnë elementet e tij me njëri-tjetrin. 1. **Dërguesi** (ai që e prodhon mesazhin), 2. **Marrësi** (ai që e merr dhe e interpreton mesazhin), 3. **Kodi** (është sistemi gjuhësor në bazë të të cilit prodhohet mesazhi), 4. **Mesazhi** (është thënia apo teksti gjuhësor i prodhuar në bazë të rregullave të kodit), 5. **Kanali** (mjete fiziko-naturor që lejon transmetimin e mesazhit), 6.

Konteksti (referenca) (i referohet mesazhit).¹⁰

Gjatë komunikimit **dërguesi** dhe **marrësi** kanë të përbashkët **kanalin** dhe **kodin**. Në të gjitha rastet e aktit të komunikimit **kanali** është i njëjtë për të dy dhe nuk ka problem. Vështirësia qëndron në situatën kur **dërguesi** dhe **marrësi** nuk kanë të njëjtin **sistem gjuhësor**, pra nuk përdorin të njëjtin kod. Si rrjedhojë kemi këto situata problemore në komunikim:

1. *Marrësi është folës njëgjuhësh, pra flet vetëm gjuhën amtare dhe dërguesi është folës dygjuhësh.* Dërguesi, meqë zotëron dy gjuhë, i përziën sistemet e tyre me njëra-tjetrën, duke krijuar një sistem të ri, i cili është pjesërisht i kuptueshëm për marrësin. E anasjella nuk shkakton problem në komunikim, pra kur marrësi është dygjuhësh dhe dërguesi njëgjuhësh pasi ai arrin ta përkapë plotësisht mesazhin e folësit njëgjuhësh.
2. *Marrësi dhe dërguesi zotërojnë dy gjuhë, nga një gjuhë tjetër përveç gjuhës amtare, por kjo gjuhë e dytë nuk është e njëjtë për ta,* p.sh. njëri zotëron gjuhën angleze dhe tjetri gjuhën franceze. Edhe në këtë rast shfaqen probleme në komunikim, sepse elementi i huaj i anglishtes te njëri folës është i pakuptueshëm për folësin tjetër që ka si element të huaj frëngjishten dhe anasjelltas.
3. *Marrësi dhe dërguesi zotërojnë të dy të njëjtën gjuhë të huaj, por niveli dhe cilësia e përvetësimit të saj është i ndryshëm për secilin.*

Prej këtyre tri mundësive rasti i parë shfaq më shumë problem dhe, sipas vëzhgimeve të bëra në jetën e përditshme, përbën pjesën më të madhe të popullsisë, e cila nuk kupton ku qëndron problemi. Ai/ajo kur dëgjon një emision në radio, shikon një debat në televizion, lexon gazetën dhe një pjesë të mirë të fjalëve nuk i kupton, atëherë mendon se nuk ka aq nivel zgjuarsie sa për të kuptuar se për çfarë flitet apo gjuha është zhvilluar aq shumë, sa që ai/ajo ka mbetur mbrapa në kohë. Prandaj, pyet për ndonjë fjalë të pakuptueshme ndonjë të ri, i cili që në shkollë fillore ka filluar të marrë njohuri të një apo dy gjuhëve të huaja dhe arrin deri diku t'i kuptojë ato. Rasti më i mirë është kur ia shpjegon qartë dhe saktë, pasi ka dhe raste kur fjalët e huaja mund të keqinterpretohen, për shkak të ngjashmërisë në shkrim apo shqiptim.

¹⁰ Gjovalin Shkurtaç, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë 2003, f. 119

1.8 Rrugët e futjes së huazimeve në shqipe

Rrugët që ndjek fjala e huaj për t'u bërë pjesë e leksikut të folësve janë disa. Secila prej tyre ka rëndësinë dhe specifikën e vet, por mund të themi se disa kanë ndikim më të madh, si: *përkthyesit, media* etj. dhe disa të tjera më të vogël, si: *terminologjia shkencore* apo *folësi i thjeshtë dygjuhësh*. Më poshtë po rendisim disa rrugë, prej të cilave futen fjalët e huaja në gjuhën shqipe.

Vendi ynë është në kontakt me shumë gjuhë të tjera, prandaj një ndër rrugët e futjes së fjalëve të huaja në gjuhën shqipe janë ***marrëdhëniet e vendit tonë me popujt e tjerë***, si nevojë për të shkëmbyer mendime e përvoja dhe pozicioni i gjuhës shqipe si gjuhë me numër të vogël folësish mbetet inferiore në këtë marrëdhënie, çfarë do të thotë se shqipja merr rolin e gjuhës marrëse dhe gjuhët e tjera rolin e gjuhës dhënëse të huazimeve.

Në ditët e sotme shumë ***gazetarëve*** të shtypit të shkruar, radiove dhe televizioneve u mungon kultura dhe njohuritë e sakta gjuhësore, pra kanë mangësi në formimin profesional. Si rezultat i kësaj, përcjellin tek publiku informacione me gabime të rënda gjuhësore, ndër të cilat futet edhe përdorimi vend e pavend i fjalëve të huaja. Edhe huazimet i shkruajnë apo shqiptojnë sipas dëshirave vetjake të çastit, jo duke u bazuar tek rregullat drejtshkrimore apo drejtshqiptimore të shqipes.

Mënyrë tjetër është ***shtegtimi i fjalës*** nga një vend në një tjetër, ***së bashku me sendin a me dukurinë***. Nga vendet me teknologji më të fuqishme, prej të cilave marrin objekte apo dukuri, futen në gjuhën shqipe emërtimet nga ajo gjuhë, e tillë është p.sh anglishtja që është bërë mbizotëruese në botë, e prej të cilës janë marrë mjaft fjalë e terma. Shembulli më konkret për të gjithë është përdorimi i gjerë i kompjuterit, e gjithë terminologjia e të cilit është në anglisht, si rrjedhojë të gjithë përdorin terma të huaja, si p.sh. *danlaudoj tekstin, (shkarkoj) selektoj (përzgjedh), sejvoj (ruaj), slajd, mouse (miu)* etj.

Një ndikim të madh për futjen e fjalëve të huaja në gjuhë kanë ***bisedat dhe debatet e realizuara në radio dhe TV*** nga persona, të cilët nuk kanë zotërim të mjaftueshëm të leksikut të shqipes. Si të tillë, ata përdorin fjalë të huaja, ku me shumë ngjasë dhe kuptimin e saktë të atyre fjalëve nuk ia dinë, pasi shpeshherë i përdorin gabim.

Përkthimet e librave nga përkthyes të cilët janë të paformuar plotësisht nga ana gjuhësore, ndikon në futjen e huazimeve. Këta janë përkthyes të cilët e njohin mirë gjuhën e huaj, por nuk e njohin aq mirë gjuhën shqipe, fondin e leksikut dhe ndërtimet e saj sintaksore. Dhe anasjelltas, njohin mirë gjuhën shqipe dhe jo aq mirë gjuhën e huaj. Një përkthyes, që të quhet përkthyes i mirëfilltë, duhet t'i zotërojë shumë mirë të dyja gjuhët, jo vetëm njëërën, sepse në të kundërt nuk arrin të realizojë përkthim cilësor.

Folësit që flasin dy gjuhë shpesh i ngatërrojnë të dy gjuhët dhe flasin disa fjalë nga njëra gjuhë dhe disa nga tjetra, duke krijuar kështu një gjuhë të përzier me elementet e të dyja gjuhëve. Kur folësi nuk ka pozicion publik d.m.th. komunikon me pak njerëz,

ndikimi i tij është i vogël, por kur folësi ka marrëdhënie, për shkak të natyrës së punës me shumë shqipfolës, ndikimi i tij është i konsiderueshëm.

1.9 Huazimi në këndvështrimin sociolinguistik

Fjalët e huaja, të cilat futen në gjuhën shqipe studiohen nga gjuhëtarët, pasi është një dukuri gjuhësore, por në këtë proces ndikojnë disa faktorë jashtëgjuhësorë, si: *shkalla e zhvillimit të ekonomisë dhe kulturës, sa mundësi kanë shqipfolësit për të lëvizur e si rrjedhojë të bien në kontakt me gjuhë të tjera, sa e kultivuar është tek secili dashuria dhe vlera e gjuhës amtare*. Por nga ana tjetër kemi dhe aftësinë e folësit për ta ndryshuar gjuhën në varësi të personit që flet duke iu përgjigjur pyetjeve të J. Fishmanit: **kush flet, me kë flet, kur dhe ku** si dhe në cilin **varietet gjuhësor**.

Në të gjitha qendrat urbane vihet re një ndërthurje njerëzish me kulturë, dialekt, arsimim të ndryshëm, por që të përbashkët kanë futjen, mes shqiptimit e shkrimit të fjalëve shqip, një mori fjalësh të huaja. Kjo gjithmonë duke pasur parasysh se kë kanë si dëgjues apo lexues, duke iu përmbajtur pyetjeve të Fishmanit. Pra, shqipfolësit i përdorin fjalët e huaja, *së pari*, në shoqërinë e tyre të cilët pak a shumë përkojnë me nivelin e tyre arsimor, *së dyti*, i përdorin në media ku paramendohet se i vëzhgojnë shtresa të ndryshme dhe atëherë kur janë të interesuar t'i kuptojnë vetëm një elitë njerëzish dhe pjesa tjetër ta shohin si “të paarritshëm” nga zgjuarsia që tregon apo të tregojë se është me një “nivel të lartë” kulturor.

Pas viteve ‘90 në Shqipëri emigrantët ishin ata që filluan të parët të futnin fjalët e huaja në komunikim me familjarët e të afërmit kur flisnin për vendet ku kanë qenë, kanë vizituar e kanë punuar. Prej tyre ishte deri diku e kuptueshme, pasi gjuha e tyre shqipe, duke qenë në kontakt me një gjuhë më të madhe, edhe pse ishte “gjuha e bukës”, jo “e zemrës”, kishte ndikim tek ata. Megjithatë, gjuha e emigrantëve deri diku mund të ndikonte vetëm tek të afërmit e tyre, prandaj nuk paraqiste ndonjë problem të madh për shqipen. Personat që emigronin, kryesisht për arsye ekonomike, nuk kishin dhe njohuri të qëndrueshme e të plota të shqipes, pasi për arsye përgjithësisht ekonomike nuk e kishin përfunduar shkollën, prandaj dhe i fusnin fjalët e huaja pa vetëdije në leksikun e tyre. Një arsye tjetër ishte edhe krenaria që donin të shfaqnin se kishin arritur të mësonin një gjuhë të huaj dhe për të treguar se ishin bërë më të ditur, më të zgjuar dhe më të zotë, duke i vendosur huazimet ku të mundnin.

Nuk mund të themi të njëjtën gjë për personat publike, që jo gjithmonë janë shembull i intelektualit shqiptar të mirëformuar, por për pozicionin që kanë, mënyra e të folurit merret si shembull nga ata që e dëgjojnë. Gazetarët, moderatorët, prezantuesit e emisioneve, politikanët janë ndër personat që përdorin më shumë fjalë të huaja dhe jo rrallëherë i thonë kur edhe vetë nuk ua dinë mirë kuptimin. Shpeshherë ata i fusin si pjesë e komunikimit që të shmangin pyetjet që u bëhen apo të flasin shumë rreth asaj pyetjeje me fjalë të huaja, që të duket sikur po thonë ndonjë gjë të rëndësishme, por realisht nuk thonë asgjë ose flasin pa kuptim.

1.9.1 Arsyet e përdorimit të huazimeve nga shqipfolësit

Huazimet po bëhen pjesë e leksikut të gjithë popullsisë, por më tepër e të rinjve, pasi ata janë shtresa që e përthithin më shpejt të renë. Kjo masë e madhe huazimesh vihet re sidomos në media, bisedat e të rinjve, komunikimi mes tyre në mesazhe telefonike apo rrjetet e ndryshme sociale. Arsyet pse i përdorin janë disa, si:

1. Për t'u dukur më të kohës apo modernë.
2. Për t'u paraqitur të barabartë mes tyre.
3. Duan të tregojnë se dinë disa gjuhë të huaja, pra të tregohen superiorë ndaj atyre që nuk kanë njohuri të tilla.
4. Jo rrallëherë i përdorin për të mos u kuptuar nga pjesa tjetër e njerëzve që i rrethon.

Kudo të zë veshi apo shikon të shkruara fjalë e shprehje të tilla si: *ciao për mirupafshim, hi për përshëndetje, ky është friendsi im për ky është miku/mikja ime, po lukesh shumë bukur sot për po ngjan, dukesh shumë bukur sot* (sipas fjalës së huazuar luk-pamje, paraqitje), *kush do vijë të dance me mua për kush do vijë të kërcejë me mua, unë like shumë këpucët e tua për unë i pëlqej shumë këpucët e tua* etj. *Dola për shopping për Dola për të blerë, A do ta paguash me para kesh? për A do të paguash me para në dorë, Kush ka marrë më shumë like për Kush ka marrë më shumë pëlqime* (përdoret në rrjetet sociale "Facebook", "Twitter" etj.).

Për këtë situatë profesor Gjovalin Shkurtaj shprehet se "...shqipja nuk ngjan më si gjuha jonë, por si një përzierje a "hibride" e tipit të "franglais" (frëngjishtes), kundër së cilës me aq zell e atdhetari luftojnë prej vitesh francezët. Edhe ne na kërcënon sot rreziku i një "shqipanglitalishteje", prandaj në qoftë se nuk duam që një shqipe e përçudnuar të përçudnojë edhe mendjen e shqiptarëve, duhet që shteti dhe krejt shoqëria e qytetëruar shqiptare të shkunden nga letargjia dhe të dalin nga mjegullnaja e kësaj shqipanglitalishteje që rrezikon të na kaplojë".¹¹

Ky përdorim i gjerë i fjalëve të huaja ka sjellë problem në komunikimin e përditshëm, pasi mesazhi që përcjell folësi nuk shkon plotësisht i qartë tek të gjithë dëgjuesit, kur folësi ndërthur gjuhën shqipe me fjalë të huaja nga disa gjuhë të tjera, të cilat ai i njeh.

Mes shqipfolësve që njohin disa gjuhë të huaja, të cilët janë dhe pjesa më aktive në punë, media, politikë dhe të rinjtë, me pjesën tjetër të folësve që nuk i përdorin fare ose shumë pak, pasi nuk kanë pasur kontakt me gjuhët e tjera ose puna që bëjnë nuk e ka të nevojshme për të njohur një apo më shumë gjuhë të huaja, krijohet një hendek i konsiderueshëm. Ky disnivel është i tillë sa mjaft njerëz shprehin shqetësimin se nuk arrijnë t'i kuptojnë disa të tjerë, të cilët flasin një lloj gjuhe shqipe të pakuptueshme për ta. Pra, mes tyre realizohet akti i të folurit, por jo akti i komunikimit, pasi ata nuk arrijnë të kuptohen plotësisht mes tyre.

¹¹ Gjovalin Shkurtaj, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë 2003, f. 78

KREU II

2. Një vështrim i përgjithshëm historik për etapat kryesore të huazimeve në gjuhën shqipe

Në gjuhën shqipe, si rezultat i kontakteve të vazhdueshme ndër shekuj me popullsi e gjuhë të ndryshme, kanë hyrë mjaft elemente të huaja. Për shkak të ngjarjeve historike që ka përjetuar vendi ynë, zhvillimi dhe normëzimi i gjuhës shqipe ka kaluar në disa peripeci që lidhen kryesisht me pushtimet, të cilat e kanë dhënë efektin e tyre drejtpërdrejt në gjuhë. Si një vend i vogël dhe me pozicion gjeografik të lakmueshëm nga shtete të fuqishme, ajo ka qenë disa herë e pushtuar për shekuj të tërë nga perandori të mëdha që kanë bërë presion të fuqishëm, me qëllim përvetësimin e asimilimin e territorit, kulturës, zakoneve ku nuk bën përjashtim edhe gjuha.

2.1 Huazime të hershme në periudhën antike

Periudha antike është koha kur u formua gjuha shqipe si gjuhë e shkruar, e cila arriti fazën më të lartë në epokën e Skënderbeut. Edhe pse nuk ka dokumente të shkruara në gjuhën shqipe të periudhës pas pushtimit të Ilirisë nga Roma, prapëseprapë për strukturën e saj mund të gjykohet nga qëndresa që ajo u ka bërë ndikimeve të gjuhëve të huaja latine, greke e sllave.

2.1.1 Grupimi i fjalëve të huaja në periudhën antike

Fjalët prej burimit të huaj, që ndeshen në shqipen e dokumentuar, duhen ndarë në dy grupe të mëdha: 1. Fjalë prej burimit të huaj që shqipja i ka trashëguar nga “nëna” e saj; 2. Fjalë prej burimit të huaj që shqipja i ka huazuar drejtpërdrejt nga gjuhët e tjera, me të cilat ka pasur marrëdhënie historike. Pra, huazime të vetë shqipes janë vetëm fjalë prej burimit të huaj të grupit të dytë, kurse ato të grupit të parë janë huazime të “nënës” së shqipes dhe si të tilla duhen konsideruar si fjalë të trashëguara, por prej burimit të huaj.

Si cak kohor për veçimin e këtyre dy grupe fjalësh do të merret ajo periudhë kur u krye shndërrimi cilësor nga ilirishtja në shqipe, d.m.th. përafërsisht periudha midis shekujve IV-VI të erës sonë.¹²

2.1.2 Huazime nga greqishtja e vjetër

Elementet e greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe janë dy llojesh, të futura *drejtpërdrejt* në gjuhën shqipe dhe në mënyrë *të tërthortë* nëpërmjet latinishtes. Fjalët e ardhura nga greqishtja e vjetër janë të përhapura në të gjithë vendin dhe kanë pësuar

¹² Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë 1988, f. 105.

ndryshime fonetike. Sipas Thumbit, në gjuhën shqipe ndeshen 21 fjalë nga greqishtja e vjetër p.sh *drapën / drapër, lakën / lakër, pjepën / pjepër, presh, qershi, shpellë* etj.

“Numri relativisht i vogël i këtyre fjalëve dëshmon se ndikimi i greqishtes së vjetër mbi “nënë” e shqipes ka qenë i kufizuar... se ngulimet e vogla greke të Adriatikut nuk mund të ushtronin një ndikim të madh mbi popullsinë vendase më të madhe në numër”.¹³

2.1.3 Fjalët nga latinishtja

Elementet latine në gjuhën shqipe janë më të shumta në numër, duke i krahasuar me ato të greqishtes së vjetër, të cilat vijnë si rrjedhojë e kontakteve të shpeshta mes dy popullsive. Ky ndikim ka qenë deri rreth fundit të shek. X, sepse më pas fillon huazimi nga italishtja.¹⁴ Me burim latin janë përgjithësisht fjalë të terminologjisë fetare, p.sh.: *djall, kishë, kreshmë, mëkat, murg, pashkë, prift* etj.; emrat e farefisit dhe jetës shoqërore *armik, femër, fëmijë, fqinj, krushk, kunat, kushëri, mashkull, mbret, mik, mjek, mjeshtër, njeri, prind, qytet, shok, ungj* etj.; pjesët e trupit *faqe, flok, fytyrë, këmbë, kofshë, kokë, mendje, shëndet, shpatull, shpinë, shtat* etj.; kafshë dhe shpend *gjel, lepur, luan, pëllumb, pulë, qen* etj.; shtëpia *furrë, gëlqere, kulm, mur, portë, shtëpi, tjegull, tra* etj.; bujqësi, blegtori, zejtori etj. *bujk, ftujë, furkë, gështenjë, kaproll, kulloshtër, mulli, musht, myshk, parmendë, pemë, pjeshkë, pyll, qerre, shportë, ulli, vaj* etj.; koha p.sh. *fruer, gusht, janar, maj, mars, e martë, e mërkurë, prill, e shtunë, verë*; mbiemra p.sh. *i ashpër, i drejtë, i gjelbër, i qetë, i shëndoshë, i shkretë, i shtrenjtë, i shurdhët, i varfër, i verbër, i verdhë* etj.; folje p.sh. *bekoj, duroj, fërkoj, ftoj, gjëmoj, gjykoj, lëvdoj, mbroj, mërzej, pagëzoj, peshoj, pëlqej, përtoj, qortoj, rrëmbej, rrënoj, shëmbëllej, shërbej, trishtoj* etj.

Nga Mihaescu përcaktohen 85 fjalë prej burimit latin, të cilat janë ruajtur vetëm në shqipe dhe nuk ndeshen në asnjë gjuhë tjetër romane. Ndër to ai përmend *bujk – bubulcus, shelqëror – sarcinarius, tërfurk – trifurcus* etj...; 151 fjalë prej burimit latin që ndeshen në gjuhën shqipe dhe nuk hasen në rumanishte p.sh. *mik – amicu, armik – inimicus, bekoj – benedicere, qelq – calicis, kështjellë – castellum, qind – centrum, gjel – gallus, mjek – medicus, shërbej – servire, vullnet – voluntas* etj.¹⁵

Pavarësisht nga disa huazime që hyjnë në leksikon e saj, gjuha shqipe e kësaj periudhe ishte e kristalizuar në strukturën e saj themelore gramatikore, meqenëse ajo iu përgjigj si një unitet, si një tërësi e formuar, ndikimeve të gjuhëve të huaja, sidomos në periudhën historike kur filloi ndikimi më i madh i sllavishtes d.m.th. aty nga shek. IX-XII.

¹³ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë 1988, f. 109.

¹⁴ Po aty, f. 111.

¹⁵ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë 1988, f.113-115.

2.1.4 Huazime në tekstet e vjetra të gjuhës shqipe

Huazimet sllave iu nënshtruan veprimit unitar të një gjuhe të formuar, dëshmi kjo e unitetit etnokulturor të popullsisë së lashtë vendase.¹⁶ Këtë mund ta shohim tek veprat e autorëve të vjetër si Buzuku, Matrënga, Budi e Bardhi.

Nga ana leksikore, gjuha e veprës së Buzukut në përgjithësi është e pastër, por ai përdor edhe mjaft latinizma, italianizma (*tentoj, fenestra*) sllavizma e pak turqizma (*dollame, kallauz*). Në veprën e Matrëngës ka plot turqizma, kurse tek shkrimet e Budit është vënë re mungesa e elementit sllav.

Vepra gjuhësore më e rëndësishme e Frang Bardhit është “Fjalori latinisht-shqip”, fjalor i cili ka rëndësi historike për gjuhën tonë letrare, sepse për të parën herë shqipja vihet përballë në një rrafsh tërësor e të kodifikuar leksikor me latinishten.

Në strukturën leksikore të gjuhës shqipe të shek. XVIII-XIX gjejmë të përdorura pa nevojë fjalë të huaja nga autorët e veprave të letërsisë shqipe me alfabet arabo-turk ose, siç quhen ndryshe, bejtexhinjtë. Vjershat e tyre janë përgjithësisht të ndërthurura me turqizmat ose orientalizmat. Në këtë kohë depërtuan në shqipe edhe huazime arabe dhe perse, kryesisht nëpërmjet turqishtes. Megjithatë, asnjëherë leksiku i kësaj periudhe nuk është mbingarkuar, aq sa ta pengonte marrëveshjen midis shqiptarëve kudo që ishin, ai nuk përbënte kërcënim real asimilues për shqipen.¹⁷

2.2 Huazime gjatë periudhës së Rilindjes deri në vitet ‘90

Gjatë kësaj periudhe u hapën mjaft shkolla, në të cilat u mësua gjuha shqipe e përbashkët për të gjithë. Kjo gjuhë që do të mësohej në shkolla duhej të mbante lidhje të ngushta me gjuhën e folur të popullit dhe të mbështetej në të, duke u pastruar nga elementet e huaja dhe zëvendësimi i tyre me elementë të burimit vendas.

Pastrimi e zëvendësimi i fjalëve të huaja me fjalë të shqipes dhe pasurimi i leksikut u bë nga rilindasit në dy rrugë: a) Me fjalë “plaka” e të harruara të shqipes, të mbledhura në truallin amtar, disa prej të cilave iu dhanë edhe kuptime të reja; kështu veproi Sami Frashëri i cili terminolizoi fjalët e leksikut të përditshëm *emër, rrënjë, nyje, vetë*, Naim Frashëri termat gjeografikë *bosht, lëmsh* etj.; b) Me fjalë të reja të krijuara nga burimi i shqipes; këtë rrugë ndoqi Naum Veqilharxhi që krijoi fjalët e reja *gjithësi, cilësi, sasi, papunësi, barngrënës* etj., Sami Frashëri krijoi *mbiemër, përemër, kryeministër, gjerësi* etj., Jani Vreto krijoi *mëmëdhe*, Kostandin Kristoforidhi ka krijuar fjalët *ndërgjegje, kryeqytet, udhëheqës, bukëpjekës*, P. N. Luarasi, në veprën e të cilit gjenden për herë të parë fjalët *përvojë, kundërveproj, bashkëveproj, bashkësi, i përbotshëm, përfaqësi* etj. Rilindasit u përpoqën mjaft për ta pastruar fjalorin e shqipes së përbashkët sidomos me emrat abstraktë, për të cilët shqipja e atëhershme ndiente një nevojë të madhe.¹⁸

¹⁶ Miço Samara, *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë 2000, f. 47.

¹⁷ Po aty, f. 66-67.

¹⁸ Miço Samara, *Historia e gjuhës letrare shqipe*, Tiranë 2000, f.78

Në disa raste rilindasit e tepruan duke u përpjekur të zëvendësojnë edhe ndonjë fjalë të huaj ndërkombëtare, ata krijuan për këtë qëllim fjalë të cilat nuk e patën jetën e gjatë, si *gjithëmësime* për *universitet*, *dheshkronjë* për *gjeografi*, *dhematje* për *gjeometri* etj.; por nga ana tjetër ata krijuan edhe shumë fjalë të goditura, me të cilat u pasurua shqipja letrare... në kohën kur pjesa më e madhe e popullit ishte analfabet, futja e fjalëve të huaja të panevojshme në gjuhën tonë e pengonte më shumë të mësuarit lehtë të saj dhe e prishte atë.¹⁹

Pas rilindjes në gjuhë depërtuan një numër jo i vogël fjalësh nga italishtja. Por ky depërtim nuk qe aq i thellë dhe nuk zgjati shumë, meqenëse vetë gjuha iu kundërvu këtij fenomeni.

2.2.1 *Parashtesat dhe prapashtesa nga gjuhët romane*

Nga gjuhët romane në shqipe kanë hyrë parashtesa **ri-** dhe prapashtesa **-ist** dhe **-izëm** me të cilat janë formuar edhe fjalë të prejardhura nga burimi i shqipes si *rindërtoj*, *ripërpunoj*, *rishikoj* etj. *majtist*, *djathtist*, *majtizëm*, *djathtizëm*, *zyrtarizëm*.²⁰

2.2.2 *Huazimet sllave në gjuhën shqipe*

Huazimet sllave kanë depërtuar drejtpërdrejt në gjuhën shqipe gjatë marrëdhënieve historike me gjuhët sllave të Ballkanit. Këto huazime kanë depërtuar në shqipe pas shek. IX. Sllavizmat që kanë depërtuar në të folmet jugore dhe ato të Shqipërisë së mesme kanë disa karakteristika të bullgarishtes, si p.sh. *mezhdë*, *opingë*, ndërsa ato që kanë depërtuar në të folmet veriore, kanë disa karakteristika gjuhësore të serbokroatishtes si p.sh. *grusht*, *kyç*, *kosë*, *kosh*, *kovë*, *lopatë*, *nevojë*, *prag*, *strehë*, *zakon* etj. Disa nga fushat leksikore të fjalëve sllave janë emra të lidhjeve farefisnore dhe trupi p.sh: *xhaxha*, *teto*, *grusht*, *kockë*, *trup* etj.; kafshë, shpendë, peshq, insekte: *mace*, *maçok*, *zhabë*, *kokosh*, *patë*, *patok*, *harabel*, *krap*, *karkalec* etj.; shtëpia dhe orenditë shtëpiake: *strehë*, *prag*, *grazhd*, *oborr*, *kotec*, *orendi*, *kovë*, *saç* etj.; bujqësia, blegtoaria, zejtoaria: *bashtinë*, *branë*, *brazdë*, *kastravec*, *kosë*, *kosh*, *lopatë*, *pleh*, *gozhdë* etj.; jeta shoqërore, administrata etj.: *bujar*, *dobi*, *gjobë*, *kasnec*, *krahinë*, *nevojë*, *rob*, *zakon* etj.; mbiemra: *i begatë*, *i vobektë* etj.; folje: *avit*, *darovit*, *godit*, *gostit*, *habit*, *neverit*, *padit*, *porosit*, *prashit*, *vadit*, *vozit*, *nuhas/nuhat*, *vikas/vikat* etj.

2.2.3 *Prapashtesat e sllavishtes në gjuhën shqipe*

Në gjuhën shqipe kanë hyrë edhe disa prapashtesa me burim sllav, si: **-ac/-ec**: *burrac*, *dorac*, *tullac* etj.; **-ash**: *çalash*, *gjumash*, *kromash*, *qurrash* etj.; **-avec**: *burravec*, *grindavec*, *qurravec* etj.; **-icë**: *buallicë*, *gomaricë*, *ngushticë*, *pakicë*, *shumicë* etj.;

-inë: *luginë*, *rrafshinë*, *thartinë* etj.; **-nik**: *besnik*, *fisnik*, *petanik* etj.; **-it**: *djesit*, *kopsit*, *radhit*, *rendit*, *ujit* etj.

¹⁹ Po aty, f. 82.

²⁰ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë 1988, f. 118.

2.2.4 Huazime nga turqishtja

Huazimet turke kanë nisur që në gjysmën e dytë të shekullit XIV dhe janë bërë më të dendura pas pushtimit të trevave shqiptare nga turqit. Disa huazime turke kanë depërtuar bashkë me sendet a dukuritë e reja që sollën turqit në jetën e përditshme të vendit tonë, p.sh. *haraç, bej, pasha, vezir, kadi, myfti, çiftlig, vakëf, vergji, xhami* etj. Një pjesë e turqizmave janë të sferës ushtarake, p.sh. *bori, daulle, dyfek, ftil, jeniçer, mejdan* etj. Një pjesë tjetër janë të sferave të ndryshme p.sh. *adet, beg/bej, cohë, çorap, gajtan, isap (=hesap), hambar* etj.

Turqizmat i hasim ku më shumë e ku më pak edhe tek autorët e vjetër, si p.sh. tek Buzuku ndeshim 6 turqizma: *dollamë, cohë, harami (=kusar), kallaus, tepsi, turk*. Tek Budi gjejmë pak më shumë p.sh. *cohë, pazar, temel, shend (=gëzim), raki, terezi (=peshë), dertunë (=vajtoj), sengjir (=zinahir)*. Kurse tek fjalori i Bardhit dhe në veprën e Bogdanit numri i turqizmave është mjaft i madh. Bardhi, siç dihet, në shpjegimin e fjalëve latine, krahas fjalëve shqipe, në disa raste ka shtuar dhe fjalë turke, çka dëshmon se turqizmat në kohën e tij ishin bërë më shumë të njohura se në shekullin e mëparshëm. Tek Bardhi gjejmë këto fjalë *bajrak, berber, hambar, hesap, ibrig, kazan, kurban* etj. Kurse tek Bogdani gjejmë fjalët *amanet, bahçe, boja, hajat, kallëp, kasap, kati, mavi, saraj* etj.²¹

Tek poetët bejtexhinj ndeshen më shumë fjalë turke, arabe, perse që ishin fare të panjohura për masat e gjera popullore.

2.2.5 Prapashtesa me burim nga turqishtja

Në shqipe kanë mbetur edhe disa prapashtesa turke riprodhuese në leksik, pra që kanë formuar fjalë të reja, si: **-li/-lli** p.sh. *merakli, namusli, qejfli, sevdalli* etj.; **-llëk/-llik** p.sh. *agallëk, budallallëk, karshellëk* etj.; **-xhi /çi** p.sh. *bejtexhi, bojaxhi, dyqanxhi, bataqçi, sahatçi, zanatçi* etj.; **-llarë/-llerë** p.sh. *baballarë, pashallarë, bejlerë* etj.

2.2.6 Huazime nga greqishtja

Ndikimi i greqishtes ka ardhur duke u shtuar pas vendosjes së greqishtes si gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine aty nga shekulli VII i erës sonë. Këto huazime kanë pësuar më pak ndryshime se huazimet nga greqishtja e vjetër dhe kanë depërtuar pothuajse vetëm në të folmet jugore dhe kryesisht nëpërmjet gjuhës së folur. Këtu fjala është kryesisht për terma që janë ndërtuar nga burimi i greqishtes dhe që në shqipe kanë hyrë më fort nëpërmjet

gjuhëve romane, p.sh. *aristokraci, demokraci, dialog, diametër, fonetikë, gjeografi, gjeologji, gjeometri, hipertoni, monolog, morfologji, perimetër, sintaksë* etj.

Disa parashtesa të burimit grek janë: **-it** (*gjirokastrit, libohovit*), **-jot** (*gramshijot, himarjot*), **-omë** (*baltomë, zezomë*), **-is** (*kallajis, pajis, përrallis, tiganis*), **-os** (*ajros, brengos, fundos*) etj

²¹ Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë 1988, f. 125, 126.

2.2.7 Huazime nga italishtja

Si kufi kohor për fillimin e depërtimit të italianizmave merret shekulli X i erës sonë. Këto huazime kanë pësuar më pak ndryshime fonetike e kuptimore sesa huazimet nga latinishtja. Kanë hyrë fjalë të termave të lundrimit, teknikës, të shkencës e të arteve, si: *barkë, vapor, vel, rem, shirok, timon, freno, torno, tornitor, freza, kimi, muzikë, bas, soprano* etj., prej të cilave fjalët *kimi, muzikë, bas, soprano* janë ndërkombëtarizuar.

2.2.8 Huazimet nga frëngjishtja

Fjalët nga frëngjishtja në shqipe kanë hyrë kryesisht nëpërmjet gjuhës së shkruar ose shtresës së shkolluar të popullsisë. Ato kanë ruajtur në përgjithësi tiparet e shqiptimit ose fjalëformimit të gjuhës dhënëse, si p.sh. *atelië, bezhë, byro, bluzë, bronshit, dantellë, garazh, gardërobë, gri, klishë, komplet, marsh, masazh, metrazh, natyrë, pardesy, pudër, relief, solfezh, triko, turnë* etj.

2.3 Huazimet në gjuhën shqipe pas viteve '90

Huazimet më të shumta u përkasin fushave të ndryshme të teknikës e shkencës, ku futet sendi apo dukuria, së bashku me emërtimin e gjuhës së vendit që e shpik apo nxjerr. Këtyre termave është vështirë t'u gjesh një gje gjegjëse në gjuhën shqipe, që të përshtatet plotësisht me kuptimin që ato shprehin, dhe përgjithësisht shihen si terma të një fushe të caktuar e cila bëhet e përbashkët për disa gjuhë që kanë marrë sendin apo dukurinë në fjalë, pa pasur mundësi zëvendësimi. Gjithmonë, duke pasur parasysh faktin e ngritjes së kulturës gjuhësore, shoqërore e historike, jemi të vetëdijshëm që me zhvillimin e teknologjisë, shumë shprehje dhe huazime i kemi të futura në leksikon tonë të përditshëm, ngase, he për he nuk kemi bërë ndonjë zbulim tonin që t'i vëmë emrin këtyre objekteve. Por edhe jeta e komunikimi i përditshëm ka patur prurje të fjalëve të huaja nga gjuhë të ndryshme si edhe rifutje në përdorim e disa huazimeve të cilat nuk përdoren prej kohësh nga shqipfolësit.

Studimit të huazimeve u është kushtuar rëndësi nga mjaft gjuhëtarë si: Aleksandër Xhuvani "Për pastërtinë e gjuhës shqipe", "Vepra", Edmond Tupe "Fjalë e struktura të huaja: (kundër) veprimi i shqipes", Emil Lafe "Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë", "Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare", Eqrem Çabej "Për pastërtinë e gjuhës", Gjovalin Shkurtaj "Normëshkelësit duhet të përgjigjen për dëmin që i shkaktojnë gjuhës shqipe", "Shqipja e sotme", Jani Thomai "Për pastërtinë e fjalorit të gjuhës sonë letrare", Mehmet Çeliku "Për pastërtinë e shqipes dhe fjalët e huaja në përdorim", Seit Mansaku "Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme", Shaban Demiraj "A ka ndikime të huaja në strukturën morfologjike të shqipe", Shezai Rrokaj, "Çështje të gjuhës shqipe 2", "Çështje të gjuhës shqipe 3" etj.

Në punimet e tyre huazimet janë parë në të gjitha rrafshet gjuhësore, të huazuara nga disa gjuhë dhe në periudha të ndryshme kohore. Më poshtë po rendisim gjuhët prej

të cilave shqipja ka marrë fjalë dhe për secilën do të japim studimet që janë bërë për huazimet e marra nga ajo gjuhë dhe disa shembuj.

2.3.1 Huazime sllave

Gjuhëtarët të cilët kanë shprehur interes për studimin e huazimeve sllave në shqipe janë Anastas Dodi “Rreth huazimeve sllave dhe vendit të tyre në gjuhën shqipe”, Emil Lafe “Vendi i orientalizmeve ndër huazimet e shqipes” dhe Xhelal Ylli “Ndihmesë për inventarin e huazimeve leksikore sllave të gjuhës shqipe”, “Rreth vendit të sllavizmave në gjuhën letrare shqipe”.

Disa sllavizma në gjuhën shqipe që vazhdojnë të përdoren ende në këtë periudhë janë: *grusht, zakon, prag, lopatë, mace, trup, nevojë, kosh, çekan, gozhdë, breg, gjobë, sitë, bujar, kulaç, kosë* të cilat nuk kanë gjegjëse në gjuhën shqipe, dhe si të tilla nuk mund t’i largojmë pasi gjuha ka nevojë për to. Ndërsa fjalët *kyç (dry, çelës), kastravec (trangull), kokosh (gjel), vazhdoj (vijoj), vadit (ujit), brazdë (hulli), prashit (skalit dheun)* i kanë gjegjëset e tyre në shqipe dhe lehtësisht mund të zëvendësohen.

2.3.2 Huazime turke

Ištva Shütz “Liberalizim apo ndërhyrje në zhvillimin e gjuhës”, dhe Lindita Latifi, “Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit” janë dy ndër studimet që janë marrë me huazimet turke në gjuhën shqipe. Disa shembuj të huazimeve turke që vazhdojnë të përdoren ende në ditët e sotme janë: *Avash (ngadalë), bahçe (kopsht), bahçevan (kopshtar), dembel (përtac), komshi (fqinj), karshi (përballë)*, të cilat vazhdojnë të përdoren edhe sot gjerësisht në shqipe. Ndërsa fjalët *çiban (i thatë që del në trup), eksiq (i metë), gjyzlykë (syze), hala (ende), hazër (gati), kollaj (lehtë), llagap (mbiemër), okllai (petës), sahat (orë) sahatçi (orëndreqës), tebeshir (shkumës), në sajë (nën hijen tënde), dhaskal (mësues), jatro, bakall* po përdoren më rrallë ose nuk po përdoren fare.

2.3.3 Huazime nga anglishtja

Huazimet angleze i ka studiuar në punim të veçantë Hajri Shehu “Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze”, “Rreth anglicizmave në mjetet e informimit masiv” dhe një punim i plotë nga Vesel Nuhiu “Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe”. Gjatë vëzhgimeve kemi vënë re se huazimet angleze përgjithësisht nuk shërbejnë si tema për formimin e fjalëve të reja, sepse elementi i huaj është joprodhimtar në fushën e fjalëformimit.²²

Disa anglicizma në gjuhën shqipe të kësaj periudhe janë: *boks meç (ndeshje boksi), air conditioner (ajërdhënës), handicap (pengesë), singëll (tek, beqar), spiker (folës), shopping (pazar, blerje), shopping center (qendër tregtare), kloun (palaço), slogan (parullë), uikend (fundjavë), copyright (e drejta e autorit), flash (shkurt), suport (mbështetje, përkrahje), start (nisje), finish (mbërritje), kros (vrapi ne*

²² Hajri Shehu, *Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze*, Gjuha jonë 1, 1989, f. 46.

natyrë), pasoj (kaloj), golavarazh (numri i golave), stop (ndalo), trajner (stërvitës), flirt (dashuriçkë, lajkë), trend (prirje), hepi end (fund i lumtur), smog (tym, mjegull), menaxher (udhëheqës), horror (tmerrues), implementoj (zbatoj), involvoj (përfshij), live (drejtpërdrejt), kalkuloj (llogaris), on line (në linjë), pasuord (fjalëkalim) etj.

2.3.4 Huazime nga italishtja

Me italianizmat është marrë në disa punime studiuësja Kristina Jorgaqi, konkretisht “Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde”, “Rreth përshtatjes morfologjike të huazimeve italiane në shqipen standarde” dhe “Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme letrare”. Marrëdhëniet mes shqipes dhe italishtes janë rreth 10-shekullore, për këtë arsye huazimet nga italishtja janë edhe më të shumta në numër.

Disa italianizma të futur në gjuhën shqipe, të rikthyera në shqipe apo italianizma që po vazhdojnë të përdoren ende janë: *dirigjoj (drejtoj), divorc (ndarje), emetoj (nxjerr), frekuencë (shpeshtësi), impotencë (pafuqi), kosto (rrezik), kuartet (katërshe), obligacion (detyrim), ofertë (propozim), rivendikoj (marr hak), okupacion (pushtues), abandonoj (braktis), ambient (mjedis), aplikoj (zbatoj), aprovoj (miratoj), autokton (vendas), dedikoj (kushtoj), arbitër (gjyqtar), densitet (denduri), devocion (përkushtim), dimension (përmasë), fantazi (imagjinatë), fenomen (dukuri), kapriço (tekë), gusto (shije), influencë (ndikim), kontribut (ndihmesë), komunitet (bashkësi), kualitet (cilësi), koordinoj (bashkërendoj), mentalitet (mendësi), moment (çast), neutral (asnjanës), nocio (koncept), ofendoj (fyej), pasagjer (udhëtar), penetroj (depërtoj), portofol (kuletë), prenotoj (rezervoj), i singertë (i çiltër), tavolinë (tryezë), vigjilje (prag), ambulancë (shëtitës), legjendë (gojëdhënë), esencë (thelb), asimilohet (përvetësoj), apel (thirrje), barsoletë (gazmore), bravo (të lumtë), duel (dyluftim), firmë (nënshkrim), sakrifikoj (flijoj), sforco (përpjekje), pastiçeri (ëmbëltore), salutoj (përshëndes) etj.*

2.3.5 Huazime nga greqishtja e re

Studuësit që janë marrë me huazimet nga greqishtja janë Seit Mansaku, “Rreth elementeve të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe”, dhe Sofia Delijorgji, “Pasqyrimi leksikografik i huazimeve greke në gjuhën shqipe”.

Disa huazime nga greqishtja që po vazhdojnë të përdoren në këtë periudhë janë: *fenomen (dukuri), farmak (i hidhur), gjithë (fqinj), fanitet (zhdukjet), igrasi (lagështirë).*

Më poshtë po rendisim edhe disa njësi frazeologjike greke me burime të ndryshme, si:

1. Me prejardhje nga mitologjia e grekëve të lashtë: *flet nga maja e Olimp, pëlhura e Penelopës, kutia e Pandorës, zjarri i Prometeut, thembra e Akilit, kali i Trojës, kompleksi i Edipit etj.*
2. Me burim biblik si: *gjykimi i Solomonit, si Shën Thomai mosbesues, molla e Adamit, mollë e ndaluar, toka e premtuar, arka e Noes, kopshti i Edenit etj.*
3. Me burim nga filozofia, letërsia etj: *nga alfa tek omega, alfa dhe omega, fluturim pindarik, dashuri platonike, ironi sokratike etj.*

4. Me burim nga gjeografia, historia: *si fitore e Pirros, si beteja e Termopileve, vrapim Maratone* etj.²³

2.3.6 Huazime nga frëngjishtja

Disa fjalë të huazuara nga frëngjishtja të cilat përdoren nga shqipfolësit të futura të reja apo që vazhdojnë të përdoren pas futjes së tyre para shumë kohësh janë: *garden, gravitet, fasadë, eveniment, etazher, eufoni, elozh, ekzemplar, ekzigjencë, ekzistencë, ekzekutoj, ekzagjeroj, ekzakt, eksplozon, , ekspozitë, ekspresion, ekstrem, efektiv, deziluzion, dekurajoj, ilaritet, imponant, konfeksione, konfirmoj, mortalitet, natalitet, neglizhencë, perfekt, persekutoj, prezantoj, prononcoj, refuzoj, suprimoj, survejoj* etj.

2.4. Ndërkombëtarizma

2.4.1 Terma ndërkombëtarë nga burimi grek

Nga greqishtja kemi këto ndërkombëtarizma p.sh. *antonim, aritmetikë, atom, botanikë, fizikë, filozofi, fonetikë, gastronomi, gramatikë, gjeologji, gjeometri, gjimnastikë, hemisferë, hidrologji, hipotezë, optikë, termometër* etj.

2.4.2 Terma ndërkombëtarë me një element grek e një latin

Ndërkombëtarizma që janë të përbërë nga një element grek e një latin janë këto fjalë: *astro-logji, astro-naut, astro-nomi, plani-metri, radio-grafi, radio-skopi* etj. dhe fjalë nga një element latin e një grek janë: *hidro-karbur, hidro-central, mono-nuklear, mono-plan, mono- valent* etj

2.4.3 Terma ndërkombëtarë nga burimi roman

Në gjuhën shqipe disa fjalë të burimit roman mund të përmendim: *freno, evolucion, revolucion, bas, kanto, soprano, tenor* etj.

2.4.4 Terma ndërkombëtarë nga burimi anglez

Shumë terma të sportit e kanë burimin nga gjuha angleze si: *basketboll, futboll, hendboll, volejball, sport* etj.

²³ Sofia Delijorgji, *Pasqyrimi leksikografik i huazimeve greke në gjuhën shqipe*, Kërkime gjuhësore, Konferencë shkencore ndërkombëtare, 31 maj 2012, Tiranë, f. 16-17

KREU III

3.1 Rëndësia e pastërtisë së gjuhës shqipe

Çdo njeri është pjesë e një shoqërie, qoftë kjo e madhe në numër apo e vogël, me të cilën e ka të domosdoshme të komunikojë në çdo hap të jetës së tij për të përmbushur nevojat jetike të përditshme. Për të komunikuar e ka të nevojshme të përdorë një gjuhë të njëjtë me shoqërinë ku ai bën pjesë, pasi në të kundërt nuk mund të realizohet komunikimi. Në qoftë se folësi gjatë komunikimit përdor fjalë të huaja, të cilat dëgjuesit nuk ua dinë kuptimin apo e marrin kuptimin e këtyre fjalëve të shtrembëruar sipas njohurive që kanë, mund të themi me siguri se nuk është arritur komunikimi, sepse mesazhi nuk është marrë i plotë dhe i saktë. Kjo është një arsye, e cila na vë përballë përgjegjësisë për të mos përdorur fjalë të huaja, sepse mund të lindin keqkuptime si në rastin, p.sh., kur dikush dëgjon fjalën *kuroj* në shprehjen *kuroj veshjen time*, ai/ajo që nuk ka njohuri të gjuhës nga është marrë fjala, konkretisht të italishtes, i duket e pakuptueshme, madje e çuditshme se si mund të “kurohet” veshja, pasi ai apo ajo e njeh si fjalë që përdoret në mjekësi p.sh. *kuroj / shëroj një sëmundje*.

Sot jetojmë në një botë të lirë, ku secili ka të drejtë të thotë atë që mendon, por askush nuk ka të drejtë të shpërftyrojë gjuhën, pasuri e të gjithëve, vetëm se ka zënë një pozicion publik e fjalën e tij/të saj janë të detyruar ta dëgjojnë një masë e madhe njerëzish. Ky numër i konsiderueshëm fjalësh të huaja që janë futur në leksik çon në situata të paqarta komunikimi. Disa persona publikë i përdorin fjalët e huaja për t’u treguar të kohës a modernë.

“Liria e fjalës është e lidhur ngushtë me lirinë e personit, po edhe me të drejtat e detyrat e secilit njeri si qytetar, si anëtar i një bashkësie shoqërore të caktuar, si edhe me traditat më të mira etnokulturore e gjuhësore të çdo populli. Kjo parakupton dhe na bën të theksojmë me forcë se liria e fjalës nuk do të thotë shthurje e gojës”.²⁴

Është e vërtetë që gjuha shqipe ka nevojë të përdorë çdo ditë e më shumë fjalë të reja, “...nuk është mirë të mbyllet shumë në vetvete, të mos huazojë fjalë e ndërtime të gjuhëve të tjera që shprehin nocione dhe koncepte të reja të botës moderne, por as nuk është mirë të përtpjë çdo element a strukturë të gjuhëve të huaja dhe të mbytet në artificializëm të çfarëdollojshëm”,²⁵ por duhet parë me vëmendje nëse kjo fjalë që po përdorim e pasuron gjuhën tonë apo e dëmton atë. Profesor Rexhep Qosja thotë se “gjuha shqipe standarde duhet të jetë e hapur: e hapur, në radhë të parë ndaj gjuhës popullore dialekteve, të folmeve të saj. Gjuha popullore është një thesar që vjen duke u shtuar dhe që kurrë nuk mund të shfrytëzohet deri në fund”.²⁶ Akoma më shumë sot, kur të gjithë shoqërinë e ka përfshirë globalizmi, duhet të punojmë për ta ruajtur dhe

²⁴ Gjovalin Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, Tiranë 2006, f. 51.

²⁵ Qemal Murati, *Shqipja përballë gjuhëve të tjera evropiane e rajonale- huazime leksikore dhe strukturore*, Aktet e Konferencës Shkencore- Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, f. 26

²⁶ Rexhep Qosja, *Kongresi i drejtshkrimit- tridhjetë vjet pas, Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë 2003, f. 41.

pasuruar gjuhën tonë, e cila është dhe një nga elementet kryesore që na ka identifikuar në shekuj dhe do të na identifikojë sot e në të ardhmen.

Ne e kemi për detyrë të shfrytëzojmë burimet e gjuhës popullore dhe të hedhim një gur në kështjellën e lashtë e të bukur të gjuhës shqipe, duke e pasuruar dhe pastruar, për ta bërë sa më të kohës e t'i përgjigjet kërkesave të sotme. “Thjeshtësia e pastërtia e gjuhës qëndron në të përdorun t'atyne fjalëve e konstrukteve, të cilat janë të përdorshme e të gjalla në gojë të popullit e që përdoren prej shkrimtarëve të tij të shquem e të përmendun”.²⁷

Profesor Gjovalin Shkurtaj shprehet se “...ashtu si kthjellimi pas kohës së keqe, duhet të vijë edhe në kulturën shqiptare një çast kthjellimi e sqarimi, duke marrë masat e nevojshme në plan të gjerë kombëtar për ta mbrojtur dhe përkujdesur me gjithë përkushtimin e nevojshëm qytetar e zyrtar këtë mjet tonin të përbashkët e të pavdirë të njëjtësisë shpirtërore, kulturore dhe etnike të kombit tonë”.²⁸

3.2 Mendimet e intelektualëve shqiptarë për huazimet ndër vite

3.2.1 Mendimet e poetëve shqiptarë për huazimet të shprehura në vargje

Gjergj Fishta “Gjuha shqype”²⁹

Pra mallkue njai bir shqyptari
që kët gjuh të Perënis
trashëgim që na la i Pari,
trashëgim s'ia len ai fimis;
edhe atij iu thaftë; po goja,
që e përbuzë këtë gjuhë hyjnore;
që n'gjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,
flet e t'veten len mas dore.
...Pra, shqyptarë çdo fes që t'jini,
Gegë e toskë, malci e qyteta,
gjuhën t'uej kurr mos ta lini,
Mos ta lini sa t'jetë jeta,
Por për të gjithmonë punoni”

²⁷ Emil Lafe, *Puna e profesor Aleksandër Xhuvanit për pastërtinë e gjuhës dhe rëndësia e saj për kohën tonë*, Gjuha jonë 2, 1990, f. 29. dhe “*Mbi thjeshtësinë e gjuhës*”, Vepra I, Tiranë, 1980, f. 18.

²⁸ Gjovalin Shkurtaj, *Normëshkelësit duhet të përgjigjen për dëmin që i shkaktajnë gjuhës shqipe*, Aktet e Konferencës Shkencore- Zbatimi i kulturës gjuhsëore në shqipen e shkruar, f. 10.

²⁹ Batjar Bega, Sokol Bega, *Malli për mëmëdhenë – Vargje të vjershëtorëve tanë kushtuar flamurit kombëtar; gjuhës shqipe, dashurisë për mëmëdhenë, bukurive të Shqipërisë e mërgimit*, Tiranë 2009, f. 31-33.

***Naim Frashëri "Korça"*³⁰**

Gjuha jonë sa e mirë!
Sa e ëmbël, sa e gjerë!
Sa e lehtë, sa e lirë!
Sa e bukur, sa e vlerë!
Perëndia na e lëntë
Përjetë ta trashëgojmë,
edhe kurrë mos e dhëntë
Ta humbim e ta harrojmë!

***Hilë Mosi "Gjuhës shqype"*³¹**

Gjuh'e ambël, gjuh'amtare,
Je e ambla gjuh'shqyptare!
Gjuh'e nalt' për Perëndi,
T'cilt ndër koh't që kahmot shkuene
Mbi Tomorr të përdoruene
Gjuh'e ambël, plot dashtni!
Gjuh'e shejt'e kaq e moçme,
shoqen tande kund s'e gjenë!
Zoti ty këtu t'ka çuemun;
kshtu gjithmon' ti ke me qenë
Gjuh'që t'foli Skëndërbegu,
Dhe ndër t'par'qe Naim Begu,
Që me shkrim t'pat lartësue
Ty t'kam' fol' shum kapidana,
Burra t'rrebt si t'ishin zana;
Gjuh'e rrebt, ti qofsh nderue!
Gjuh'e bukur si pranvera,
Ti s'do t'quhesh ma: e mjera;
Se na dona ty me t'rritë
Bashk' me t'jerat shoqe tueja,
Se ma s'dona zhele t'hueja
Veç duem ty me t'pa në dritë.

³⁰ Batjar Bega, Sokol Bega, *Malli për mëmëdhenë – Vargje të vjershëtorëve tanë kushtuar flamurit kombëtar; gjuhës shqipe, dashurisë për mëmëdhenë, bukurive të Shqipërisë e mërgimit*, Tiranë 2009, f. 37.

³¹ Batjar Bega, Sokol Bega, *Malli për mëmëdhenë – Vargje të vjershëtorëve tanë kushtuar flamurit kombëtar; gjuhës shqipe, dashurisë për mëmëdhenë, bukurive të Shqipërisë e mërgimit*, Tiranë 2009, f. 41

3.2.2 Mendimet e disa gjuhëtarëve shqiptarë për pastërtinë e shqipes

Dashamirësit e gjuhës shqipe që herët e kanë shprehur hapur admirimin për pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes dhe strukturat sintaksore e morfologjike të saj. Ndër vite gjuhëtarët kanë derdhur mundin e tyre në studimin e shqipes, duke u thelluar në të gjitha rrafshet e saj. Një ndër çështjet që ka zënë vend të konsiderueshëm në studimet e tyre kanë qenë fjalët e huaja dhe rëndësia e mbajtjes pastër të gjuhës shqipe. Disa nga mendimet e tyre po i rendisim më poshtë.

Aleksandër Xhuvani shumë vite më parë është shprehur: “Kjo gjuhë e popullit duhet studjue fellë e nga gjith’anët, që të dalë soje gjith’ ai material leksikologjik e frazeologjik i nevojshëm për shprehje të ndryshme në gjuhë të shkrimit e për t’ua zanë vendin fjalëvet e konstruktevet të hueja. Kjo punë e përdorimit në shkrim të një gjuhe shqipe me bazë nga thesari i gjuhës së popullit duhet të tërheqë gjithëmonë kujdesin e interesimin e gjith’ atyneve që marrin pendën e shkruajnë diçka”.³²

Edhe Budi në veprën e tij “Doktrina e krështenë” thotë se “ i hyni punës së hartimit të kësaj vepre edhe nga shkakun se gjuha arbneshe (sikurse quhej atëherë gjuha shqipe) po prishej ma fort nga pakujdesia e diesvet dhe letrorëvet t’saj kohe, të cilët, si duket, nuk e vritshin mendjen për punë të gjuhës, por e kishin lanë shkret”.³³

Shqetësimi i intelektualëve për hyrjen e fjalëve të huaja të panevojshme dhe ndërtimeve që nuk i shkojnë përshtat gjuhës shqipe ka qenë i pranishëm gjithmonë, kur më shumë e kur më pak. Në ditët e sotme, me këtë nivel kulturor e arsimor që kanë arritur shqiptarët, nuk duhet ta lëmë gjuhën shqipe të mbytet prej fjalëve të huaja, duke deformuar edhe ndërtimeve morfologjike e sintaksore të saj. Shumëkujt mund t’i duket normale, meqë gjuha shqipe është gjuhë në kontakt me gjuhët e tjera dhe, si e tillë, mund të marrë fjalë nga këto gjuhë, por marrja e fjalëve nuk duhet të jetë e pakontrollueshme pa kritere, sepse mund të marrim fjalë për të plotësuar hapësirat boshe në gjuhë, por jo t’i dyfishojmë ato.

Numri i huazimeve në gjuhën shqipe ka arritur të jetë aq i madh, sa “n.q.s nuk do të ishim në gjendje të identifikonim huazimet dhe përmes shoshitjes sonë, të mos i veçonim dot si të tilla, atëherë me shumë gjasë do ta mbivlerësonin masën e afrisë së gjuhëve përkatëse”.³⁴ Për rëndësinë e gjuhës shqipe Aleksandër Xhuvani thotë se “gjuha asht shenja e gjallë

e çdo populli dhe gjatë jetës së tij bahet vegël e çmueshme për kulturën e tij. Për këtë funksion të naltë që ka gjuha e popullit ka ndodhë që çdo popull, sikurse kujdesej për çdo gjë të vetën, të kujdeset edhe për gjuhën e vet, me qëllim që të zhvillohet e të lavrohet kjo sa ma mirë e të mbahet pastër nga çdo element i huaj, nga çdo gabim e nga shtrembërim, që mund të hynte mbrenda pa nevojë e që do t ja priste prigrigjinalitetin dhe bukurin’e saj. Për këtë pastërti të gjuhës, në gjithë popujt e kulturuem të botës janë ba

³² Aleksandër Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1956, f. 60.

³³ Po aty, f. 3.

³⁴ John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë 2001, f. 40.

në çdo kohë studime, bisedime e polemika për ta folë e për ta shkruar gjuhën e popullit sa ma drejtë e dritë, pa gabime e pa elemente të hueja”.³⁵

Studiuesi Istvan Shütz shprehet se “...fjalët e kulluara e të lashta të shqipes, të cilat nën ndikimin e masmediave mbeten në harresë dhe zëvendësohen me një ritëm sa vjen e më të shpejtë me fjalë të huaja të kota, me barbarizma, të cilat e fëlliqin gjuhën... u duhet ngritur patjetër një digë për të filtruar çdo pleh, çdo ndyrësi nga ujërat e kulluara të gjuhës”.³⁶ Profesor Shezai Rrokaj jep disa qëndrime që duhet të mbajmë ndaj huazimeve:

1. Të marrim vetëm atë që është e nevojshme dhe që i shërben funksionimit të jetës në bashkësinë shqipfolëse.
2. Të vendosim rregulla të qarta për zbatimin e parimit fonetik në drejtshkrim.
3. Të vendosim rregulla të qarta për zbatimin e parimit gramatikor.
4. Institucionet e shtetit (administrata, shkollat, qendrat kërkimore, mediat dhe letërsia, aktet normative etj.) duhet të mbrojnë me përgjegjësi kombëtare gjuhën amtare.
5. Vetë shoqëria duhet të nxisë vetëdijen gjuhësore shqipfolëse nëpërmjet kulturimit të përhershëm në gjuhën amtare.
6. Të vazhdohet me zgjerimin e standardit me prurje dialektore për të hapur edhe me bazën e tij gjuhësore e për të rritur në këtë mënyrë aftësinë e tij qëndrestare.³⁷

3.3 Zëvendësimi i fjalëve të huaja të panevojshme në shqipe

Një pjesë e konsiderueshme e huazimeve kanë mundësi zëvendësimi me fjalë shqipe ose shprehje frazeologjike. Huazimet e panevojshme që mund t'i zëvendësojmë me fjalë nga burimi i vetë gjuhës shqipe janë: *mjedisor* për *ambient*, *thirrje* për *apel*, *të lumtë* për *bravo*, *zbukurim* për *dekor*, *i saktë* për *ekzakt*, *i rremë* për *fals*, *i njëjtë* për *identik* etj.

Gjithashtu, fjalën e huaj mund ta zëvendësojmë me frazeologji të gjuhës shqipe, p.sh. *ngul këmbë* për *insistoj*, *vë në jetë* për *realizoj*, *ka gisht për është* i *implikuar*, *vërej* për *konstatoj*, *i nxori bojën* për *e demaskoi*, *e bën qimen tra* për *ekzagjeron* etj.

Studiuesit kanë dhënë edhe mundësinë e shqipërimit të disa mjeteve fjalëformuese, p.sh. shqipërimi i parashtesave **anti-**, **de-**, **dis-**, **dez-**, **inter-**, **ko-**, **multi-**, **pan-**, **poli-**, **super-** dhe prapashtesave **-al**, **-ant**, **-esk**, **-acion**, **-llëk**, **-xhi**, **-çi** p.sh.: *kundërajror*, *kundërgaz*, *kundërkontinental*, *bashkekzistencë*, *mbinjerëzor*, *kulturor*, *muzikor*, *natyror*, *studentor*, *diskutues*, *bakërpunues*, *orëndreqës*, *sharrëtar* etj., të cilat jo shumë kohë më parë përdorehin me parashtesa a prapashtesa të huaja.

Gjithashtu, mund të shqipërojmë edhe krejt fjalën bashkë me parashtesën a prapashtesën, si p.sh. *dispropocion* (*shpërpjesëtim*), *deziluzion* (*zhgënjim*), *internacional* (*ndërkombëtar*), *central* (*qendror*), *sahatçi* (*orëndreqës*) etj.

³⁵ Aleksandër Xhuvani, *Vepra I*, Tiranë 1980, f. 110.

³⁶ Istvan Shütz, *Liberalizëm apo ndërhyrje në zhvillimin e gjuhës*, Gjuha jonë 1-2, 2003, f. 63.

³⁷ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë 2014, f. 40.

Secili shqipfolës duhet të udhëhiqet nga parimi, që fjalë të cilat emërtojnë objekte a dukuri që hyjnë në vendin tonë nga vendet e tjera, aty ku është mundësia, të krijohen gjegjëse nga burimi i vetë shqipes, dhe vetëm kur nuk është e mundur të marrim fjalën e huaj, por njëkohësisht duke ia përshtatur shqipes.

Profesor Seit Mansaku është shprehur: “Mendoj se ka ende mënyra dhe mjete shprehjeje, togfjalësha dhe ndërtime sintaksore të gjuhës popullore a të folmeve dialektore që mund të pasurojnë dhe ta bëjnë më të gjallë, më të zhdërvjellët dhe më të larmishme

strukturën sintaksore të shqipes standarde, duke mënjanuar ndërtime stereotipa e klishe që tingëllojnë artificiale”.³⁸

Një mënyrë për të pastruar gjuhën shqipe është dhe krijimi i fjalëve të reja me burim të shqipes, por sipas ndërtimit të fjalëve të huaja që duhen zëvendësuar (kalket) p.sh. *fundjavë* sipas fjalës angleze *weekend*.

Për pasurimin e leksikut mund të përzgjedhim edhe fjalë shqipe që kanë qenë më parë, por për arsye të ndryshme kanë mbetur mënjanë. Por, e rëndësishme në këtë moment zhvillimi të shqipes, ku e kemi faktuar praninë e shumë huazimeve, është se “...duhen dalluar mirë ç’janë fjalë të huaja të panevojshme dhe ç’janë huazime a ndërkombëtarizma të pranueshme. Lidhur me këtë, natyrisht, kërkohet shoshitje e mirë e lëndës, maturim e qëndrime të peshuara në mënyrë që të bëhet pastrim i shoqëruar me pasurim të mirfilltë, pa cënuar askund dhe aspak aftësinë shprehëse, përndryshe po të bëjmë pastrim për pastrim do të ishte varfërim i gjuhës”.³⁹

3.3.1 Llojet e shqipërimit të huazimeve dhe kriteret që duhen zbatuar

Në gjuhën shqipe është punuar për zëvendësimin e fjalëve të huaja të panevojshme me fjalë shqipe, dhe zëvendësimi i tyre ka arritur të jetë disa llojesh:

1. Zëvendësimi tërësor dhe i plotë, kur çerdhja e fjalëve shqipe e zëvendëson plotësisht çerdhen e fjalëve të huaja në të gjitha kuptimet e përdorimet.
2. Zëvendësimi i plotë, por jo tërësor, kur njëra nga fjalët e çerdhes zëvendësohet plotësisht në të gjitha kuptimet, kurse folja nuk zëvendësohet ose zëvendësohet pjesërisht.
3. Zëvendësimi i pjesshëm, kur një fjalë zëvendësohet vetëm në disa kuptime.⁴⁰

Gjatë zëvendësimit të fjalëve të huaja duhet të kemi parasysh disa kriteret:

1. Kuptimi i fjalës shqipe duhet të përputhet ose të jetë i afërt me kuptimin e fjalës së huaj.
2. Duhet synuar që shqipërimet të jenë fjalë me kuptim të kapshëm nga masa e folësve. Në leksik është më e pranueshme një fjalë e re e formuar me mjetet e shqipes, sesa një fjalë pak ose aspak e njohur.

³⁸ Seit Mansaku, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 25.

³⁹ Gjovalin Shkurtaç, *Shqipja e sotme*, Tiranë 2010, f. 210.

⁴⁰ Emil Lafë, *Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë*, SF 4, 1984, f. 96-99.

3. Nuk këshillohet të krijohen nga e njëjta temë dy fjalë me kuptime të ndryshme e me tingëllim të ngjashëm.
4. Duhet të shmangen homonimet fjalëformuese d.m.th. fjalë të formuara nga po ajo temë e me po ato ndajshitesa, por me kuptime të ndryshme.
5. Fjala e huaj mund të përdoret krahas fjalës shqipe, kur ka ngjyrimë të veçanta kuptimore p.sh. *pastiçeri e ëmbëltore*.⁴¹

3.4 Qëndrimet kryesore të studiuesve kundrejt huazimeve

Ashtu si për shumë çështje të ndryshme, edhe për huazimet qëndrimet e gjuhëtarëve janë të ndryshme nëse duhen pranuar apo jo, t'i konsiderojmë si elemente me vlerë për pasurimin e gjuhës apo si element parazitari. Disa gjuhëtarë janë më tolerantë ndaj futjes së huazimeve, kurse disa të tjerë janë më konservatorë. Prof. Hajri Shehu shprehet: “Nuk jemi kundër vlerave të huazimeve angleze ose me prejardhje nga anglishtja që kanë hyrë ose që hyjnë në gjuhën e sotme shqipe si terma etj. dhe që kanë zënë a mund të zënë ndonjë qelizë të zbrazët në sistemin e gjuhës. Ne jemi kundër anglicizmave... të cilat... përdoren subjektivisht, pa vend e pa nevojë e që janë një e metë mjaft e spikatshme e mjaft e qortueshme e mjeteve të informimit masiv, sidomos të gazetarisë televizive, por edhe më shumë përkthimeve e botimeve ekonomike, financiare, informatike etj.... përpjekjet për zëvendësimin e anglicizmave në shtyp, televizione e radio duhet të jenë si ato të shekullit XIX për zëvendësimin e turqizimeve në gjuhën shqipe”.⁴²

Gjithashtu, ka edhe dy mendime ekstreme, si: Nuk duhet penguar vërshimi i çfarëdolloj hyrjeje të re, edhe pse vjen nga vullnetet e veçanta gjuhësore të shqipfolësve, pasi tek e fundit këto prurje janë edhe një shteg pasurimi për shqipen. Qëndrimi tjetër është ai konservator, që kërkon ta barazojë gjuhën me një normativë të palëvizshme e të mos pranojë asnjë fjalë të huaj.

Mendojmë se asnjëra nga të dyja mendimet nuk duhen të merren parasysh. Sipas mendimit të parë, duhet të lejojmë futjen e fjalëve të huaja, sepse është një mënyrë për pasurimin e shqipes, por ky pasurim çon në tkurrjen e gjuhës shqipe duke u lënë dorë të lirë gjuhëve të tjera ta “pushtojmë” shqipen. Por, gjuha shqipe është e të gjithëve dhe nuk mund të varet nga vullnetet e veçanta të disa shqipfolësve pro huazimeve. Edhe mendimi i dytë është i pamundur të realizohet, pasi vendi ynë është në kontakt të përditshëm me vendet e tjera e njëkohësisht dhe me gjuhët e tyre, sidomos me anglishten si një gjuhë që përdoret në shumë vende, dhe nuk mund të qëndrojë tërësisht e pastër.

Ndërsa profesor Xhevat Lloshi jep mendimin “...jo të ngecim te ideja e ngulitur: është huazim i panevojshëm të mos e pranojmë! ...Folësi do të ketë horizont aktiv (ose veprues, të gjallë, siç do ta kërkonte libri i pastërtisë) më të gjerë, i cili ndihmon për të kuptuar më mirë edhe kulturën e huaj, edhe kulturën shqipe, lidhjet e tyre dhe madje zhvillimet e mëtejshme në rrethanat e botës pa kufij të dhunshëm”.⁴³

⁴¹ Po aty, f. 96-99.

⁴² Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e sotme të informimit masiv*, SF 3-4, 2002, f. 92.

⁴³ Xhevat Lloshi, *Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike*, Tiranë 2003, f. 92

Qëndrimi më i duhur dhe më i logjikshëm është qëndrimi i mesëm apo e mesmja e artë, sipas të cilit nuk duhen pranuar fjalët e huaja, kuptimi i të cilave mbulohet plotësisht tashmë me fjalë të shqipes dhe nga ana tjetër, nuk duhet të jemi ekstremistë në pastërtinë e gjuhës duke mos pranuar asnjë fjalë të huaj.

Pra, duhet të marrim fjalë të huaja që plotësojnë vendet bosh në gjuhën shqipe, por gjithmonë duke i përshtatur me strukturën e gjuhës shqipe dhe nuk duhet të pranojmë fjalë të huaja për të cilët ka gjegjëse në shqip.

3.5 Si t'i parandalojmë fjalët e huaja të panevojshme

Hyrja në gjuhën shqipe e fjalëve të huaja të panevojshme tashmë është një fakt i pakundërshtueshëm, kështu që na duket e arsyeshme të japim disa alternativa se si mund t'u vëmë fre, ta ngadalësojmë këtë dukuri, pasi është e pamundur ta frenojmë plotësisht depërtimin e huazimeve.

Të gjithë e kemi cilësuar median si pushtetin e katërt, pasi ka një fuqi të madhe ndikuese. “Në çdo vend media luan një rol pararojë me proceset zhvilluese të gjuhës, sepse ajo është e lidhur ngushtë e drejtpërdrejt me jetën, me veprimtarinë e njerëzve”.⁴⁴ Këtë gjë e kemi të vërtetuar meqenëse një nga rrugët e hyrjes apo përhapjes në masë të gjerë të huazimeve është media. Duke qenë një fuqi kaq e madhe ndikuese, mund ta përdorim si një mënyrë për t'i treguar masës së gjerë se si duhet ta flasim e shkruajmë gjuhën tonë saktë, qartë e pastër.

Kjo mund të realizohet duke transmetuar një emision televiziv apo radiofonik për çështje të përditshme të gjuhës dhe thelbësore, për ta ruajtur atë sa më mirë dhe për ta përshtatur me kërkesat e kohës në mënyrë të drejtë dhe pa e deformuar.

Po ashtu, nëpër gazeta mund t'i kushtohet një artikull i veçantë një herë në javë, ku gjuhëtarët të shkruajnë se si është mënyra më e mirë për ta përdorur gjuhën shqipe, të japin disa rregulla drejtshkrimore dhe të tregojnë cilat fjalë që ne po dëgjojmë e flasim sot janë të huaja dhe si mund t'i zëvendësojmë ato.

Mund të bëhet një punë e tillë si një fjalorth me fjalë të huazuara të panevojshme dhe gjegjësen e tyre në gjuhën shqipe, siç bëhet tek revista “Gjuha jonë”. Por mendojmë se ndikimi që ka ky fjalorth tek lexuesit do të jetë më i madh tek shtypi i shkruar i përditshëm, se sa tek revista “Gjuha jonë”, pasi gazetat e përditshme kanë një numër më të madh lexuesish.

Ky lloj fjalorthi mund t'u shërbejë dhe vetë gazetarëve apo redaktorëve, që të shkruajnë në mënyrë të saktë e të kuptueshme për shqiptarët e të gjitha niveleve arsimore, duke ngulitur normën gjuhësore tek një masë e gjerë folësish, të cilët lexojnë shkrimet e tyre.

Gjithashtu mund të bëhen trajnime të shpeshta të mësuesve që japin mësim gjuhën shqipe në arsimin parauniversitar, pasi ata janë një mënyrë e mirë për të dhënë njohuri

⁴⁴ Emil Lafe, *Gjuha e medias sot-probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 11.

sa më të sakta të gjuhës shqipe dhe të ngulitjes sa më mirë të saj, sepse “shkolla qëndron në majë të veprave më madhore që ka krijuar njeriu... si fidanishtja e parë, ku nisin të marrin jetë filizat e porsalindur të gjuhës sonë amtare”.⁴⁵

Një vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet përkthyesve dhe librat që ata përkthejnë. Përkthyesi nuk duhet që të dijë vetëm gjuhën e huaj, gjuhën në të cilën është shkruar libri që do të përkthejë, por duhet të ketë edhe njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, të pasurisë së leksikut, të ndërtimeve morfologjike e sintaksore, për frazeologjinë dhe njohuri të mira të rregullave drejtshkrimore dhe jo t’i përkthejë si t’i vijë për mbarë.

Subjekteve të ndryshme para se t’u jepet licenca për të filluar një aktivitet, duhet t’u kërkohej rreptësisht të përdoret gjuha shqipe dhe emërtimi i aktivitetit të jetë shkruar në gjuhën shqipe.

Mbi të gjitha këtu qëndron shteti dhe ai duhet të hartojë disa ligje më specifike për përdorimin e gjuhës shqipe, duke vendosur se çfarë masash duhen marrë ndaj atyre që nuk e përdorin ashtu siç e kanë për detyrë shqipen.

E rëndësishme dhe e domosdoshme është ngritja e institucioneve shtetërore për të mbrojtur gjuhën dhe marrjen e masave ndëshkuese ndaj atyre personave që nuk e përdorin drejt atë sipas rregullave. “Rreziku që i kanoset sot shqipes nuk janë aq fjalët që hyjnë prej gjuhëve të tjera se sa kufizimi i përdorimit të saj; marginalizimi, në daçi “dialektalizimi” përballë gjuhësh të tjera “të mëdha”, e sidomos përballë anglishtes, për sa kohë s’përdoret atje ku i takon. Një politikë voluntariste e mbrojtjes së shqipes nëpërmjet ligjit duhet të shihet vetëm si pjesë e një strategjie gjuhësore komplekse, që duhet përpunuar sa më shpejt”.⁴⁶

Secili nga ne e ka për detyrë ta përvetësojë e ta përdorë drejt gjuhën standarde dhe të japë kontributin e tij modest për ta mbrojtur dhe zhvilluar më tej atë. Mbi të gjithë këtë përgjegjësi duhet ta ndiejnë punonjësit e medias dhe personat që kanë zë publik, pasi një ndër elementet e parë që vihen re tek një njeri i mirëarsimuar është mënyra se si ai/ajo e flet gjuhën e tij.

Profesor Xhevat Lloshi jep dy detyra për shqipfolësi në ditët e sotme: “Detyra e parë është ta ripohojmë shqipen standarde si mjetin themelor të kulturës shqiptare, ta lëvrojmë, ta përpunojmë më tej. Po ta shpreh ndryshe, hapi i parë i domosdoshëm është: ta ngremë në shkallën që i përket prestigjin e gjuhës standarde, duke nisur me rrethin e gjuhëtarëve e të gjithë atyre që kanë zë publik në këtë fushë, dhe vetëm pas kësaj do të mund të ndërtojë edhe përdoruesit e shqipes standarde, duke u ngjitur deri te institucionet shtetërore e publike... Detyra e dytë është ta bëjmë shqipen standarde të përshtatshme për nevojat dhe kërkesat e mijëvjeçarit të ri...ka nevojë për ndryshime kundrejt rrjedhave të derisotme”.⁴⁷

⁴⁵ Luan Babameto, *Ta pastrojmë e pasurojmë gjuhën tonë*, Tiranë 2008, f.18.

⁴⁶ Kristina Jorgaqi, *Sportel i hapur i shqipes*, Tiranë 2008, f.318.

⁴⁷ Xhevat Lloshi, *Shqipja gjuhë e hapur dhe dinamike*, Tiranë 2003, f. 88.

KREU IV

4. Shqipja përballë huazimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni

4.1 Gjendja e gjuhës shqipe dhe huazimet në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni

Huazimet si dukuri mbarëbotërore i kemi vëzhguar edhe në Kosovë e Maqedoni. Si material burimor kemi marrë disa gazeta të viteve të fundit në të tria vendet, duke parë sa fjalë të huaja përdoren në to, ku dallojnë dhe a përputhen huazimet e këtyre tri vendeve, të cilat si pjesë të përbashkët kanë gjuhën shqipe. Gazetat që kemi hulumtuar janë gazeta “Shqip” 14 qershor 2012 dhe gazeta “Panorama” 25 korrik 2012 në Shqipëri, gazeta “Bota sot” 15 qershor 2012 dhe gazeta “Express” 15 qershor 2012 në Kosovë, gazeta “Koha” 31 gusht 2012, “Zhurnal” 31 gusht 2012 dhe gazeta “Lajm” 31 gusht 2012 Maqedoni.

Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia janë vende me një popullsi që kanë përjetuar histori të ndryshme në rrjedhë të kohëve, por e rëndësishme është qenësia e një gjuhe të përbashkët. Tashmë nuk duhet të luftojmë kundër ndokujt, por thjesht kundër dëshirës sonë, dalë këto vitet e fundit për ta “mbytur” atë me shumë fjalë të huaja të panevojshme. Themi fjalë të huaja të panevojshme, për të bërë dallim nga huazimet e tjera për të cilat gjuha shqipe i ndien të nevojshme për t’i përdorur, pasi nuk ka fjalë të vetat.

Në të tria vendet është vënë re një prirje e shqipfolësve që të përdorin mjaft fjalë të huaja si pasojë e faktorëve politiko-shoqërorë. Shumica e tyre përgjithësisht janë marrë nga anglishtja, italishtja dhe më pak nga frëngjishtja.

Kjo nuk e ndihmon aspak komunikimin, pra gjuha nuk e kryen plotësisht funksionin e saj për të ndihmuar njerëzit të realizojnë aktin e komunikimit, sepse shpeshherë këto fjalë nuk përdoren saktë.

Ka mjaft raste kur çdo lexues do të vinte në dyshim njohuritë e tij, nga ajo çfarë lexon apo dëgjon, si në rastin që do të citojmë më poshtë nga gazeta “Shqip” në Shqipëri: “Nevoja për të mos proceduar me mbushje të *vakancave* për postet ministrore”.⁴⁸

Lexuesi që nuk njeh gjuhën italiane në këtë rast nuk do të kuptonte asgjë, por edhe ai që e njeh fjalën *vacanza* do ta përktente *pushime*, gjë që nuk ka asnjë lidhje me kuptimin e fjalisë. Në qoftë se do të shikojmë me vëmendje në artikull, disa fjali më tutje hasim fjalën *vakant*. “Zgjedhja e kreut të shteti dhe ngelja e një vendi *vakant* në kabinet” dhe vetëm ata lexues që dinë italisht e kuptojnë se po flitet për një vend bosh, të lirë. Pra, nga huazimi *vakant* ky autor është munduar të formojë fjalën *vacanza*, që ka një kuptim krejt tjetër nga ajo çka ai kërkon të transmetojë. Kjo është një dukuri, e cila ndodh shpesh tek ata që përdorin huazime pa ia ditur mirë kuptimin apo që mundohen të krijojnë fjalë të reja prej tyre. Tashmë me këta botues “modernë”, me sa

⁴⁸ Gazeta “Shqip” 14 qershor 2012, f. 1.

duket, duhet të lexojmë një paragraf a mos më shumë, për të nxjerrë kuptimin e një fjale të vetme të përdorur krejt pa kuptim.

Në të njëjtën trysni të futjeve të fjalëve të huaja janë edhe Kosova e Maqedonia, te gjuha e të cilave, përveç ndikimit të serbishtes në Kosovë e maqedonishtes në Maqedoni, ka ndikim po aq të konsiderueshëm dhe fjalët nga anglishtja, italishtja e frëngjishtja.

4.2 Shembuj huazimesh të panevojshme nga gazetat e tri vendeve

Nga gazetat e tri vendeve kemi nxjerrë disa fjalë të huaja, të cilat po i japim në fjali, që të merret më mirë konteksti në të cilin ato janë përdorur. Për secilin shembull kemi dhënë edhe gjegjësen në shqipe, çfarë do të thotë se ato mund të zëvendësohen lehtësisht dhe pa problem, gjë të cilën botuesit e këtyre të përditshmeve nuk kanë parapëlqyer ta bëjnë apo nuk e kanë një ndër kriteret a përparësitë e punës së tyre.

“**Tentova** t’i thërrisja atij për ndihmë, por nuk kisha fuqi” (**U mundova** t’i thërrisja atij për ndihmë, por nuk kisha fuqi), gazeta “*Shqip*”, 14 qershor 2012, faqe 7.

“Zgjedh një president kukull, duke **avancuar** projektin e tij” (Zgjedh një president kukull, duke **përparuar, ecur përpara** me projektin e tij), gazeta “*Shqip*”, 14 qershor 2012, faqe 9.

“I jep **komoditetin** Gjermanisë” (I jep **rehatinë** Gjermanisë), gazeta “*Shqip*”, 14 qershor 2012, faqe 22.

“Aq më tepër për **sensibilitetin** që ka SHISH” (Aq më tepër për **ndjeshmërinë** që ka SHISH), gazeta “*Panorama*”, 25 korrik 2012, faqe 2.

“Program edukues dhe **aktivitetet** deri te kreditet e Maturës Shtetërore” (Program edukues dhe **veprimtaritë** deri te kreditet e Maturës Shtetërore), gazeta “*Panorama*”, 25 korrik 2012, faqe 6.

“**Fenomeni** negativ që vonon për shumë vite” (**Dukuria** negative që vonon për shumë vite), gazeta “*Panorama*”, 25 korrik 2012, faqe 20.

“Përbushjen e kriterëve dhe **obligimeve** të përcaktuara” (Përbushjen e kriterëve dhe **detyrimeve** të përcaktuara), gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, faqe 4.

“Artificializmi dhe gjetja e moduleve **inspiruese**” (Artificializmi dhe gjetja e moduleve **frymëzuese**), gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, faqe 5.

“Mund të ketë **komplikime**” (Mund të ketë **ndërlikime**), gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, faqe 5.

“Klane dhe grupe që duan të **dominojnë** në ekonomi” (Klane dhe grupe që duan të **mbizotërojnë** në ekonomi), gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, faqe 11.

“Kosova po prodhon produkte **kualitative**” (Kosova po prodhon produkte **cilësore**), gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, faqe 12.

“Të jetë **potent** edhe si zë” (Të jetë **i fuqishëm** edhe si zë), gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, faqe 20.

“Tre pikët do të jenë në **konton** e tyre” (Tri pikët do të jenë në **llogarinë** e tyre), gazeta “*Bota sot*” 15 qershor 2012, faqe 27.

“Ka rëndësi **vitale** për Evropën” (Ka rëndësi **jetësore** për Evropën), gazeta “*Ekspres*”, 15 qershor 2012 faqe 3.

“Një nga **benficionet (përfitimet)** është lirimi nga tatimi”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012 faqe 3.

“Për përpunim të studimeve dhe **revidentët (rishikuesit)** nga Fakulteti i ndërtimtarisë”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 4.

“Hedhjen e mbeturinave në vend **joadekuat (jo të përshtatshëm)**”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 5.

“Është **obligim (detyrim)** që del nga marrëveshja me komunat e tjera”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 5.

“Me qëllim të **efikasitetit (vlefshmerisë)** në dhënien e letërnjoftimeve”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012 faqe 6.

“Mendoj se do të jetë shumë **atraktiv (tërheqës)** që njeriu i kulturës të bëjë diçka që do të jetë në interes të turistëve”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 7.

“Nuk duhet të tërhiqemi dhe të **insistojmë (ngulin këmbë)** në formalizimin me të cilin e mbulojnë të gjitha dobësitë tona”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 8.

“Ka **indikacione (shenja)** që marrëveshjet do të arrihen para se palët të takohen publikisht”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 8.

“Është situatë e **komplikuar (ndërlikuar)** dhe shumë e rëndë”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 8.

“Dhurata është bërë në shenjë mirënjohjeje për **kontributin (ndihmën)** e banorëve”, gazeta

“Koha”, 31 gusht 2012, faqe 9.

“Ishin pikërisht kompanitë dhe **konzorciumet (grupimet)** ato që i kërkuan qeverisë të ndryshonte vendimin”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 11.

“Bondi **ispirues (frymëzues)**”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 13.

“Një klip përmbledhës të **eventeve (ngjarjeve)** të këtij viti”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 13.

“Është **konstant (i qëndrueshëm)** në jetën e tij”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 15.

“Duhet të përmirësojnë formën e tyre, nëse duan të **avancojnë (përparojmë)** më tej”, gazeta

“Koha”, 31 gusht 2012, faqe 19.

“Ne besojmë në **kualitetin (cilësinë)** e ekipit tonë”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 19. “Është një kënaqësi **enorme (e madhe)**”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 20.

“Në këtë **moment (çast)** jam i **koncentruar (përqendruar)** në ndeshjen e së dielës”, gazeta

“Koha”, 31 gusht 2012, faqe 20.

“**Insiston (ngul këmbë)** s’e nuk është hero”, gazeta “Koha”, 31 gusht 2012, faqe 21.

“Deklaron se **preokupimi (shqetësimi)** i kryeministrit është i madh”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 2.

“Mund të **konstatoj (zbuloj, vë re)** lirisht që qeveria funksionon”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 2.

“Degët kryesore u krijuan para se të përhapeshin dhe të **deversifikoheshin (shumëfishoheshin)** në rajone të tjera”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 4.

“Tashmë marrëveshja **bilaterale (dypalëshe)** dypalëshe mes dy vendeve ka hyrë në procedurë parlamentare”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 4.

“Kushtet e punës përcaktohen nga Rregullorja e posaçme nën **ingerencë (urdhrin)** të ministrit të ekonomisë”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 6.

“Në çdo çast **evitoi (shmangu)** termat”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 9.

“Për ne është **fundamentale (thelbësore)** dhe kjo tregohet përmes historikut të zhvillimit”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 9.

“Kërkon prirjen, **afinitetin (afrinë)** dhe **kreativitetin (krijimtarinë)** për diçka më shumë”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 10.

“Është **evidente (e dukshme)** edhe në Evropën e sotme”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 10.

“Një dalje e Greqisë do të kishte **kosto (çmim, vlerë) të pakalkulueshme (të pallogaritshme)**”, gazeta “Zhurnal”, 31 gusht 2012, faqe 10.

“**Demolohet (hidhet në erë)** vetura e redaktorit”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 1.

“Punimet do t’i vazhdojë në **ambientet (mjediset)** e studimeve të **disperzuara (shpërndara)**”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 4.

“Kjo kompani nuk **posedonte (zotëronte)** leje pune”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012 faqe 7. “**Obligon (detyron)** kompaninë në fjalë”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 7.

“Ndihmë do të ofrojnë dhe **donator (dhurues)** të tjerë”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 8.

“Paralajmërojnë se **intervenimet (ndërhyrjet)** përkatëse do të bëhen”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012 faqe 8.

“Manifestimi do të mbahet në disa **lokacione (vende)**”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 9.

“Sipas **sentencës (shprehjen, fjalinë)** “bashkimi bën fuqinë” që i duhet shtuar dhe “bashkimi bën fuqinë”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 10.

“Nuk janë vetëm numrat që e tregojnë **dimensionin (përmasat, madhësinë)** e një lufte”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 11.


“Jeton në një banesë me strehim të **subvencionuar (mbikëqyrur)**”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 28.

“Biseda e fundit me **adjutantit (ndihmësin)**”, gazeta “Lajm”, 31 gusht 2012, faqe 28.

Sipas një përlllogaritjeje matematikore ndërmjet faqeve të gazetës dhe numrit të huazimeve të panevojshme të gjetura në secilën gazetë, arrijmë në këto përfundime:

Tabela nr. 4.1. Numri mesatar i fjalëve të huaja për çdo faqe gazete

Emërtimi i gazetës	Numri i faqeve	Fjalë të huaja	Numri mesatar i fjalëve të huaja për çdo faqe
Ekspres (Kosovë)	32	82	3
Bota sot (Kosovë)	32	115	4
Panorama (Shqipëri)	23	86	4
Shqip (Shqipëri)	23	106	5
Lajm (Maqedoni)	31	84	3
Zhurnal (Maqedoni)	24	145	6
Koha (Maqedoni)	24	80	3



Grafik nr. 4.1 Numri mesatar i fjalëve të huaja për çdo faqe gazete

Numri i huazimeve është i konsiderueshëm, ku vlen për t’u nënvizuar shifra e gazetës “Zhurnal” të Maqedonisë, e cila është më e larta, por edhe të tjerat nuk mbeten më pas. Duam të theksojmë se tek numri i huazimeve nuk janë përlllogaritur sa herë është përdorur e njëjta fjalë brenda faqes apo gjithë gazetës, pasi shifra do të ishte shumë herë më e madhe.

4.3 Mënyrat e depërtimit të huazimeve në shqipen e tri vendeve

Sot nuk mund të kërkojmë pastërti absolute, pasi do të ishte e pamundur në këtë komunikim të përditshëm në shumë fusha, shtete e gjuhë të tjera, por kjo s’do të thotë të dëmtojmë gjuhën tonë, që është një nga gjërat më të rëndësishme e cila na identifikon në mbarë botën si shqiptarë.

Huazimet në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni kanë hyrë edhe si pasojë e globalizmit, ku anglishtja është gjuhë ndërkombëtare në të gjithë globin apo si pasojë e krenarisë

së pakuptimtë të disa personave, për të treguar se njohin gjuhë të huaja dhe i përdorin fjalët e këtyre gjuhëve kur duhen, por më shumë kemi vënë re kur nuk duhen përdorur.

Nga vëzhgimet kemi dalë në përfundime se shumica e huazimeve janë nga anglishtja, frëngjishtja e italishtja që është e përbashkët për të tre vendet, por në Kosovë dhe Maqedoni ka një ndikim dhe nga gjuhët me të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm, serbishtja dhe maqedonishtja.

Gjithashtu, ka mjaft fjalë të cilat janë të huazuara njëjloj si në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri, si p.sh. *obligim, inspirues, kualitative, vitale, atraktiv, preokupim, posedon, kreativitet* etj., por janë dhe disa të tjera që i kemi hasur tek gazetatat e Kosovës e Maqedonisë, të cilat në Shqipëri nuk njihen fare ose shumë pak, si p.sh. *azhurnimin, revidentët, konzorciumet, enorme, deversifikoheshin, ingerencë, demolohet, disperzuara* etj.

Në trevat e Maqedonisë ku jetojnë shqiptarët, huazimet leksikore sllave kanë depërtuar përmes institucioneve, kontaktit me institucionet dhe përmes bashkëjetesës, pasi maqedonishtja është gjuhë zyrtare. Në mungesë të shkollimit, në mungesë të administratës në gjuhën shqipe, kjo vjen si pasojë e jointitucionalizimit të shqipes si gjuhë zyrtare në këtë vend.

Brezi i vjetër, e me pak përjashtime edhe brezi i ri, disa turqizma i kanë zëvendësuar me sllavizma, si: *kadija-sudija, devrije-cuvar, aza-odbor, astahane-bollnicë* etj. Për një numër të madh personash të moshës së re, shumë fjalë turke janë të panjohura, por sllavizmat edhe sot e kësaj dite janë të pranishme te çdo shqipfolës në Maqedoni, ku nën ndikimin e institucioneve sllave, popullata vazhdimisht ka pasur nevojë të drejtohet në sportelet e administratës shtetërore, dhe vazhdojnë ato emërtime t'i përdorin si në gjuhën e administratës, si p.sh. *për certifikatë të lindjes thotë izvod, për vërtetim-potvrda*⁴⁹ etj.

Pavarësisht nga zhvillimet teknologjike, gjuha e shkruar është mjeti më i mirë për të siguruar komunikimin midis brezave, për të përcjellë përvojën nga brezi në brez. Për këtë arsye, ajo duhet të ruajë njëjtësinë e normës drejtshkrimore, përndryshe pas shumë vitesh, këto radhë që po shkruhen sot do të mund të lexohen vetëm nga filologët e specializuar.

⁴⁹ Sindorela Doli Kryeziu, Shpresa Dorda, Zarije Nuredini, *Ndikimet ndër-gjuhësore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni*, Konferencë Ndërkombëtare “Kërkime gjuhësore”, 4 korrik, Tiranë 2013.

KREU V

5. Shqipfolësit mes fjalës së huaj dhe shqipe

5.1 Pyetësi

Për të vëzhguar se sa i kuptojnë fjalët e huaja shqipfolësit, sa arrijnë t'u gjejnë një gjegjëse në shqipe dhe ku e kanë hasur më shpesh atë, kemi hartuar një pyetësor me 100 fjalë të huaja. Këto fjalë janë përzgjedhur nga fusha të ndryshme, si: jeta e përditshme, sporti, politika, jurisprudenca, mjekësia etj.

Pyetësi përmban këto fjalë: *agresiv, atribuojnë, salutoj, lançoj, imazhin, impakt, impenjuar, ingredient, inicim, insistoj, konfrontoj, dakordim, konsiston, obliguar, oponent, prezente, princip, rezistencë, stabilitet, luk, tentativë, uikend, vakant, adekuate, indirekt, inovacion, kontigjent, shoubiz, definitive, donator, eveniment, eviton, imediat, inspiruar, puntat, mentalitet, prioritet, strapacim, alegro, anoncuar, dominim, elokuent, aludim, memorie, merkato, fjala, performancë, klauzolë, afeksion, afinitet, afirmohem, akostoj, aparencë, aplikoj, asistoj, parevokim, koicidencë, bekgraund, borsë, rilevim, presekutim, destinacion, kortezi, difezë, disponoj, efikas, elaboroj, ezauroj, grataçel, implikoj, impresionoj, independencë, arbitër, ekzekutim, insuficiencë, itinerari, ilegal, kalkuloj, komplikoj, komercial, koncentroj, rivendikim, aksesorë, konfondo, konfuz, kontemporan, kontestoj, kreativ, kredibilitet, kualitet, ofezë, oportun, ospitoj, posedoj, rimors, sensibil, suportoj, violent, puntatë, konvenon, vital.*

Pyetësi është plotësuar nga persona të moshave, arsimimeve dhe zonave të ndryshme, banorë aktualisht në qytetin e Tiranës. Duke qenë me origjinë nga vende të ndryshme të Shqipërisë e bën më gjithëpërfshirës pyetësin dhe të dhënat që kemi marrë prej tij.

Të intervistuarit i kemi grupuar në këto kategori:

1. *Të intervistuar mbi moshën 35 vjeç / nën moshën 35 vjeç.* Kemi përzgjedhur këtë ndarje për të parë se sa janë të ndikuar personat që kanë qenë në një moshë të pjekur para viteve '90 dhe ata që nuk kanë lidhje me atë periudhë. Në periudhën para viteve '90 për gjuhën shqipe ka pasur vëmendje të veçantë, për shkak të sundimit të sistemit qeverisës diktatorial, i cili ka punuar fort për ta ruajtur të pastër gjuhën nga fjalët e huaja.
2. *Të intervistuar me arsim të lartë / të mesëm apo 8/9-vjeçar.* Niveli i arsimit është i rëndësishëm për pasurinë apo varfërinë e leksikut të secilit folës, sepse nëse ka mbaruar një arsim të lartë, në mënyrë të ndërgjegjshme apo jo ai/ajo fut në leksikun e përditshëm fjalë apo shprehje nga fusha ku është diplomuar. Në rast

se nuk ka njohuri të thelluara në një degë të caktuar, mungojnë këto lloj fjalësh në leksikun e tij/saj, detyrimisht dhe fjalët e huazuara, pasi është e pamundur që një degë e arsimit të mos ketë në terminologjinë e saj fjalë të huazuara, të cilat përgjithësisht si prirje e kohës përkapen lehtësisht nga shoqëria.

5.2 Analiza e rezultateve të pyetësorit

Në pyetësor kemi vendosur fjalë të cilat janë të përfshira në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, pra gjuha shqipe i ka pranuar tashmë si të nevojshme për të plotësuar vendet bosh, dhe fjalë të papërfshira në të, prej të cilëve 95% e të intervistuarve kanë arritur t'i dallojnë ato, kurse 5% jo.


Duke i kthyer përfundimet në përqindje, 56% e të intervistuarit nën moshën 35 vjeç kanë arritur të gjejnë gjegjësen e fjalës së huaj në gjuhën shqipe, dhe 44% prej tyre nuk kanë arritur ta gjejnë atë. Ndërsa të intervistuarit mbi këtë moshë vetëm 35% e tyre kanë arritur t'i gjejnë, kurse 65% jo.

5.2.1 Ku i hasim më shpesh fjalët e huazuara

Përgjigjen e kësaj pyetjeje të pyetësorit, se ku i hasin më shpesh fjalët e huazuara, po e japim më poshtë në mënyrë të përmbledhur në tabelë.

Tabela numër 5.1. Ku e kanë hasur më shpesh fjalën e huazuar të intervistuarit nën moshën 35 vjeç.


Radio	TV	Gazetë/ revistë	Bisedat e përditshme	Tjetër
10%	38%	21%	20%	11%



Grafiku numër 5.1. Paraqitja në mënyrë grafike e të dhënave në tabelën numër 4.1

Tabela numër 5.2. Ku e kanë hasur më shpesh fjalën e huazuar të intervistuarit mbi moshën 35 vjeç

Radio	TV	Gazetë/ revistë	Bisedat e përditshme	Tjetër
16%	36%	19%	24%	5%



Grafiku numër 5.2 Paraqitja në mënyrë grafike e të dhënave në tabelën numër 4.2


Sipas këtyre përfundimeve, del se televizioni dhe bisedat e përditshme zënë vendin më të madh ku përdoren huazimet e panevojshme. Ndikimi më i madh është i televizionit, i cili, për vetë funksionin që ai ka në shoqëri, është edhe një nga burimet kryesore të përhapjes së këtyre fjalëve të huaja, duke i shfaqur si prirje e kohës dhe mjaft tunduese për shikuesin.

5.2.2 Sa arrijnë t'i kuptojnë fjalët e huaja shqipfolësit?

Për të kuptuar se sa arrijnë t'i kuptojnë fjalët e huaja shqipfolësit, më poshtë kemi renditur rezultatet në përqindje për të dyja grupmoshat në tabelë dhe në mënyrë grafike.

Tabela numër 5.3. Sa arrijnë t'i kuptojnë këto fjalë të huaja shqipfolësit?

	Mirë	Shumë mirë	Nuk ia dinë kuptimin
Mbi moshën 35 vjeç	24 %	49 %	27%
Nën moshën 35 vjeç	22%	70%	8%



Grafiku numër 5.3. Paraqitja në mënyrë grafike e të dhënave në tabelën numër 4.3

Sipas grafikut shihet dukshëm se huazimet arrijnë t'i kuptojnë shumë mirë në një përqindje të konsiderueshme folësit nën moshën 35 vjeç, ndërsa kanë vështirësi të përkapin kuptimin në përqindje më të lartë folësit mbi moshën 35 vjeç.

5.2.3. Sa kanë arritur t'u gjejnë gjegjëset në shqipe huazimeve?

Vëmë re se të intervistuarit, të cilët kanë arritur të gjejnë gjegjëset në gjuhën shqipe e pjesës më të madhe të fjalëve, janë afërsisht të moshës 20-25 vjeç dhe vazhdojnë arsimin e lartë. Ndërsa të intervistuarit që kanë gjetur gjegjëset e vetëm 4-20 fjalëve të huazuara, janë rreth moshës 15-18 vjeç, pra vazhdojnë arsimin 9-vjeçar apo të mesëm. Na rezultoi vetëm një rast, me moshë 26 vjeç, me arsim të lartë, i cili ka gjetur sinonimin në shqip të vetëm 22 fjalëve, që bien në kundërshtim me shumicën dërmuese. Ky mund të jetë edhe ndonjë rast i veçantë, që për arsye të ndryshme nuk ka arritur të marrë njohuri të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Të intervistuarit mbi moshën 35 vjeç, të cilët nuk kanë arritur të gjejnë gjegjëset në gjuhën shqipe e vetëm të 2-8 fjalëve janë të moshës 40 vjeç dhe me arsim të lartë, kurse ata që kanë arritur të gjejnë gjegjëset shqipe vetëm të 14-29 fjalë gjegjëset e tyre në shqip, janë me arsim të mesëm dhe të moshës 55 vjeç.⁵⁰

Pra, sipas këtyre të dhënave arrijmë në përfundimin se ata persona që e kanë përfunduar apo vazhdojnë një arsim të lartë kanë më shumë mundësi për të kuptuar domethënien e këtyre fjalëve kudo që ato përdoren, kurse pjesa tjetër e cila përbën dhe pjesën dërmuese të shqipfolësve nuk arrijnë t'i kuptojë. Kjo përforcon faktin se përdorimi i fjalëve të huaja vështirëson komunikimin.

5.2.4 Fjalët më pak të njohura nga të intervistuarit

Fjalët që na rezultojnë më pak të njohura nga të intervistuarit janë: *afeksion, afinitet, dakordim, vakant, indirekt, strapacim, akostoj, parevokim, rilevim, elaboroj, insuficiencë, oportun, rimors, konvenon, obliguar, rivendikim, itinerary, puntatë, difezë, kontemporan, ospitoh, inovacion, adekuate, aludim, klauzolë, implikoj, konfondo, atribuoh, kredibilitet, kortezi*, sepse pjesa më e madhe e tyre nuk ia njeh kuptimin këtyre fjalëve ose nuk kanë arritur t'u gjejnë gjegjësen në shqipe.

Bashkësia shqipfolëse përbëhet nga nivele të ndryshme kulturore e arsimore, kjo është një arsye e fortë që ne duhet t'i përzgjedhim me kujdes fjalët që përdorim gjatë komunikimit për të qenë sa më të saktë për atë që duam të kumtojmë.

5.3 Çfarë duhet të bëjmë sipas përfundimeve që nxjerrim nga pyetësi

Ngritja e një pengese ndaj huazimeve të panevojshme fillon me ndërjegjësimin e folësve për t'u kujdesur për gjuhën e tyre, duke e pasuruar herë-herë me fjalë që ajo ka nevojë. Mjaft i rëndësishëm është standardi për të cilin profesor Shezai Rrokaj shprehet se “sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekënd dhe masës së folësve që e përdorin, aq më shumë rritet qëndresa ndaj trysnisë së huazimeve”.⁵¹

Çdo njeri jeton në një shoqëri, qoftë kjo e madhe në numër apo e vogël, me të cilën e ka të domosdoshme të komunikojë në çdo hap të jetës për të përmbushur nevojat jetike të përditshme. Për të komunikuar e ka të domosdoshme të përdorë një gjuhë,

⁵⁰ Shënim: Sasia e fjalëve që kemi marrë shembull janë përgjigjet më të pakta që kanë dhënë të intervistuarit.

⁵¹ Shezai Rrokaj, *Cështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, f. 122

e cila duhet të jetë e njëjtë edhe për shoqërinë ku ai bën pjesë, pasi në të kundërt nuk mund të realizohet komunikimi. Sipas Ledi Shamkut, “ky komunikim përmbushet plotësisht kur mendimet kodifikohen qartë e me rregullsi dhe kur ato dekodifikohen po aq qartë. Kështu ndodh kur folësi e ndërton mesazhin në bazë të një kodi të caktuar dhe dëgjuesi, që zotëron një kod, e interpreton me lehtësi atë”.⁵²

Në qoftë se ne gjatë komunikimit me të tjerë, përdorim fjalë të huaja të cilat bashkëbiseduesit tanë nuk ua dinë kuptimin apo e marrin kuptimin e këtyre fjalëve të shtrembëruar sipas njohurive që kanë, mund të themi me siguri se nuk kemi arritur të komunikojmë, pasi mesazhi nuk është marrë i plotë dhe i saktë. Ky është një fakt, të cilin duhet ta kemi parasysh, për të mos përdorur fjalë të huaja, sepse mund të lëmë hapësira për keqkuptime.

Shqetësimi i gjuhëtarëve për hyrjen e fjalëve të huaja të panevojshme dhe ndërtimet që nuk i shkojnë përshtat gjuhës shqipe ka qenë i pranishëm gjithmonë, kur më shumë e kur më pak. Në ditët e sotme, me këtë nivel kulturor e arsimor që kemi arritur, ka ardhur koha të reflektojmë për këtë dukuri, duke rritur ndërgjegjësimin e qëndresës ndaj tyre.

Si përfundim, mendojmë se këshillat e profesor Shezai Rrokajt dhe të Aleksandër Xhuvanit janë me vend dhe duhet të vihen në zbatim. “Në këto kushte del si domosdoshmëri vënia në qarkullim e formave, të cilat do të duhet mjaft kohë për t’u hapur ndaj gjithë bashkësisë së folësve. Për këtë gjë do të duhej doemos që i gjithë ky potencial fjalësh dhe strukturash të mos mbetet i panjohur për tërësinë e folësve; ai duhet të faktohet e të shpjegohet në dokumente të tilla siç janë fjalorët dhe gramatikat thesarë”⁵³ dhe “kjo gjuhë e popullit duhet studjue fellë e nga gjith’ anët, që të dalë soje gjith’ ai material leksiko-logjik e frazeologjik i nevojshëm për shprehje të ndryshme në gjuhë të shkrimit e për t’ua zanë vendin fjalëvevet e konstruktevet të hueja. Kjo punë e përdorimit në shkrim të një gjuhe shqipe me bazë nga thesari i gjuhës së popullit duhet të tërheqë gjithëmonë kujdesin e interesimin e gjith’atyne që marrin pendën e shkruajnë diçka”.⁵⁴

⁵² Ledi Shamku, *Standard dhe neostandard*, Tiranë 2007, f. 168.

⁵³ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, f. 74

⁵⁴ Aleksandër Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1956, f. 60.

KREU VI

6. Disa fusha ku kanë depërtuar huazimet

Huazimet kanë gjetur shtrirje të gjerë në të gjitha rrafshet gjuhësore në gjuhën shqipe dhe si rrjedhojë edhe terminologjia nuk kishte si ta shmangte një dukuri të tillë. Pas viteve '90 pati dyndje të huazimeve në shumë fusha, të cilat për t'i konkretizuar depërtimet e fjalëve të huaja në to ne kemi përzgjedhur 6 fusha dhe terminologjinë që ato përdorin, të tilla si: terminologjia administrativo-juridike, terminologjia gjuhësore, terminologjia e kulinarisë, terminologjia sportive, terminologjia informatike dhe terminologjia ekonomike.

6.1 Terminologjia administrativo-juridike

Vjelja e materialit të fjalëve të huaja, që i përkasin terminologjisë administrativo-juridike është bërë nga *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, *Kodi civil*, Tiranë 2010, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, *Kodi i procedurës penale*, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*.

Më poshtë fjalët e huaja i kemi dhënë në fjali, në mënyrë të tillë që të merret më mirë kuptimi të cilin ato transmetojnë.

“Marrëveshje ndërkombëtare të **ratifikuar** nga shteti shqiptar”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 10.

“Kur vepra penale kryhet nën **efektin** e narkotikëve”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 19.

“Kryerja e veprës i shtyrë nga **motive** të dobëta”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 35.

“Të mos **frekuentojë** vende të caktuara”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 42.

“Prokurori i kërkon gjykatës zëvendësimin e tyre me një **sanksion** tjetër”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 43.

“Çdo veprimtari që lidhet me heqjen dhe **implantimin** e paligjshëm të organeve”, *Kodi penal*

– *I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 58.

“Pengimi ose fshehja e **korrespondencës**”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 73.

“**Tranzitimi** dhe tregimi në kundërshtim me ligjin e veprave të artit dhe kulturës”, *Kodi penal*

– *I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 81.

“Dëmtimi me dashje i pronës me **eksploziv** dënohet”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 87.

“Kur nuk **ekzistojnë** rastet e përjashtimeve nga përgjegjësia penale”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 92.

“Transportimi i mallrave që dihet që janë **kontrabandë**”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 96.

“Kryerja e veprimeve që synojnë të **provokojnë** luftë”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 112.

“Shpërdorimi i **kontributeve** të dhëna nga shteti”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 129.

“**Konsiston** në krijimin e **privilegjeve** të padrejta”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 128.

“Për të krijuar dhe **privilegje** të padrejta për të tretët”, *Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore*, Tiranë 2009, faqe 130.

“Kur këto të fundit kanë lidhje me **pretendimet** e fillimit”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 12.

“Kanë qenë në gjendje të debatojnë sipas parimit të **kontradiktoritetit**”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 15.

“Në **kompetencë** të gjykatës së shkallës së parë janë të gjitha mosmarrëveshjet civile”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 22.

“Ai mban përgjegjësi penale dhe civile sikurse **eksperti**” *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 44.

“Mund të zgjasë me vendim afatin që nuk është **prekluziv**”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 54.

“Kur të metat e kërkesëpadisë **konstatohen** gjatë gjykimit të çështjes”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 58.

“Pa lejen e gjykatës dhe pa qenë të **evidentuara** në dosje”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 97.

“Pa treguar personin të cilit i **atribuohet falsiteti**”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 102.

“Pohimi gjyqësor i rastit mund të jepet në formë **verbale**”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 104.

“Mund të ndryshohet ose të **revokohet** nga gjykata që i ka dhënë”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 116.

“Për rivendosjen në **posedimin** e banesës bashkëshortore”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 117.

“Me abstenimin ose heqjen dorë nga misioni i **arbitrit**”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 155.

“Kryetari i gjykatës së apelit cakton **relatorin** e çështjes dhe ditën e gjykimit”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 167.

“Udhëzimet dhe **konkluzionet** e Gjykatës së Lartë janë të detyrueshme” *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 178.

“Kur përmbaruesi gjyqësor **konstaton** se nuk është kompetent për të vënë në ekzekutim kërkesën”, *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 187.

“Blerësi quhet **ofertuesi** që ka dhënë çmimin më të lartë” *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 200.

“Për shkak **preference** nga detyrime të tjera, urdhri i **ekzekutimit** i kthehet **kreditorit**” *Kodi i procedurës civile*, Tiranë 2007, faqe 214.

“Kanë të drejtë të **kompensohen** për humbjet **eventuale** në bazë të dispozitave ligjore” *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 11.

“Duhet të respektojnë parimin e **proporcionalitetit**”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 11.

“Qëllimi i kërkuar të realizohet me masa sa më pak **represive**, pa **kompromentuar efektivitetin** e tyre”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 12.

“Juridiksioni vendoset në momentin kur fillon **procedimi** administrative”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 16.

“Ligje të veçanta kur **imponohen** nga situata të veçanta”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 28.

“Palët e interesuara kanë të drejtë të **inspektojnë** dosjet e **disponuara** nga administrata”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 28.

“Vërtetime a kopje **autentike** të dokumentave”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 29.

“Palët e interesuara njoftohen për **ekzaminimet**”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 47.

“Hyrja në fuqi e tyre kushtëzohet nga miratimi apo **kundërfirmimi**”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 56.

“Aktin administrativ, të nxjerrë apo munguar, që **kontestohet**”, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009, faqe 68.

“Personi juridik pushon veprimtarinë e tij dhe vihet në **likuidim**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 20.

“Vendos për **destinimin** e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së saj”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 26.

“Dita kur është dhënë vendimi i gjykatës ose **arbitrazhi** përkatës nga i cili ka lindur padia e **regresit**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 47.

“Parashikimi i ndërprerë kundër njërit prej **debitorëve solidarë**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 50.

“Kur një e drejtë mund të ushtrohet brenda një afati **prekluziv**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 51.

“Pronësia mbi sendet e luajtshme të **abandonuara**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 66.

“Pabarazia e pjesëve që rezulton nga ndarja në natyrë **kompensohet** me një shpërblim në para”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 73.

“Miraton **preventivat** e shpenzimeve që ka vendosur të kryhet gjatë vitit”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 76.

“Detyrohet që në **proporcion** me përfitimin që nxirret prej tij të ndërtoj edhe mirëmbajtje mjetet e tjera”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 94.

“Duke **evituar** veprimet e dhunës që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 107.

“Sendi nuk mund të jetë nën **kualitetin** mesatar”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 128.

“Detyrimi është **alternativ** kur debitori shkarkohet prej tij”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 140. “**Konvertimi** duhet të bëhet me kursin zyrtar”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 145.

“Kur **kreditori pretendon** se ka humbur dokumentin”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 150.

“Përveç padisë **posedimore** mund të ushtrojë edhe padinë e **rivendikimit**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 171.

“Me kusht që kreditori të mos jetë **privuar** në mirëbesim prej titullit dhe garancive të kredisë”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 203.

“Kur palët detyrohen **reciprokisht** ndaj njëra – tjetrës”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 206.

“E humb të drejtën e garancisë për **evinksion** në qoftë së nuk provon se nuk ekziston arsye e mjaftueshme për të penguar marrjen e sendit”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 225.

“Shitësi mund të kryejë **spedicionin** me kusht që sendet t’i dorëzohen blerësit”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 226.

“Të përdorë sendin në një **destinacion** tjetër”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 242.

“Numri i kopjeve duhet të tregohet në çdo **ekzemplar**”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 269.

“Për të përfituar **avantazhet** e ardhura nga vonesat në pagim”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 284.

“Në vlerën e asaj që është vjedhur, dëmtuar ose humbur deri në **ekuivalentin** e njëqindfishit të çmimit të qirasë”, *Kodi civil*, Tiranë 2010, faqe 301.

“Respekti dhe mirëkuptimi **reciprok**, si baza e unitetit në familje”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 9.

“Bashkëshortët **pretendojnë** se martesë e mëparshme ka qenë e pavlefshme”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 20.

“Është larguar pa shkak nga vendbanimi familjar dhe **refuzon** të kthehet”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 24.

“Pasuritë e fituara si **aksesorë** të pasurisë vetjake”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 31.

“Pasuritë që bashkëshorti ka **neglizhuar** të marrë”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 31.

“Ka të drejtën e **regresit** ndaj bashkëshortit tjetër për pjesën e detyrimit të shlyer për llogari të tij”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 39.

“Në mungesë të provave të kundërta **prezumohet** se pasuria e luajtshme bën pjesë në bashkësi”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 40.

“Çdo **klauzolë** e kontratës është e pavlefshme nëse detyron bashkëshorti”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 42.

“Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose përfaqësuesit e tyre **respektivë**”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 46.

“Janë të lidhura me ushtrimin **abuziv** të përgjegjësisë prindërore”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 56.

“Padi para gjykatës **kompetente** për të vërtetuar se ai është i ati i fëmijës”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 63.

“Mund të paraqesim në gjykatë **pretendime** për të kundërshtuar birësimin”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 83.

“**Konfirmimin** se i mituri nuk ka patur mundësi të birësohet”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 85.

“Birësimi është i **parevokueshëm**”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 87.

“Trashëgimitë dhe **donacionet** publike”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 121.

“Birësimi i fëmijës **rezident** jashtë vendit”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 134.

“Detyrohet të ruajnë **konfidencialitetin** dhe besueshmërinë”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 138.

“Kanë shprehur ose **evidentuar** atë me shkrim”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 144.

“Organet e tjera të **akredituara** rregullisht në shtetin e tyre”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 146.

“Një shtet me sistem të **unifikuar**”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 157.

“Instrumenti i **aderimit** depozitohet pranë të njëjtit organ”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 158.

“Interesat e fëmijëve janë të një rëndësie **prioritare**”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 162.

“Republika e Shqipërisë **rezervon** të drejtën e juridiksionit të autoriteteve të veta”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 182.

“Ligjin e zbatueshëm për mbrojtjen e **minoriteteve** ka nevojë për rishikim”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 183.

“**Konsiston** në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 211.

“Informacion në lidhje me **bekgraundin**”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 213.

“Asnjë siguracion, **obligacion** apo depozitë nuk mund të kërkojë garanci pagese kostosh”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 219.

“Konventë për ndihmë dhe **konsulencë** ligjore”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 220.

“Fëmijë viktimë **potenciale** e trafikimit”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 231.

“Dispozita që paracaktojnë **konfiskimin** e të gjitha objekteve”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 232.

“Ky bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni të **azhurnohet** me qëllim luftën ndaj trafikimit”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 233.

“Hartimin e standardeve për mbledhjen e rregullt dhe **eficente** të informacionit”, *Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet*, faqe 233.

“Me kërkesë të shkruar dhe të **motivuar**”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 54.

“Palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë të paraqesin **memorie** dhe kërkesa me shkrim”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 63.

“Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga **indicjet** përveçse kur këto janë të rëndësishme”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 82.

“Gjatë pyetjes dëshmitari bën thënie **kontradiktore**”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 88.

“Ka **preferencë** ndaj çdo kreditori tjetër për shumat e depozituara”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 111.

“Afati i **infiltrimit** mund të zgjatet nga prokurori”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 159. “Duke përfshirë dhe **rilevimet** daktiloskopike”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 159. “Mbrojtësit e të cilëve kanë **asistuar** në marrjen e tyre”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 172. “Dëshmitari mund t’i bëjë pyetjet në **distancë**”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 191.

“I dënuari do t’u nënshtrohet akteve **presekutuese** ose **diskriminuese**”, *Kodi i procedurës penale*, faqe 262.

6.2 Terminologjia gjuhësore⁵⁵

Termet gjuhësorë i kemi marrë nga “Fjalor me terma të gjuhësisë”, Tiranë 2011, të autorëve Giovanni Belluscio dhe Shezai Rrokaj. Meqë gjuha shqipe e ka një fjalor të tillë vendosëm të merrim disa terma për t’i paraqitur si shembuj termash të kësaj fushe.

Adstrakt – ndajshtesë, adverbizim – ndajfoljezim, afiks – ndajshtesë, aglutinim – përngjitje, aklimatizim – përshtatje, akordim – bashkëpërshtatje, anaptiks – tingull shtesë, aorist – e kryer e thjeshtë, areal – hapësirë, infiks – brendashtesë, inkorporim – brendatrupësim, eufoni – bukurtingëllim, kakofoni – keqtingëllim, kolofoni – shënim i botuesit, cross-over – kapërcim i kryqëzuar, deiks – tregor, deverbativ – prejfoljor, diminutiv

– zvogëlues, diptot – dyrasësh, ekuativ – shkallë krahasore e barazisë, substrativim – emërzim, falset – zë koke, verbalizim – foljezim, kompletivizim – ffillim, glotë – shtegth, gradual – shkallëzuar, gutural – grykor, gjeneroj – prodhoj, heteroklizi – lakimndryshmëri, hipokoristik – përkëdhelës, hipotaks – nënrenditje, imperfektivim – pakryerëzim, infleksion – brendaoptim, iterative – përsëritës, izosilabik – barasrrokësh, koaleshencë – shkrirje tingujsh, konversion – shndërrim, kakuminal – kulmor, gnomik – njohës, imperfektivim – pakryezim, antecendent – paraprirës, parantetik – i, e ndërshënë, kontrastiv – përqasës, ridondancë – fjalëtepri, singularizuar – njëjësuar, translacion – zhvendosje⁵⁶ etj.

6.3 Terminologjia e kulinarisë

Si material burimor për vjeljen e materialit kemi marrë dy libra kulinarie, “Arti i pasticerisë”, Kosta Koçi, Tiranë 2005, dhe “Arti i të gatuarit”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, Tiranë 1998, si edhe nga emisionet në bazë të të cilave janë gatimet.

⁵⁵ Shënim: Për termat e huazuar në gjuhësi nuk janë paraqitur me shembuj në fjali, meqë tema është e kësaj fushe dhe nuk ka problem për të nxjerrë kuptimin e tyre.

⁵⁶ Giovanni Belluscio, Shezai Rrokaj, *Fjalor me terma të gjuhësisë*, Tiranë 2011

“Gjalpi zbutet duke u ngrohur në **banjo – mari**”, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 28.

“Për **konservimin** e mishit ka shumë metoda”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 13.

“... **ekstraktive** që shkrihen gjatë zierjes...”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 12.

“**Gradacionet** e nxehtësisë...”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 23.

“Kur i **servirim**, i radhisim me shije në pjatancë”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 29.

“Ngjyra e bardhë e tyre **spikat** dhe shkon me ngjyrën e kuqe”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 38.

“Kërpudhat që të përdoren duhet të jenë shumë të vogla dhe të **pacënuara**”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 40.

“...për **garnityrë** veprojmë në këtë mënyrë”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 42.

“...mund të nxjerrim 2 litra lëng të **koncentruar**”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 73.

“...ziejmë si zakonisht **spagetat...**”, Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 91.

“Në vend të djathit hedhim **putargë** të grirë në rende..” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 92.

“...mbushim **kanelonit...**” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 94.

“Gatimi i **raviolve...** do shumë kohë” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 95.

“**Llazanjet** i ziejmë me ujë e me kripë...” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 97.

“...me **simigdal** bëjmë një brumë jo shumë të shtërnguar..” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 100.

“...të jetë mpiksur mirë salca **beshamel...**” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 103.

“Vezë **o graten**” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 107. “Omëletë **parmandie**” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 112.

“Vezë të mbushura **shemej**” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 116.

“Salcë *vellute*” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 125. “Salcë *ravigot*” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 128. “Salcë *remullade*” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 129.

“Salcë ruse me *smetanë*” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 132.

“Salcë *pikadili*” Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998, faqe 133.

“Frutat që do të përdoren duhet të jenë të *kualitetit* të parë”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 43.

“E hollojmë me *madera* ose me *maraskino*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 45.

“Këto salca shërbejnë për *butinga, sharlotë, kroketa* etj.”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 48.

“Shtohet në shurup vanilje, pureja, lëngu i limonit, *kirsku* dhe përzihen mirë”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 49.

“Do ishte më mirë që ato të *konservoheshin* në kushtet e shtëpisë”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 53.

“E mira është të zihen frutat në enë metalike prej çeliku të paoksidueshëm ose në enë të *emaluara*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 55.

“Shurupi përgatitet sipas *normativave* që përmendet në recetë”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 55.

“*Prevede* mollësh”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 61.

“*Xhem* frutash”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 62.

“*Zhelëja* me *agar-agar* është më e mirë sesa me xhelatinë”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 76.

“Spërkatës mund të bëhet me thërmijat e brumit të shkrifët, *sfoliat*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 81.

“Kur masa ftohet pritët në copa pastash dhe *serviret*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 91.

“Sipërfaqja *glasohet* me *fondan* kakao dhe pritët në racione”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 99.

“Përpunimi i pastave *ekler* paraqet variacione të ndryshme”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 125.

“*Tartat* dhe *tartaletat*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 140. “*Savaren, brushë*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 254. “*Zhele* frutash”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 257. “*Milfëj*”, Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005, faqe 283.

“*Shu* i mbushur me krem *pralinë*”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 285. “*Kandigjibek*”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 302.

“*Kulture* me portokalle”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 304. “*Sharlot* molle”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 330.

“*Sufle* me mollë”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 331.

“Dieta me *holicistitet* kronike”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 413. “*Tortaletë* të ndryshme”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 423. “Portokalle të *carinës*”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 478.

“Dardha *almina, karmen, muritanie*”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 484.

“Krem *santigji*”, Kosta Koçi, Arti i pastičerisë, Tiranë 2005, faqe 486.

6.4 Terminologjia sportive

Për terminologjinë sportive kemi përzgjedhur gazetën “Panorama sport” të ditëve të ndryshme dhe emisionet televizive sportive. Disa shembuj të termave që i përkasin kësaj fushe janë:

“Pirlo *refuzon* Milanin: *Rinovoj* me Juventusin”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 1.

“ Më kanë *kontaktuar*, por kam kontratë...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 1. “...të kuqtë duken më të *avantazhuar..*”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 2. “...të *intensifikojnë* bisedimet me lojtarin.”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 2. “Për *tranferimin* e tij tek Partizani...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 2.

“...mbetet për t’u parë sa do të vazhdojë kjo *rezistencë..*”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 2.

“... do të jetë në *kontigjentin* e të larguarve.”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 2.

“... janë dy objektivat e Tiranës për *merkaton* e dimrit.”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 3.

“ Lika *konfirmoi* se ka patur kontakte...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 3.

“ Magani projektin largime dhe *eviton* ndërhyrje”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 3.

“.. procesi do të jetë i hapur dhe *transparent.*”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 4.

“...Muçollari nuk ishte në *kondicion optimal*”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 4.

“...të jemi më të **kompletuar** në pjesën e dytë...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 4.

“Po presin **destinacionin** e fazës përgatitore...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 4.

“...kanë bërë **immediate** futjen e drejtuesve në merkato”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 6.

“.. Franca kualifikohet në çdo **kompeticion**”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 6.

“.. të gjithë e kanë **bojkotuar** stërvitjen” gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 6.

“... kishin vendosur një **premio** të papërcaktuar...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 7.

“...do të **startojnë** me datë 6 janar”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 8.

“.. **tratativat** për të afruar lojtarë **kualitativë**”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 8.

“... me një **dominancë** nga kolonat e humbjeve”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 8.

“...skadrat kanë në përbërje lojtarë **amatorë**”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 9.

“.. u **ingranua** me skuadrën e parë...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 10.

“.. duke e aktivizuar në **formacionin** e parë të Dinamos”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 10.

“... nuk pati shumë kohë në dispozicion për të **kolauduar** skuadrën...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 13.

“ **Negocioj** me Çelësin, por dua të qëndroj”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 15.

“...dy forcat **ofensive** më të fortat e kampionatit...”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 17.

“...i **rikuperuar** pas çarjes në gju”, gazeta *Panorama sport*, 26 dhjetor 2013, faqe 17.

“...e mbështesim skuadrën pa **rezerva**”, gazeta *Panorama*, 25 dhjetor 2013, faqe 23.

“...duke u nisur nga **performanca** e talentit kosovar”, gazeta *Panorama*, 25 dhjetor 2013, faqe 23.

6.5 Terminologjia informatike

Fjalët e huaja të fushës së informatikës i kemi përzgjedhur në dy tekste shkollore të arsimit të mesëm të ulët, përkatësisht “Informatika 8” dhe “Informatika” me autorë Ledian Bardhi dhe Anduela Lile. Meqë numri i fjalëve të huaja për çdo fjali është minimumi 2, nuk po i përzgjedhim për t’i dalluar, pasi do të duhet të nënvizionim gati të gjithë fjalinë.

“Instruksionet e boot-imit kanë një memorie të kufizuar në çipin ROM, prandaj zakonisht shkruhen në assembler”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 7.

“Të dhënat ruhen në hard drive-in e kompjuterit”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 10.

“Ajo përfshin një sfond për Desktop-in, një sfond ekrani në asreen saver”, *Informatika 8*,

Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 11.

“Klikoni personalize”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 11.

“Menyja e Start funksionon si qendër manaxhimi”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 12.

“Ajo është e vlefshme si për menynë Start ashtu edhe për Taskbar-in”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 12.

“Kjo procedurë nuk e heq programin nga lista All Programs dhe nuk e çinstalton programin”,

Informatika 8, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 13.

“Pineska shërben për të vendosur një dokument në menynë Start”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 14.

“Emërtimi “Picture Tools” shfaqet në fillim të ribonit pasi kemi futur dhe selektuar një pikturë”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 17.

“Klikoni butonin Office dhe më pas vendoseni te opsioni Save as”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 20.

“Kur fusni një imazh në një libër pune në Excel, tab-i për formatimin e imazhit shfaqet një ribbon”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 22.

“Klikoni butonin Cut në grupin Clipboard, Word e heq tekstin e selektuar dhe e vendos ne Clipboard”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 27.

“Zgjidhni tab Page Layout. Hapësira “default” shfaqet fusha “Space Before” dhe “Space After” në grupin Paragraph”, *Informatika 8*, Ledian Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 33.

“Grafikë Smart Art – diagram të ndryshme”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 36.

“Në ribon shtohen dy tan-e të përkohshme Desing dhe Layout, nën emërtimin Table Tools”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 39.

“Ju mund të fshini me Backspace ose Delete”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 47.

“ Për të fshirë kolonat klikoni Delete Sheet Columns”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 49.

“Komandat Cut, Copy dhe Paste ekzekutohen në të njëjtën mënyrë si në Word”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 55.

“Në tab Insert, grupi Charts zgjidhni llojin e grafikut që i përshtatet qëllimit tuaj”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 56.

“Lundroni midis faqeve duke klikuar butonat Next Page dhe Previous Page”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 58.

“Në menunë “Customize Quick Access Toolbar” zgjidhni opsionin “Show Below the Ribbon”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 64.

“Klikoni tab Layout, grupi Rows and Columns, dhe selektoni Insert Right”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 72.

“Në kutinë Save in afishohet folder-i My Documents”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 75.

“Komandat në grupet Alignment, Number dhe Style janë me ngjyrë gri, pra të paaktivizuara”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 78.

“Në tab Desing, grupi Data, klikoni Switch Row Column”, *Informatika 8*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 80.

“Në panelin e afishuar klikoni dy herë Blank Dokument”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 9.

“Imazhet Clip Art në Word”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 11.

“Mund të ndryshoni stilin e tij me anë të komandave Bold dhe Italic”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 12.

“Selektoni Word Art duke klikuar një herë”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 12.

“Në tab Format, grupi Text, klikoni butonin Edit Text”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 13.

“Ju mund të shtoni një rresht total në tabelën tuaj, që ju siguron akses të disa funksione, si: Avarage, Count, Sum etj”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 16.

“Në grupin e parë të tab Desing, Properties, në fushën Table Name, shkruani emrin për tabelën tuaj”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 17.

“Power Point është pjesë e Office, një paketë me produkte që kombinon tipe të ndryshme software”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 20.

“Për të hapur Poëer point-in klikoni butonin Start dhe në folder-in Microsoft Office gjeni dhe klikoni programin Microsoft Office Power Point 2007”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi,

Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 20.

“Klikoni Power Point Presentation për ta ruajtur prezantimin në formatin pptx, “default” i programit Power Point”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 21.

“Faqja e punës quhet slide”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 22.

“Butoni Office hap menynë që përmban komandat që lidhen me prezantimin në tërësi, si New, Open, Save, Print etj.” *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 22.

“Klikoni butonin Delete në grupin Slide, tab Home”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 27.

“Në grupin Blackground, tab Desing, klikoni butonin Blackground Styles”, *Informatika 9*,

Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 29.

“ Të gjitha formatimet e mësipërme realizohen me anë të dritares së dialogut “Bullets and Numbering”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 31.

“Klikoni Costumize në tab Bulleted, hapet dritarja e dialogut Symbol”, *Informatika 9*,

Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 31.

“Objekte të tjera që ju mund të fusni nga zona e operimit përfshijnë tabela, grafikë, diagramë Smart Art, Clipart dhe video”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 32.

“Secili nga këto objekte ndryshon në varësi të selektimit në meny të opsioneve Aling Slide dhe Aling Selected Objects”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 33.

“Shumë diagrame SmartArt ju vijnë të gatshme me efekte special animacioni”, *Informatika 9*,

Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 35.

“Hapet paneli i veprimeve Custom Animation. Vini re butonat nuk janë të aktivizuar. Selektoni tekstin. Butoni Add Effect aktivizohet”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 37.

“Handouts, ky opsion printon disa slide në një faqe”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 39.

“FTP krijon një server skedarësh në web, i cili lejon bankat e skedarëve të vendosen në server, të gatshme për përdorim”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 45.

“Dial up dhe Broadband përdorin të njëjtën linjë telefonike, por Broadband e përdor atë me më shumë efikasitet.”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 49.

“Një lloj tjetër Broadband-i i quajtur DSL, ju lejon të downloadoni dhe uploadoni me të njëjtën shpejtësi”, *Informatika 9*, Lediana Bardhi, Anduela Lile, Tiranë 2012, faqe 50.

6.6 Terminologjia ekonomike

Termet ekonomikë i kemi marrë nga gazeta “Ekonomia” e datave 29 dhe 31 tetor 2014. “Shkëmbimet tregtare **deficit** tregtar rritet 25,2%”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 1.

“Për disa sektorë të tjerë siç është bujqësia dhe turizmi ekzistojnë **precedentë** në Bashkimin Europian apo në vende të rajonit të cilat **suportojnë** për ekonominë në mënyrë që të jenë **prezentë** në ekonomi qoftë me produkte, qoftë me shërbime”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 1.

“Sllovenia është e gatshme të ofrojë **ekspertizë**”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 2.

“Për të gjetur rrugët për **avancimin** e tyre me **fokus** ekonominë”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 2.

“Kërkohet informacion i detajuar për **koncensionin** e skanimit në dogana”, gazeta “Ekonomia” 29 tetor 2014, faqe 3.

“Në fillim është **koncensionin** i pullave **fiskale**, pastaj **markimi** i karburanteve”, gazeta “Ekonomia” 29 tetor 2014, faqe 3.

“Rritje më të madhe kanë patur në **importin** e grupeve...”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 4.

“Të vendosura nën regjimin doganor, në përpunim pasiv, ose të **rieksportuara**”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 4.

“Është një **nomeklaturë** mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë së jashtme doganore”, gazeta “Ekonomia”, 29 tetor 2014, faqe 4.

“Rreth 5 mijë grupe të veçanta mallrash të *identifikuara* sipas një kodi 4 shifror”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 4.

“Për përbalimin e zhvillimeve negative ekonomike e financiare të vendeve ku ato *operojnë*, por edhe zhvillimeve negative ndërkombëtare”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“Mbikqyrësve të Bankave Europiane si organ *ekzekutiv të* Këshillit të Bashkimit Europian”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“Qëndrueshmëria financiare e institucioneve të *kreditit* në të gjithë eurozonën”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“..ndër to banka tregtare dhe banka *investimesh* duke mbuluar 85% të sistemit bankar europian”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“ Me shumë pak probabilitet për t’u materializuar ose e thenë thjeshtë nëse *kapitali* i bankave është i mjaftueshëm për të përthithur humbjet në rastin e këtyre goditjeve të hamendësuar të skajshme pa prekur vazhdimin normal të veprimtarisë tregtare”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“Rishikimi i cilësisë së *aktiveve* përqëndrohet në matjen e tregueve të mjaftueshëm “, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“*Aktive të ponderuara* me risk”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“Tregojmë se është mbi *normën prag* e vendosur për skenatin *statik* dhe skenarin *dinamik*”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“Pozicioni i Alfa Bank është përmirësuar shumë edhe nga kthimi i aktiveve të shtyra në tatim të *kreditueshëm* nga shteti grek”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“I shërben si vlerë e shtuar dhe *garanci* për qëndrueshmërinë”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“Banka të këtij lloji një pjesë e vogël *operojnë* edhe në Shqipëri”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 5.

“10 mijë biznese deklarojnë se po shkojnë drejt *falimentimit*”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 6.

“Rruga është ajo e uljes së taksës e rritjes së *eficencës* “, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 6.

“Tregues kyç është promovimi i një përgjegjshmëria *menaxheriale* dhe fuqizimi i një sistemi kontrolli të brendshëm”, gazeta “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, faqe 7.

“*Procedura* më të thjeshta për biznesin”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“Ky takim rajonal i *inicuar* nga Dhoma e Amerikane e Tregtisë”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“650 milion euro për **infrastrukturën** energjetike”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“Eksporti 33% e naftës shkon në Itali”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“Open Data Albania po hulumton mbi tregues të **eksportit bruto**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“**Konsistoi** në një vlerësim të cilësisë së **aktiveve** si dhe një ushtrim që **ekzaminonte impaktin** e skenarëve të mundshëm negative **makroekonomike**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“Këpucë e **konfeksione** kontrabandoheshin nga Greqia”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 1.

“Nuk do të lejojë që **informaliteti** të vendosë poshtë çdo sektor”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 3.

“**Kompesim** përmes shtresave në nevojë”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 3. “...do të ishte shumë më **efikase**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 3.

“Dogana është në **angazhim** të plotë për të ruajtur **konkurrencën** e ndershme mes bizneseve”, Gazeta “*Ekonomia*” 31 tetor 2014, faqe 4.

“Lehtësimi i procedurave për **import-eksportin** dhe gjithashtu çmimet e **referencës**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 4.

“Siç u **demonstrua** nga vlerësimi i Bankës Qëndrore”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 5.

“Politikat tona të shpërndarjes së **dividentëve**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 5.

“**Previgjionimi kolektiv** është bazuar në **kriteret konservative** të Modelit Sfidues”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 5.

“Brenda **totalit** të **ekspozimit** me kredi të mira”, gazeta “*Ekonomia*” 31 tetor 2014, faqe 5.

“Në shërbim të individëve edhe në sektorin e **bankingut** tregtar”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 5.

“Për nivelin e tretë të Aktiveve me Vlerë të Drejtë duke përfshirë dhe **derivatet**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 5.

“Sfida kryesorë është **unifikimi** i të dhënave mbi pronat”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 6.

“Kthimin e pronave fizike dhe **kompesimi** për një pjesë tjetër”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 6.

“Për një projekt të **interkonjeksionit** të gazit”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 6. “Rritja e nivelit të **aksisizës**”, gazeta “*Ekonomia*” 31 tetor 2014, faqe 6.

“ Të ardhurat e kompanisë **koncensionare**”, gazeta “*Ekonomia*” 31 tetor 2014,

faqe 7. “1 miliard euro **remitanca**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 8.

“Ndihmon në **stabilitetin** e jashtëm të dinarit”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 8. “Të dhënat nuk janë shumë **precise**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 8.

“Në **indikatorin** e fillimit të biznesit është bërë një ngritje **kualitative**”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 8.

“**Rangimi** i Kosovës në kuadër të raportit të Bankës Botërore”, gazeta “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, faqe 8.

6.7 Ndërtime të huaja në antroponime

Vitet e fundit vihet re se prindërit u vendosin fëmijëve emrat që nuk përshtaten me fonologjinë e shqipes, pra emra që ndryshe shkruhen dhe ndryshe lexohen, si p.sh. Jenna (*Xhena*), Jessica (*Xhesika*), Melissa (*Melisa*), Alexandra (*Aleksandra*), Alysa (*Alisa*), Angela (*Anxhela*), Biancha (*Bianka*), Brigida (*Brixhida*), Camila (*Kamila*), Cassandra (*Kasandra*), Christina (*Kristina*), Cindy (*Sindi*), Emely (*Emili*), Nicole (*Nikola*), Miryam (*Miriam*), Jenifer (*Xhenifer*), Wendy (*Uendi*) etj.

6.8 Ndërtime të huaja tek emërtimet në radio dhe televizione

Disa emërtime të tilla janë: *Top channel* (*Top çenëll*), *Agon channel* (*Agon çenëll*), *Déjà vu* (*de zha vu*), *Goodmoornig Albania* (*Gudmornig Albenia*), *Top select* (*Top selekt*), *Orange* (*Orinxh*), *Tonight me Ilva Tare* (*Tënaajt me Ilva Tare*), *Wake up* (*Uejk ap*), *Breaking news* (*Brejking njuz*), *Voice of Albania* (*Vois of Albenia*), *X Factor* (*iks faktor*), *Big brother* (*Big bradhër*), *My music radio* (*maj mjuzik radio*), *Masterchef* (*Mastër shef*), *BBF music TV* (*Bi Bi ef mjuzik ti vi*), *Club TV* (*Klab ti vi*), *Scan* (*Skan*), *Smile* (*Smajl*), *Digi Gold* (*Dixhi gold*), *ABC* (*ej bi si*), *Club FM* (*Klab ef em*), *Tring Life* (*Tring lajff*), *Tring Max* (*tring maks*), *Heart Attack* (*Hërt atak*) etj.

6.9 Libra në shqip të titulluar me fjalë në gjuhë të huaj

Gjatë një vëzhgimi të shkurtër të librarive kemi vënë re se edhe titujt e librave të shkruar shqip dhe nga autorë shqiptarë kanë në përbërje të titullit fjalë të huaja ose janë emërtuar plotësisht në gjuhë të huaj. Disa shembuj po i rendisim në vijim:

“*Pax Albanica*” i autorit Mustafa Nano, “*Facebook – koobecaf*” Edmond Shallvari, “*Hasta la vista*” Petro Marko, “*Requiem për një grua*” Vath Koreshi, “*Las Varrezas*” Zija Cela, “*Missing*” Bashkim Hoxha, “*Sos një buzëqeshje*” Zija Cela, “*I love Tom Hanks*” Elvira Dones, “*Rabini pasy*” Lisandri Kola etj., edhe pse janë libra të shkruar në gjuhën shqipe, titujt i kanë vendosur në gjuhë të huaj ose fjalë të huaja të përziera me fjalë shqip.

KREU VII

7.1 Llojet e huazimeve

Huazimet sipas mënyrës që janë futur në shqipe, kohëzgjatja e tyre, zhvillimi që kanë pësuar me kalimin e viteve etj. mund t'i grupojmë apo klasifikojmë në disa llojesh, si:

1. Fjalë me burim të huaj, të cilat janë përvetësuar nga shqipja, duke u bërë njësoj si fjalët e tjera të leksikut të shqipes.
2. Fjalë me burim të huaj, të cilat me kohë kanë dalë nga përdorimi, pasi janë kaluar në periferi të gjuhës ose sepse janë zhdukur vetë sendet a nocionet që ato shprehin, p.sh. *akcent, aproksimativ, bazal, kuestionar* etj.
3. Fjalë të huaja të panevojshme, të cilat janë zëvendësuar e po zëvendësohen me fjalë shqipe ekzistuese ose të krijuara me burimin e shqipes sipas gjedheve të gjuhëve të tjera, p.sh. *kualitet, asistoj, definicion, deskriptiv, disponoj, eksplodon* etj.

Huazim tjetër janë dhe **huazimet krahinore**, të cilat e pasurojnë gjuhën, por folësi parapëlqen më shumë një fjalë të kohës, sesa një fjalë të një krahine të caktuar.

Huazimet grafike janë huazime të cilat nuk shqiptohen ashtu si shkruhen në gjuhën origjinale. Huazime të tilla më së shumti janë nga anglishtja, pasi është gjuhë që shkruhet ndryshe dhe shqiptohet ndryshe, p.sh. fjala *marketing* shkruhet kështu në anglisht, por lexohet [maakiting].

Huazime quajmë edhe **termat ndërkombëtarë**, por ndryshe nga llojet e tjera të huazimeve, këto kanë shtrirje të gjerë në disa vende dhe për këtë arsye kanë marrë edhe emërtimin terma ndërkombëtarë. Fjalë të tilla janë p.sh. *OK, kompjuter, univers, nacional, futboll, debit, bonus* etj.

Nga mënyra se si futen huazimet në një gjuhë, janë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta.

Huazimet quhen **të drejtpërdrejta**, kur dy gjuhë fliten në një bashkësi shoqërore të njëjtë në pikëpamje gjeografike dhe politike, siç janë huazimet që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga italishtja, p.sh. *luçidoj, inteligjencë, insuficiencë, gusto, ezauroj, dislokoj, divergjencë* etj.

Huazimet janë **të tërthorta**, kur ndërmjet dy bashkësive a kombeve, të cilat gjeografikisht dhe politikisht nuk bëjnë pjesë në një njësi, madje nuk kanë as pikëtakime fizike a topografike, marrin e japin fjalë, siç janë huazimet nga anglishtja, p.sh. *penallti, spiker, start* etj. dhe nga frëngjishtja: *deziluzion, dekurajoj, azhurnoj, afeksion, afirmoj* etj.

Një lloj huazimi vitet e fundit në gjuhën shqipe janë dhe **shkurtimeve e huazuara**. Për shkurtimeve e huazuara ka disa probleme në mënyrën e të lexuarit, sepse nuk është vendosur një normë se si duhet të lexohen. Prandaj, leximi i tyre bëhet në disa variante si: germë për germë sipas alfabetit të gjuhës shqipe, sipas rrokjeve ose sipas gjuhës nga

janë marrë, p.sh. OSBE [o së bë e], NATO [nato], UNICEF [uniçef]. Disa shkurtime shkruhen ndryshe dhe shqiptohen ndryshe, si p.sh. BBC shqiptohet [bi bi si], sipas germave të alfabetit anglez, OK [o kej].

Arsyet përse huazimet grafike janë lexuar e më pas përhapur me një shqiptim të tillë janë disa:

Së pari, folësit e parë që i kanë përdorur këto shkurtime i kanë shqiptuar siç i kanë dëgjuar në gjuhën nga i kanë marrë, pastaj një shqiptim i tillë është përhapur dalëngadalë dhe është ngulitur.

Së dyti, folësit duke i ndier të huaja këto shkurtime dhe duke pasur vështirësi në shqiptim i përshtatin ato në gjuhën shqipe. "...Shqiptimi sipas grafisë origjinale duhet parë si dukuri normale, si një mënyrë përshtatje e fjalëve të huaja, me qëllim që këto të fundit të integrohen sa më mirë në shqipe".⁵⁷

Për këto shkurtime duhet respektuar ky lloj shqiptimi, pasi dhe në mjaft gjuhë të tjera shqiptohen në këtë mënyrë. Por në gjuhën shqipe disa nga këto lloj huazimesh kanë shqiptimet në shqip, p.sh. në anglisht quhet NGO (Non Governmental Organization), ndërsa në shqip OJQ (organizatë joqeveritare).

Huazimi më i shpeshtë në gjuhën shqipe është huazimi i fjalës bashkë me sendet apo konceptin e ri, të cilat quhen **huazime leksiko-kulturore**, p.sh. *bankë*, *sonet* nga italishtja apo *basketboll*, *volejball* nga anglishtja etj.

Në rastet kur fjala e huaj përdoret si sinonim me fjalën shqipe për një send apo koncept që e ka një emërtim në shqip, quhen **huazime gjuhësore**.

Fjalët që u përkasin gjuhëve fqinje, por që gjuha shqipe i ka trashëguar nga ilirishtja, quhen **fjalë të trashëguara**. Ndërsa fjalët të cilat i ka marrë vetë nga gjuhët e tjera janë emërtuar **huazime vetjake**.

Huazimet relikto përfshijnë dy shtresa fjalësh si: fjalë të substratit, të cilat një gjuhë fituese i merr nga gjuha e asimiluar, përgjithësisht janë të pakta në numër; dhe fjalë të superstratit, d.m.th. fjalë që hyjnë në gjuhën fituese, e cila i takon popullit të mundur, nga gjuha e popullit fitues, e cila zhduket.⁵⁸

Huazimet i ndajmë dhe në **huazime gojore** dhe **shkrimore** sipas fushës së ligjëritimit ku hyjnë në gjuhë. Huazimet gojore vijnë si rezultat i komunikimit të folësve të vendeve përkatëse dhe media, ndërsa huazimet shkrimore hyjnë nëpërmjet gjuhës së shkruar si libra artistikë, shkencorë etj. apo media e shkruar.

Sipas strukturës huazimet janë dy llojesh:

1. Huazime leksikore kemi atëherë kur huazohet e gjithë fjala së bashku me kuptimin e saj. **2. Huazime ndërtime, kalke** quhen kur huazohet vetëm ndërtimi morfemor dhe kuptimi, ndërsa parashtesat dhe prapashtesat janë të shqipes, p.sh. *ndërgjegje* sipas latinishtes *con + sciencia*, *hekurbeton* sipas italishtes *ferrobeton*, *fundjavë* sipas anglishtes *weekend* etj.

⁵⁷ Kristina Jorgaqi, *Sporteli i hapur i shqipes*, Tiranë 2008 f. 25-26.

⁵⁸ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë 2002, f. 200.

Huazime të pjesshme quhen ato fjalë, në të cilat njëri nga elementet e saj përkthehet, kurse tjetri mbetet siç është, p.sh. *kulturor*, *natyror* etj., ku prapashtesa *-al* zëvendësohet nga gjegjësjja e saj shqipe *-or*; *teleshikues* ku tema e dytë e fjalës është shqipërimi i fjalës së huaj *spektator*.

7.2 *Huazimi brenda sistemit të shqipes*

Rrugëtimi nëpër të cilin kalojnë fjalët e huazuara nga gjuha dhënëse tek ajo marrëse është i gjatë dhe, si i tillë, fjalët pësojnë disa ndryshime të kushtëzuara nga gjuha marrëse. Shkallët që përshkojnë fjalët e huaja janë tri, të cilat po i rendisim dhe i shpjegojmë në vijim.

Shkalla e parë është **transferimi**, kur fjala hyn në gjuhën marrëse e përdoret pa asnjë ndryshim nga gjuha dhënëse. Pastaj vjen **ndërndikimi** apo **interferenca**, kur fjala fillon të përshtatet me natyrën fonetike e morfologjike të gjuhës marrëse, si p.sh. lëvizja e theksit. Shkalla e tretë është **përfshirja** apo **integrimi i plotë i fjalës së huaj** në gjuhën marrëse. Në këtë shkallë elementet e huaja përfshihen plotësisht në sistemin e gjuhës marrëse dhe asgjë nuk e dallon se janë të huaja.

Sipas këtij shkallëzimi, fjalët e marra nga gjuhët e huaja në gjuhën shqipe mund të ndahen⁵⁹:

1. Fjalë të huaja, të cilat i dëgjojmë apo i lexojmë dhe duket se nuk janë shqiptare, sepse ka fonema të huaja, theks të huaj dhe jo të zakonit për gjuhën tonë, p.sh. *low cost*, *de jure*, *de facto*, *show*, *hi-tech* etj.
2. Fjalë të cilat janë të përfshira hëpërhë në gjuhën shqipe, por për shumë prej tyre ende nuk dihet se si do të shkojë ky proces më tej, p.sh. *difezë*, *difuzion*, *eminent*, *elaboroj*, *glosar*, *ekzigjencë* etj.
3. Ndërsa huazimet e ngulitura janë fjalë krejtësisht të përfshira në sistemin e gjuhës marrëse. Këto nuk kanë më mundësi për t'u zëvendësuar me fjalë të tjera, pasi kanë zënë vendin e tyre, p.sh. *amnistia*, *anketim*, *celebrim*, *integrim* etj.

Katër dukuri kryesore që ndodhin gjatë një ekspansioni gjuhësor, sipas profesor Shezai Rrokaj, janë⁶⁰:

1. **Ngulitja**, kur një varietet i dhënë synon të mbizotërojë një hapësirë të rëndësishme, duke u shndërruar nganjëherë deri në gjuhë – mëmë për pjesën dërrmuese të folësve të një territori.
2. **Importimi**, kur një varietet i dhënë përhapet në një territor duke krijuar “ishuj” gjuhësorë. Sigurisht kjo gjuhë nuk është mbizotëruese dhe masa e folësve të saj është e lëkundur. Kjo mënyrë ekspansioni shpie drejt diglosisë.
3. **Mbishtrësëzimi** ndodh kur dy a më shumë varietete bashkëgjëlljnë dhe kur njëri prej tyre luan rolin e gjuhës standarde.

⁵⁹ Leksion i profesor Gjovalin Shkurtajt, *Të ndajmë mirë huazimet nga fjalët e huaja të panevojshme*, f. 9-10.

⁶⁰ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, f. 119-120.

4. **Rrezatimi** ndodh kur një varietet përhapet deri në masën sa krijon një situatë diglosie, por pa mundur të ketë një status zyrtar. Mësimi i tij varet nga qëndrimet individuale.

Importimi apo zëvendësimi i fjalës së re në gjuhën marrëse mund të ndikojë në tri mënyra⁶¹:

1. Kuptimi i fjalës së re mund të ngatërrohet me kuptimin që ka ekzistuar më herët në gjuhën marrëse.
2. Fjala që ka ekzistuar më parë në gjuhën marrëse mund të zhduket.
3. Fjala e re dhe fjala e vjetër mund të mbijetojnë secila, po me kuptime të veçanta.

Fjalët e huazuara që në të shumtën e rasteve pësojnë ndryshime në gjuhën marrëse dhe quhen zëvendësim, kurse ato që nuk pësojnë ndryshime quhen të importuara.

7.3 Zhvillimi i huazimeve në shqipe

Në shqipe huazimet kanë pasur zhvillime të ndryshme në varësi të nevojës së gjuhës për ato fjalë; nëse fjala që futet vjen për të mbushur një hapësirë boshe, del si sinonim me fjalë të burimit të shqipes ose nëse fjala vjen në një kontekst apo me një kuptim plotësues e fjalëve që janë tashmë ekzistuese në gjuhë. Sipas zhvillimit që kanë pasur në gjuhën shqipe, fjalët e huaja i grupojmë në katër grupe:

1. **Fjala e huaj nuk zhvillohet më tej, duke kaluar në periferi të gjuhës ose drejt zhdukjes.** Kjo ka ndodhur për disa arsye, si: fjala shënon një send ose dukuri në vendin nga ka ardhur, prandaj ajo vjen së bashku me karakteristikat e përdorimit të saj në atë vend dhe për pasojë nuk ka shumë hapësirë për t'u zgjeruar nga ana kuptimore. Duke qenë se vazhdon të gjallojë ende fjala shqipe, fjala e huaj përgjithësisht nuk krijon fjalë të reja dhe ka vështirësi lidhjeje me fjalë të tjera p.sh. *afinitet, akomodim, ambiguitet, destruktiv, eksentrik, fantomatik, fizibilitet* etj.
2. Fillimisht **fjala e huaj, kur futet në gjuhën shqipe, ka disa variante shqiptimi**, disa e shqiptojnë sipas gjuhës nga është marrë, disa e shqiptojnë siç e dëgjojnë nga të tjerët, ndërsa një pjesë më e vogël mundohen ta përshtatin me gjuhën shqipe. Megjithatë, “kjo dukuri është edhe më e përkohshme në gjuhët standarde, ku në mënyrë të vetëdijshme ndërhyhet për të vendosur disa norma të qëndrueshme e të përgjithshme në përdorim... për huazimet që kanë prirje për t'u rrënjësuar në gjuhë apo që janë rrënjësuar tashmë”.⁶² Për këtë gjë, në gjuhën shqipe nuk janë vendosur ende disa norma, për të paktën mënyrën e shkrimit të tyre në rastet kur kanë fonema që nuk i përmban shqipja apo ndryshe shkruhen e ndryshe shqiptohen, p.sh. *web (ueb), file (fajl), page (pejxh), review (rivju), play off (p lej of)* etj.

⁶¹ Uanrah Juriel, *Interferenca leksikore*, sipas *Ndikime ndërgjuhësore* përgatitur nga Vesel Nuhiu, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 74-79.

⁶² Kristina Jorgaqi, *Sportel i hapur i shqipes*, Tiranë 2008, f. 36-37.

3. **Fjala e huaj në gjuhën shqipe është zhvilluar me kalimin e kohës duke krijuar edhe fjalë të tjera** si p.sh. *abonohet, abone, abonent, abonim, abonohem, abonuar, adaptoj, adoptim, adoptive, adoptohem, adoptues, angazhoj, angazhohem, angazhim, angazhuar etj.*
4. **Disa huazime kur futen në gjuhën shqipe pësojnë ndryshime duke u përshtatur me të.** Fjalët e huaja arrijnë ta mbajnë theksin e tyre origjinal, vetëm kur ai është i njëjtë me atë të gjuhës shqipe, ndërsa të fjalët që nuk e kanë të njëjtë, theksi zhvendoset në atë rrokje siç duhet në shqip, pra ndodh rregullimi mekanik i theksit. Megjithatë, sot vihet re prirja që fjalët e huaja të shqiptohen me theksin e gjuhës nga është marrë fjala, gjë e cila kritikohet nga studiuesit e gjuhës.

Për t'u bërë ballë huazimeve, nevojitet një punë korrekte e këmbëngulje për të realizuar atë që na takon si shqipfolës apo si studiues të shqipes. Për ta arritur këtë duhet bërë një ndërgjegjësim i masës së gjerë të shqipfolësve se këto huazime që po përdorim çdo ditë e më shumë jo gjithmonë shkojnë në pasurim të gjuhës, por edhe në mbingarkesë e shpeshherë në ngatërresa e deri në keqkuptime në komunikim.

Megjithatë, nga ana tjetër, gjuha shqipe ka nevojë që gjuhëtarët t'u rikthehen rregullave drejtshkrimore që t'i përshtasin me kohën dhe t'u japin drejtim disa çështjeve, të cilat kanë dalë vitet e fundit dhe kanë nevojë për zgjidhje.

Pra, rëndësi në këtë moment ka përmirësimi i standardit, për të cilin prof.dr. Shezai Rrokaj shprehet: "Sa më i plotë të jetë standardi i një gjuhe nga pikëpamja e gjithëpërfshirjes gjuhësore anekënd dhe masës së folësve që e përdorin, aq më shumë rritet qëndresa ndaj trysnisë së huazimeve".⁶³

Të gjithë shqipfolësit, të cilët janë sadopak të ndërgjegjësuar, duhet të japin kontributin e tyre për ta mbajtur sa më të pastër gjuhën shqipe, deri aty ku është e mundur, jo të kërkojmë purizëm, pasi ajo është e pamundur në ditët tona me këto marrëdhënie hyrje-daljes me vendet e tjera. Për më tepër, duke qenë vend i vogël, me pak njerëz dhe ekonomi të dobët në krahasim me fuqitë e shteteve të mëdha, kemi nevojë për përvojën e vendeve më të zhvilluara, teknologjitë më të reja që ato nxjerrin, të cilat futen së bashku me emrat e objekteve e zbulimeve të fundit, por gjithsesi ne duhet të jemi të matur e përzgjedhës.

7.4 Rrafshet gjuhësore ku kanë depërtuar huazimet

Huazimet në gjuhën shqipe kanë depërtuar në të gjitha rrafshet e saj, diku më shumë e diku më pak, si: *fonetikë, leksik, morfologji* dhe *sintaksë*.

Huazimet fonetike janë të rralla, sepse nuk bëhet fjalë për huazim të drejtpërdrejtë të fonemave, por fonema që i shtohen sistemit fonetik të një gjuhe si rrjedhojë e shumësisë së fjalëve të huazuara, të cilat e përmbajnë këtë fonemë. Deri tani në gjuhën shqipe nuk ka raste të huazimeve fonetike, por ka mund të themi se ka prirje të tilla.

⁶³ Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, faqe 122

Huazimet morfologjike kanë të bëjnë me huazimet e mjeteve fjalëformuese, si parashtesa e prapashtesa. Në gjuhën shqipe kemi parashtesa të huaja si: **anti-** (*antiajror, antitank*), **pan-** (*panshqiptar*) dhe prapashtesa të cilat janë më të shumta në numër si: **-icë** (*buallicë, gomaricë*), **-ist** (*xhepist*), **-izëm** (*majtizëm*), **-men** (*bllokmen*).

Huazimet sintaksore kanë hyrë në shqipe kryesisht nëpërmjet gjuhës së shkruar. Duhet të theksojmë se “...në sintaksë ndërtimet e huaja janë edhe më të dëmshme, pasi ato dhunojnë atë që është origjinale dhe e veçantë në ndërtimin e ligjërimit shqip... bashkë me ndërtimet e nevojshme, që e pasurojnë gjuhën, të mos hyjnë ndërtime të panevojshme ose të tilla që cenojnë origjinalitetin e sintaksës së shqipes”.⁶⁴

Leksiku është rrafshi që preket më shumë nga huazimet dhe shembuj të shumtë i kemi paraqitur gjatë gjithë punimit.

Studiuesit Emil Lafe, Eqrem Çabej, Seit Mansaku, Gjovalin Shkurtaç, Shaban Demiraj, Jani Thomai, Shezai Rrokaj, Kristina Jorgaqi, Mehmet Çeliku, Aleksandër Xhuvani, Nikollë Topalli etj. kanë trajtuar çështje të futjes së elementëve të huaj në rrafshet gjuhësore të shqipes, duke i ilustruar me shembuj rastet që kanë shtjelluar. Disa prej këtyre elementëve të huaj dhe shembujt përkatës po i rendisim më poshtë.

7.4.1 Depërtime të trajtës së huaj në rrafshin morfologjik

Element i huaj në shqipe është përdorimi i tepruar i emrave foljorë, si p.sh.: *Marrja e masave të nevojshme për kapërcimin e prapambetjeve në përfundim dhe vënien në shfrytëzim të objekteve prodhuese.*

Në gjuhën shqipe po përdoren në fjali përemrat vetorë pa qenë të nevojshëm, p.sh.: *Kush ndodhej atje? – e pyetëm ne njëzëri.* “Këto përdorime e kanë burimin në gjuhët e sotme evropiane, sidomos në anglishten e frëngjishten, që e kanë thjeshtuar shumë sistemin e mbaresave foljore, duke bërë të domosdoshme vendosjen e përemrave vetorë si tregues të kategorive gramatikore të foljeve”.⁶⁵

Të tepërt janë dhe përemrat dëftorë kur ndiqen nga një përcaktor, si p.sh.: *Artistin e udhëhoqi karakteri i ndjeshëm dhe ai popullor.*

Ndërtim i huaj sipas frëngjishtes është përdorimi i përemrit të pacaktuar *gjithë* përpara formës foljore të përcjellores si p.sh. ...*gjithë duke marrë një kënd shikimi pozitiv.*

Te foljet vihen re përdorime të gabuara të mënyrës lidhore në vend të dëftores ose të përcjellores, pas foljeve që shprehin të perceptuar, të ndier, si: *shoh, shikoj, dëgjoj, ndiej* etj. *Më vjen turp të ketë dalë një i tillë nga shtëpia ime.* “Duke përdorur mënyrën lidhore në vend të paskajores së këtyre gjuhëve është thyer rregulli i bashkëvjajtjes së foljeve, meqenëse në

grupin e foljeve të mësipërme shprehen veprime reale, kështu që ky përdorim i lidhores është shtrirë mjaft në kohën e kryer e më se të kryer”.⁶⁶

⁶⁴ Emil Lafe, *Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë*, SF 4, 1984, f. 88-89.

⁶⁵ Nikollë Topalli, *Për zëvendësimin e ndërtimeve të huaja në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 4, 1986, f. 50.

⁶⁶ Nikollë Topalli, *Për zëvendësimin e ndërtimeve të huaja në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 4, 1986, f.50

Përdorimi i ndajfoljeve që mbarojnë me *-isht* për të treguar një shkallë shumë të lartë janë ndërtime të huaja dhe nuk përshtaten me natyrën e shqipes si: *skajshmërisht, paturpësisht* etj ku ne në vend të tyre mund të përdorim ndajfoljet e sasisë *mjaft, shumë, tepër, fare, krejt* etj.

Ndikim i huaj është edhe shkalla e sipërisë të disa mbiemra me *më* përpara, si: *më se e natyrshme, më se e qartë* ku mund të përdorim ndajfoljet e sasisë *shumë, krejt, fare* etj.

Përdorimi i ndajfoljes *larg* përpara një emri foljor në rasën rrjedhore nuk është i gjuhës shqipe p.sh.: *Larg së shfrytëzuarit tekstin shqip të veprës së tij* në gjuhën shqipe shprehen me mjete të tjera p.sh.: *Pa shfrytëzuar aspak tekstin.*

Vihet re një përdorim i shpeshtë i parafjalëve në, *mbi* dhe *nën* në kurriz të parafjalëve e shprehjeve të tjera, si p.sh. *dramë në (= me) dy pjesë, vend i pasur në (=me) minerale, jemi në lidhje (= jemi të lidhur me të gjithë), shkruaj diçka mbi (= për) ngjarjet e ditës, kishte njoftuar mbi (= për) ardhjen e shokëve, rruga ishte mbi (= më shumë se) 20 km.* Shembuj të tillë, si: *nën shembullin e më të mirëve, nën kujdesin e tyre* mund të shprehen me përcaktorë të veçuar ose me ndonjë parafjalë tjetër p.sh. *sipas shembullit të më të mirëve, me kujdesin e tyre.*⁶⁷

Nga ndikimi i italishtes vjen dyndja e kohës së kryer në dëm të së kryerës së thjeshtë p.sh. *sot ka shkelur tokën shqiptare X*, kur shqip duhet të thuhet *sot erdhi për vizitë ky ose ai.*⁶⁸

Thyerje e rëndë është kur nuk lakohen emrat e përveçëm të huaj ose shkurtimet, p.sh. *takim me Blear* në vend të *takimi me Blerin*, *lajmet e TV KLAN* në vend të *TV KLAN-it.*⁶⁹

Huazimi në morfologji mund të jetë vetëm i ndajshtesave me funksion gramatikor trajtëformues dhe fjalëformues dhe "...kalimi i një ndajshtese me funksion gramatikor nga një gjuhë në një tjetër mund të bëhet vetëm nëpërmjet huazimit të fjalëve, që përmbajnë atë ndajshtesë. Kjo pastaj nëpërmjet fjalëve të huazuara mund të shtrihet edhe në fjalët e tjera me burim vendës".⁷⁰

Megjithatë "...pas një shoshitje të imët të të dhënave gjuhësore, është arritur në përfundimin që ndikimet e huaja mbi ndërtimin morfologjik të gjuhës shqipe ose janë të paqena, ose janë të parëndësishme, sidomos kur është fjala për ndajshtesat me funksion trajtëformues".⁷¹

⁶⁷ Po aty, f.50-55

⁶⁸ Gjovalin Shkurtaç, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë 2003, f. 82.

⁶⁹ Gjovalin Shkurtaç, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folura*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 31-32.

⁷⁰ Shaban Demiraj, *A ka ndikime në strukturën morfologjike të shqipes*, Gjuha jonë 2, 1981, f. 35.

⁷¹ Po aty, f. 35

7.4.2 Depërtime të strukturës së huaj në rrafshin sintaksor

Në rrafshin sintaksor po vihet re përdorimi i tepërt i ndërtimeve pësore në vend të atyre veprorë, si: *Nga nxënësit po punohet me vrull për...; X. Y. në zotërim të topit (Nxënësit po punojnë me...; X. Y. zotëron topin).*

Gjithashtu, është vënë re zëvendësimi i lokucioni *gjë që me lidhëzën çka*, p.sh.: *Ëndërronte të bëhej artist, gjë që s'i hiqej nga mendja ose çka s'i hiqej nga mendja*, por së fundi ka filluar të përdoret edhe përemri *çfarë ...çfarë s'i hiqej nga mendja*.

Ndikime të huaja të qortueshme janë edhe shprehjet *bëj përkthyesin, bëj kamarierin etj*.⁷²

Ka marrë përhapje të gjerë forma pësore *u lind* p.sh. *u lind në Shkodër më...* ku zgjedhohet si vetvetore, kurse në gjuhën shqipe folja *lind* zgjedhohet si veprorë p.sh. *kur ke lindur dhe jo kur je lindur*.

Në gjuhën shqipe ndërtohen përcaktorë me parafjalën *me* p.sh. *ngjarja me rëndësi të madhe, vepër me nivel të lartë, problem me karakter politik etj.*, ndërsa nën ndikimin e gjuhëve të huaja po përdoret ndërtimi me gjinore: *ngjarje e një rëndësie të madhe, vepër e një niveli të lartë, problem i karakterit politik*.

Ndërtime me emra në rasën gjinore në funksion përcaktori a kallëzuesori janë ndikim i huaj p.sh.: *I një rëndësie të veçantë është fakti...* ndërsa në shqip kjo fjali mund të shprehet me emra në rasën kallëzore, të shoqëruar me parafjalën *me*, me ndërtime mbiemërore etj.: *Këto vendime ishin me rëndësi të veçantë*.

Sipas ndikimit sllav, po ndërtohen gjithnjë e më shumë struktura të tilla, si: *duhen përkrahur propozimet e..., i falënderohem dikujt për diçka, lajmërohem në telefon në vend të përkrah propozimet e... ose falënderoj dikë për diçka, dal në telefon*.⁷³

Nën ndikimin e gjuhëve të huaja, shpesh thuhet *jap shpjegime mbi diçka* në vend që të thuhet *jap shpjegime për diçka, periudha nën sundimin e Turqisë në vend të gjatë sundimit të*

Turqisë, punonte nën shembullin e më të mirëve në vend të thuhet sipas shembullit të më të mirëve.⁷⁴

Sipas shprehjes angleze *good luck* - fat të mbarë, apo italishtes *buona fortuna* - paç fat, po përdoret në vend të shprehjes shqipe *të priftë e mbara*. Shprehja italiane *mi sei mancato* apo anglishtes *I missed you* - më ke munguar po përdoret me kuptimin *më ka marrë malli*. Sipas shprehjes italiane *ci vediamo* - shihemi, *ci sentiamo* - dëgjohemi janë shprehje që po mundohen të zënë vendin e gjegjëseve shqipe *mirupafshim, mirudëgjofshim*. Sigurisht që në shqip mund të themi *do të shihemi* ose *do të dëgjohemi* në kohën e ardhme të thjeshtë, por kurrsesi në mënyrën urdhërore.⁷⁵

⁷² Seit Mansaku, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 26-27.

⁷³ Emil Lafa, *Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare*, Gjuha jonë 3-4, 1992, f. 51.

⁷⁴ Shezai Rrokaj, *Dy çështje për mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollë*, Akte të konferencë shkencore – zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, f. 50.

⁷⁵ Edmond Tupe, *Fjalë e struktura të huaja: (kundër) veprimi i shqipes*, SF 1-2, 2007, f. 129.

Përshëndetja *mirëdita* po përdoret në vend të shprehjes shqipe *tungjatjeta*, duke ndjekur shprehjen italiane *buongiorno* apo franceze *bonjour*:

Më thuaj është shprehje e përkthyer fjalë për fjalë nga italishtja *dimmi*, kur në shqipe kemi shprehjet *Kishe ndonjë gjë? Me çfarë mund të ndihmoj?* Sipas përkthimit nga italishtja e fjalës *Scordatelo!* ka filluar të përdoret *Harroje!*, ndërkohë që kemi shprehjet në shqip *As mos e çoj nëpër mend! As të mos të shkojë në mendje!* ose *Hiqe nga mendja!*⁷⁶

Shprehja *me në krye presidentin* është ndikim i huaj nga frëngjishtja *avec a satète*, sepse në shqip nuk mund të ketë dy parafjalë që shprehim marrëdhënie sintaksore të ndryshme para të njëjtit emër. *Nuk do të mungoj t'i them të falat e tua* sipas frëngjishtes *ye ne mangue pas de lui dire*. Shqipja ka ndërtimin e vet *nuk do të harroj t'i them*. Lidhja semantiko-sintaksore e foljes *mungoj* me foljen *them* është sipas ndikimit të frëngjishtes. Frazat që fillojnë me *është ky që* nuk është e shqipes, por si ndikim i frëngjishtes.

7.4.3 Depërtime të fjalës së huaj në rrafshin leksikor

Në leksik ndikimi i huaj ka depërtuar aq shumë dhe përdoret vazhdimisht, sa jo rrallëherë është bërë e vështirë për të dalluar cila mënyrë apo formë është e gjuhës shqipe dhe cila e huaj. Kjo gjë duket qartë dhe nga shembujt e dhënë në fjalor me rreth 830 fjalë të huaja në kreun IX dhe shembujt e dhënë gjatë çështjeve që kemi trajtuar në punim.

7.4.4 Depërtim të prapashtesave të huaja në fjalëformim

Në formimin e fjalëve të reja të shqipes të përdoren disa prapashtesa me burim nga gjuhë të tjera, si:

1. Të huazuara nga gjuha sllave –*aç* (*gungaç, rrugaç*); –*ac* (*përtac, dorac, tullac*); –*nik, -anik* (*shtatanik, thatanik*); –*avec* (*grindavec, mburravec*); –*icë* (*rrugicë, pakicë*)⁷⁷
2. Huazuar nga greqishtja e re –*os* (*kripos, plehëros*); –*omë* (*baltomë, fromë*);
3. Huazuar nga turqishtja –*çe* (*shkodrançe, turçe*); –*xhi* (*fshesaxhi, furrëxhi*)⁷⁸ etj.

7.4.5 Depërtime të trajtës së huaj në terminologji

Termet e huaj në gjuhën shqipe i kemi dy llojesh:

- a. Terma të huaj me shtrirje ndërkombëtare, si *amnistia, agjenci, anarki, kapital, kredi, standard* etj.
- b. Terma që nuk kanë shtrirje ndërkombëtare, por që janë pranuar si të domosdoshme

⁷⁶ Po aty, f. 129, 130.

⁷⁷ Anastas Dodi, *Rreth huazimeve sllave dhe vendit të tyre në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 1-4, 1995, f. 59.

⁷⁸ Nikollë Topalli, *Për mënjanimin e ndikimit të huaj në fjalëformimet prapashtesore*, Gjuha jonë 2, 1989, f. 55-56.

ose janë gjykuar si të nevojshme në përdorim derisa t'u gjendet barasvlerësi i përshtatshëm shqip si: *ankand, dekoratë, dispozitë, klauzolë, prokurë, seancë, testament, audiencë, konfiskim etj.*

Problem për terminologjinë në ditët e sotme është rikthimi i përdorimit të termave të huaj, të cilët e kanë barasvlerësin shqip, si p.sh. *abandonim, adoptim, bilateral etj.* në vend të fjalëve shqip *braktisje, përshtatje, dypalëshe etj.* Problem tjetër është edhe përdorimi i termave të huaj krahas termave po të huaj, që kanë qenë në përdorim, p.sh. *draft, publicitet, menaxhim, trajnim etj.* krahas termave *projekt, reklamë, administrim, kualifikim etj.*⁷⁹

Kemi vënë re se po dyfishohen termat e huaj, në vend që për ata ekzistues të gjendet aty ku është e mundur barasvlerësi në gjuhën shqipe.

7.4.6 Depërtime të strukturës së huaj në frazeologji

Ndikime të huaja kanë depërtuar edhe në frazeologji, si p.sh. *u hedh pluhur syve* në vend të *u hedh hi syve, mbaj parasysh* në vend të *kam parasysh*. Janë krijuar dhe shprehje të tilla si *nuk më premtan koha* në vend të *nuk kam kohë* ose *nuk më del koha*.⁸⁰

Krijime të shqipes po zëvendësohen shpesh nga imitime dhe kalke gjuhësore, si p.sh. *ishte gjysmë i vdekur*, sipas gjermanishtes *halbtot*, në vend që të përdoret *po jepte shpirt, dukej si i vdekur etj.*; ose *bëni kujdes*, sipas italishtes *fate attenzione*, në vend që të thuhet *kini kujdes, tregoni kujdes, jini të kujdesshëm etj.*; shprehja *marr në konsideratë*, sipas frëngjishtes *prendre en consideration*, në vend që të thuhet *kam parasysh, marr parasysh etj.*; shprehja *mbi të gjitha*, sipas anglishtes *above all*, në vend që të thuhet *sidomos, veçanërisht etj.*; shprehja *marr mbi vete*, sipas frëngjishtes *prendre sur soi*, në vend që të thuhet *marr përsipër etj.*⁸¹

⁷⁹ Hëna Pasho, *Probleme të terminologjisë teknike-shkencore në gjuhën e shtypit dhe të radiotelevizionit*, Gjuha jonë 1, 2000, f. 42-45.

⁸⁰ Emil Lafa, *Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë*, SF 4, 1984, f. 89.

⁸¹ Shezai Rrokaj, *Dy çështje për mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollë*, Akte të konferencë shkencore – zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, f. 51.

KREU VIII

8. Fjala e huaj në këndvështrimin e medias së shkruar

Gjuha është në zhvillim të pandërprerë dhe fjalët e huaja, të cilat janë bërë pjesë e saj, kanë zhvillimin e tyre. Disa zhvillohen e krijojnë çerdhe fjalësh, ndërsa disa të tjera dalin në periferi të gjuhës duke mos u përdorur më. Synimi ynë është të shikojmë nga ana sasiore fjalët e huaja në shtypin e përditshëm, pasi dukuria e sipërpërmendur do më shumë kohë që të vihet re se ç’do të ndodhë me fjalën, nëse do të bëhet pjesë e shqipes apo jo.

Kemi bërë një vëzhgim të dy gazetave të përditshme në vite të ndryshme për të parë nëse po shtohet apo po pakësohet numri i fjalëve të huaja që përdoren nëpër gazeta. Si kampion, kemi marrë gazetën “Tema” të viteve 2000, 2011 dhe gazetën “Shqip” të viteve 2006, 2011.

8.1. Fjalë të huaja në gazetën “Tema”, 18-25 qershor 2000

Fjalët e huaja të kësaj gazete po i rendisim më poshtë:

Adoptuar	Decentralizim	Emancipim
Ingredient	Inicim	Kremtim
Agresiv	Deciziv	Eminent
Anonimati	Demonstrim	Esencial
Anullim	Desintegrim	Eskortë
Apolitik	Destabilitet	Eventualisht
Aprovoj	Diapazon	Evituar
Aspektin	Dilemë	Falso
Atakim	Disfatë	Finale
Atribuoj	Disponim	Formalitate
Avancim	Dispozitiv	Funeral
Avantazh	Distancë	Graduale
Bipolar	Diversion	Imazhi
Bodigardët	Eksentrik	Impakt
Bojkotim	Ekspertët	Impenjuar
Brutalitet	Ekspluzion	Implikim
Konsensus	Elektoratin	Incident

Injorim	Lidership	Rezistencë
Inkurajim	Lider	Rezultont
Insistoj	Linguistik	Rival
Instruktuar	Margjinalizim	Rurale
Integroj	Marshim	Sanksione
Joefikase	Mazhorancë	Sfidant
Kalibruara	Metrizant	Sintoni
Kapluar	Militant	Skalione
Karizmatik	Minirevoltë	Sofistifikim
Klandestinë	Minoritet	Spikat
Koalicion	Multietnike	Spontanisht
Kolaps	Obligim	Stabilitet
Komplekse	Ofensivë	Statuskuosë
Komplementim	Oponent	Substanciale
Konfidenciale	Paprecedent	Superior
Konfirmoj	Plebishitare	Supozojnë
Konfrontim	Potencial	Taktikë
Konfuzitet	Prelud	Tendencë
Konkludim	Premtim	Tentativë
Konkluzionet	Pretendime	Transferim
Konsiston	Prezent	Tranzicion
Konstruktiv	Princip	Rezervoj
Kontigjent	Progres	Uikend
Kontrabandë	Proporcional	Unanim
Konvencional	Protokoll	Unitet
Koordinim	Reflektim	Uzulpim
Korruptim	Reciprokisht	Vakant
Kredenciale	Reduktimi	Vanitoz

8.2 Fjalë të huaja në gazetën “Tema”, 23 qershor 2011

Fjalët e huaja të kësaj gazete po i rendisim më poshtë:

Adekuate	Fluks	Kontigjencë
Akredituar	Fokus	Kontravers
Akt – padi	Fonde	Kontribut
Akumulim	Identifikim	Korentë
Aluzion	Imediat	Kosolidim
Ambiguitet	Impakt	Kosto
Analog	Impenjim	Kreditet

Ankora	Importim	Kualifikim
Anonim	Imunitet	Lokale (zgjedhje)
Apolitik	Incident	Legalizim
Asistencë	Indirekt	Lider
Aspirat	Inerci	Lidership
Atribuim	Inflacion	Likuiditet
Axhendë	Iniciativë	Live
Bonuse	Inkurajoj	Monitoroj
De facto	Inovacion	Manipulim
De jure	Koalicion	Maturitet
Debutim	Kolateral	Minimale
Deficit	Kombinim	Mirëankorim
Deformim	Kompromis	Ofron
Dekadë	Konfident	
Destruktiv	Konfirmim	Opozitar
Efikas	Konfliktim	Opsion
Ekspertizë	Konkluzion	Pakontestueshme
Ekspert	Konkrete	Pankinë
Eksplite	Konsideratë	Paramilitar
Ekspozim	Konsolidim	Partner
Elektorat	Konstatim	Platform
Finalizimin	Kontakt	Preferoj
Presupozon	Kontekst	Prespektivë
Primarisht	Privilegj	Proaktiv
Prioritet	Procedim	Produktiv
Prognozën	Protokoll	Rakordim
Realizim	Reciprok	Reduktim
Rekomandim	Relative	Rivitalizim
Rezistencë	Ribalancim	Rigorozitet
Risk	Rival	Sajt
Sfidë	Shans	Shokoj
Showbiz	Soft-in	Sondazh
Spekulim	Sportivitet	Stabilitet
Stopim	Strategji	Sugjerim
Supreme	Tabulim	Tenton
Në këtë grupim futen fjalët të cilat nuk janë zhvilluar më tej: *agjent, amortizim, alivani, delikat, dilemë, ekspert, final, gjigant, hipotezë, identik, inflacion, incident, interval, kaos, kapacitet, kauzë, konditë, kontradiktë, kontrast, maksimal, maternitet, monoton, opinion, patronazh, relative, sanksion, situatë, tendencë* etj.

9.1.2 Fjalë të cilat nuk ndodhen tek asnjëri nga fjalorët

Ky grupim fjalësh, meqë nuk ndodhen tek asnjëri nga fjalorët, do të thotë që janë futur kohët e fundit dhe se si do të reagojë gjuha ndaj tyre do të shihet në të ardhmen nëse do t’i bëjë pjesë të saj apo jo. Disa pre tyre janë: *abonoi, abandonoi, akomodim, amplifikoi, joefikase, kalorimetër, kolaps, kompensim, konfondo, konstituim, kompeticion, lançim, luk, memorial, multinacional, opsion, ospitoj, i patrukuar, posesiv* etj.

9.1.2.1 Fjalë të cilat nuk ndodhen në asnjë nga fjalorët dhe kanë krijuar çerdhe fjalësh

Në këtë grupim futen fjalët: *amplifikoj, anonçoj, civilizoj, deziluzion, disproporcion, elaboroj, ezauroj, inskenoj, insistoj, intoksikoj, kalkuloj, konciz, konfuz, luçidoj, neglizhencë, preciz, predispozicion* etj. Këto fjalë, meqë kanë pasur një lloj zhvillimi, mund të shikohen si të mundshme për t'u futur në fjalorët e viteve të ardhshme.

9.1.2.2. Fjalë të cilat nuk ndodhen në asnjë nga fjalorët dhe nuk kanë krijuar çerdhe fjalësh

Në këtë grupim futen fjalët: *ankora, auditiv, badigard, bonus, difensivë, demontim, destinacion, donator, eksplicite, ekuivok, etazher, fleksibël, gjenocid, gusto, grataçel, iminent, inkasoj, koincidencë, kompensim* etj. Sipas gjasave, këto fjalë mund të dalin nga përdorimi, pasi në gjuhën shqipe nuk kanë arritur të zhvillohen.

9.1.3 Fjalë të cilat nuk ndodhen në fjalorin e vitit 1954, por janë në tre fjalorët e tjerë

Pasqyrimi i këtyre fjalëve në këta fjalorë vërteton atë çka është thënë gjithmonë se në gjuhë me kalimin e viteve bëhen ndryshime dhe futja e fjalëve të huaja nuk bën përjashtim, pra gjuha është vazhdimisht nën trysinë e tyre dhe një pjesë janë përfshihen në fjalor, si: *adekuat, aksion, ambientohem, atribut, avancë, avantazh, denigroj, devocion, diapazon, dislokoj, eksploroj, elitë, front, ilaritet, impiant, kamuflim, kontekst, konvertoj, limit, oponent, replikë* etj.

9.1.4. Fjalë të cilat nuk ndodhen në fjalorët e viteve 1954, 1980 dhe 2002, por ndodhen vetëm në fjalorin e vitit 2006

Futja e këtyre fjalëve në fjalorin e vitit 2006 tregon se ato janë përdorur vazhdimisht nga shqipfolësit, pra e kanë parë të nevojshme t'i bëjnë pjesë të leksikut të saj. Këtu bëjnë pjesë këto fjalë, *tranzicion anglofon, destabilitet, donator, evitohet, kolaps, konsensus, mazhorancë, obligim, superior, reduktim, vizionar* etj.

9.1.5 Fjalë të cilat ndodhen në fjalorin e vitit 1954 dhe 2006, kurse në fjalorët e viteve 1980 dhe 2002 jo

Ky grup fjalësh tregon për një dukuri të kohëve të fundit ku po rikthehen në përdorim fjalë të huaja, të cilat gjuha shqipe tashmë i kishte zëvendësuar për më shumë se 50 vitesh me gjegjëset në gjuhën shqipe. Fjalë të tilla janë: *absorboj, ambulat, asistoj, bravo, inkuadroj, inovacion, inspiroj, intervenoj, intolerancë, intrasigjent, kaligrafi, konsultoj, koordinoj, legalizim, ofroj, orient, perfekt, permanent, posedoj, rigoroz, sensibil, supersticion, suplement, transformoj, transparent*.

9.1.6 Fjalë të cilat janë të përfshira në fjalorin e vitit 1954, por jo në tre fjalorët e tjerë

Kjo tregon për natyrën e gjuhës që një pjesë të fjalëve i kalon në periferi të saj, derisa i nxjerr fare nga përdorimi si në fjalët e mëposhtme: *afinitet, akcent, aproksimativ, atak, dakord, de facto, de jure, deskriptiv, destinoj, determinoj, direkt, disponoj, eksplodon, gratis, indirekt, inferioritet, koncentroj, kondicionoj, konsiston, konsolidim, konstante, kontestoj, kualitet, kuestionar, kurbë, kurioz, legjitim, medicinë, persekutoj, predominon, presing, prezencë, privoj, solid, sprovë, strapacim, tekstual, vakant, violencë.*

9.1.7 Fjalë të cilat nuk ndodhen tek fjalorët e viteve 1954, 1980, por gjenden tek fjalorët e viteve 2002, 2006

Këto fjalë tregojnë se kanë depërtuar në gjuhë pas viteve '80 dhe kanë vazhduar të përdoren deri në vitin 2006 e në vazhdim, meqë përfshihen në të. Fjalët që i përkasin këtij grupimi janë:

1954	1980	2002	2006	Fjalët e huaja
-	-	+	+	Afeksion, ekzagjeroj, evakuj, evidentoj, evokoj, fokus, imponim, marketing

9.1.8. Fjalë të cilat ndodhen tek fjalorët e viteve 1954, 1980, por nuk gjenden tek fjalorët e viteve 2002, 2006

Këto fjalë tregojnë se kanë depërtuar në gjuhë deri në vitet '80 dhe kanë dalë nga përdorimi i shqipfolësve më pas, meqë nuk përfshihen tek fjalorët e viteve të mëvonshme. Fjalët që i përkasin këtij grupimi janë:

1954	1980	2002	2006	Fjalët e huaja
+	+	-	-	Bazal, fekondoj, silvikulturë

9.1.9 Fjalë të cilat nuk kanë një zhvillim të rregull duke u bazuar nga mënyra se në cilin fjalor janë vendosur e në cilin jo

Meqë janë të pakta në numër po i vendosim në një tabelë ku me shenjën + do të japim praninë e fjalës në fjalor dhe me shenjën – mospraninë e saj. Renditjen e fjalorëve e kemi sipas vitit të botimit, pra 1954, 1980, 2002 dhe 2006.

1954	1980	2002	2006	Fjalët
-	+	-	+	Abort, brefotrof, defekt, dekurajoj, densitet, prioritet, probabël, rezulton, version, vizion
-	+	-	-	Atraksion, bashkëpatriot
-	-	+	-	Balotazh, barrierë
+	-	+	+	Ekzakt, ekzemplar, eventual, verbal
+	+	-	+	Adaptoj, dedikoj, definitive, dimension, ekuivalencë, gjiton, igrasi, kontrakt, kundërofensivë, kurajë, neutral, produktiv, proklamoj, promemorie, proporcion, proverbial, provizor, tranzitor, tromaks
-	+	+	-	Alegro

Ky reflektim i çrregullt vjen si pasojë e harresës së këtyre fjalëve nga hartuesit e fjalorëve, pasi diferenca mes viteve të botimit të fjalorëve është e vogël dhe fjala nuk ka një zhvillim aq të shpejtë sa të dalë e të hyjë në gjuhë brenda një periudhe të shkurtër kohore.

Për fjalën e fundit përkatësisht *alegro*, e kemi hasur në mbledhjen e fjalëve të huaja të viteve të fundit, kështu që nuk e shohim të arsyeshme të mos jetë në fjalorin e këtij viti.

9.1.10. Fjalë të cilat ka ndryshim të një tingulli nga pasqyrimi në fjalorin e vitit 1954 dhe në fjalorin e vitit 2006

Disa nga fjalët që kemi vëzhguar kanë ndryshuar formën e tyre tingullore me një shkronjë. Po i rendis më poshtë në një tabelë, duke treguar dhe fjalorin ku ato ndodhen:

Fjalori i vitit 1954	Fjalori i vitit 2006
De fa <u>k</u> to	De fa <u>ç</u> to ²¹
Funk <u>ç</u> ion	Funk <u>ç</u> ion
Hemor <u>r</u> agji	Hemor <u>rr</u> agji
Instruk <u>ç</u> ion	Instruk <u>ç</u> ion
Protokol	Protokoll
Sank <u>ç</u> ion	Sank <u>ç</u> ion
Selek <u>ç</u> ionoj	Selek <u>ç</u> ionoj

Fjalët *de fakto*, *funksion*, *hemoragji*, *instruksion*, *protokoll*, *sanksion*, *seleksionoj* kanë këtë formë tingullore sepse i janë përshtatur sistemit fonetik të shqipes, ndërsa gjegjëset e tyre sipas tabelës përkatësisht *de facto*, *funkcion*, *hemorragji*, *instruksion*, *protokol*, *sakcion*, *seleksionoj* është forma tingullore e gjuhës nga ka ardhur.

9.1.11 Fjalë të cilat kanë të njëjtën formë, por u ndryshon kuptimi nga një fjalor në tjetrin

Akreditoj në fjalor është me kuptimin diplomatik, caktoj **dikë si përfaqësues diplomatik në një shtet tjetër**. Kurse sot ka marrë kuptim tjetër si p.sh *Universitet i akredituar*.

Alegro gjendet në fjalor me kuptimin **Në mënyrë të shpejtë e të gëzueshme (për ekzekutimin e një pjese)** ndajf. muz. Kurse sot përdoret në kuptimin si *njeri që jep gëzim* p.sh *ai i dha shfaqjes, mbrëmjes alegri*.

Amator në fjalor del me kuptimin **ai që është i dhënë pas diçkaje me dashuri... pa e patur si profesion** p.sh *amator lulesh, piktor amator*. Kurse sot del edhe me kuptimin **si një njeri fillestar në një punë të caktuar** p.sh. *fati i amatorit – fati i fillestarit*.

²¹ Nuk gjendet në fjalorin e vitit 2006, por është marrë nga gazetat e përditshme të kohëve të fundit.

Bord në fjalorët e viteve 1984, 2002 pasqyrohet me kuptimin e **faqes anësore të anijes, barkës ose anija kundrejt mjedisit rreth saj**, kurse në fjalorin e 2006 gjendet me kuptimin **grup drejtues i institucionit**. Sot ka marrë një kuptim tjetër **këshill** p.sh. *bordi drejtues – këshilli drejtues*.

Disonancë në fjalor del si term muzikor prishja e harmonisë së tingujve, por sot përdoret me kuptim tjetër, **mospërputhje** p.sh. *jemi në disonancë me njëri-tjetrin – kemi mospërputhje me njëri-tjetrin*.

Inteligjencë në fjalorin e vitit 1954 ka si kuptim të dytë **zgjuarsi**, kurse në fjalorët e viteve 1980, 2002 nuk ndodhet. Në fjalorin e vitit 2006 paraqitet me këtë kuptim **zgjuarsi**, ndërsa fjala **inteligjent** del si fjalë më vete. *Ky është djalë inteligjent – djalë i zgjuar*.

Koherent sot ka marrë kuptim tjetër **i kohës**, ndryshe nga kuptimet që paraqiten në fjalorë

Kuotë ka marrë kuptim tjetër, **kuotat për secilin fakultet apo degë studimi**, kurse në të katër fjalorët ka kuptimin e **lartësisë së një vendi pa emër në hartën topografike**.

Kuroj sot ka marrë kuptim tjetër **kujdesem**, *ka kuruar veshjen time – është kujdesur për veshjen time*. Në fjalor del me kuptimin **mjekoj sëmundjen ose mbikëqyr të sëmurin**.

Perfekt në fjalorin e vitit 1954 është si term gramatikor, **koha e kryer**, kurse sot përdoret me kuptimin **i përkryer**.

Unik ka kuptimin që është **një, i njëjtë** në fjalorët e viteve 2002, 2006. Në fjalorin e vitit 1980 përveç këtij kuptimi, ka kuptimin **tri vjetët që vijnë pas shkollës fillore**, dhe në fjalorin e vitit 1954 ka dhe kuptimin **zyrtar i pakëputur**.

Destinoj në fjalorin e vitit 1954 del me kuptimin **zgjedh një gjë për një punë a një qëllim të caktuar**, kurse sot del me kuptimin **paracaktuj**.

Indeks në fjalorin e vitit 1954 del me kuptimin **katalogu që përmbledh gjithë ato libra që kisha katolike ia ndalon të krishterit t'i lexojë, këndojë**, kurse në fjalorët e viteve 1980, 2002, 2006 del me kuptimin **shenjë që u vihet përbri shkronjave të një shprehje për t'i dalluar**.

Inferior në fjalorin e vitit 1954 del me kuptimin **nëpunësi ose ushtaraku që është në urdhrin e eprorit**, kurse sot është futur në përdorim me kuptimin **nënvlerësim**. Në fjalorët e viteve të mëvonshme nuk pasqyrohet kjo fjalë.

9.1.12 Fjalë të cilat kanë shtuar çerdhen e fjalës ose e kanë pakësuar atë

Kamufloj ka marrë një zhvillim të ri që nuk ndodhet tek fjalorët, **kamuflazh**. **Konsulent** nuk ndodhet tek çerdhja e fjalëve në asnjë fjalor.

Konvertim sot përdoret, por nuk jepet në fjalorin e vitit 2002, kurse në fjalorin e viteve 1980 dhe 2006 po.

Korrupsion që sot përdoret nuk ndodhet në fjalorët e viteve 1980, 2002 vetëm tek fjalori i vitit 2006.

Linguist mungon tek fjalori i vitit 2002, ndërsa tek fjalorët e tjerë gjendet.

Stabël nuk gjendet në fjalor tek çerdhja e fjalës **stabilitet**.

Stop ndodhet në fjalorët e viteve 1980, 2002, 2006, kurse **stopim** që përdoret sot nuk gjendet tek asnjëri nga fjalorët.

Kontrakt në fjalorin e vitit 1980 ka 5 fjalë si pjesë të çerdhes së tij, në fjalorin e vitit 1980 ka një fjalë, në 1954 dy fjalë, kurse tek fjalori i vitit 2002 nuk është përfshirë fare.

9.1.13 Fjalë të cilat u ka ndryshuar numri i kuptimeve nga njëri fjalor tek tjetri

Disonancë në fjalorin e vitit 1980 ka 3 kuptime, kurse në fjalorin e vitit 2002 ka 2 kuptime, ku mungon kuptimi **mospërfillje** që përdoret sot.

Farsë fjalori i vitit 1954 ka 1 kuptim, 1984 ka 2 kuptime, 2002 ka 2 kuptime dhe 2006 ka 2 kuptime, përkatësisht **lloj komedie e shkurtër me një akt**, **b. Lojë a veprim për të mashtruar dikë**.

9.1.14 Fjalë të cilat janë reflektuar ndryshe në fjalorë të ndryshëm

Në fjalorin e vitit 1980 gjenden fjalët **densitet**, dhe **denduri** kurse tek fjalori i vitit 2002 pasqyrohet vetëm fjala **denduri**, pra ka dalë fjala e huaj dhe ka mbetur vetëm fjala e burimit të shqipes.

Në fjalorin e vitit 2002 gjendet vetëm fjala përmasë, kurse tek fjalori i vitit 1980 gjenden të dyja fjalët shqip dhe e huaj, përkatësisht, **dimension** dhe **përmasë**.

9.2 Shqyrtimi i fjalëve të huazuara sipas mënyrës së ndërtimit

9.2.1 Huazime të ndërtuara me parashtesë shqipe dhe temë të huaj

Fjalë me këtë mënyrë ndërtimi janë: *joefikase, jolegal, pakondicionuar, pakontestueshëm, patrukuar, riafirmim, ribalancim, ridefinim, rikuperim, rivitalizim etj.*

9.2.2 Huazime të ndërtuara me një temë shqipe dhe një temë në gjuhë të huaj

Fjalë me këtë mënyrë ndërtimi janë: *bashkëekzistencë, bashkëpatriot, mirëakordim, kundërofensivë etj.*

9.2.3 Huazime të ndërtuara me dy tema në gjuhë të huaj

Huazime të cilat janë ndërtuar me dy tema në gjuhë të huaj janë: *medikolegal, minirevoltë, multinacional, low cost, play off, hi – tech, feedback etj.*

9.2.4 Huazime të ndërtuara më parashtesë të huaj dhe një temë në gjuhë të huaj

Fjalë me këtë mënyrë ndërtimi janë: *apolitik, decentralizoj, dekurajoj, demontim, demaskoj, destabilitet, disavantazh, dispozicion, dispropocion* etj.

9.3 Fjalë të huazuara sipas mënyrës së zëvendësimit me fjalë të gjuhës shqipe

9.3.1 Fjalë të huazuara të cilat zëvendësohen plotësisht me fjalë shqipe

Disa nga fjalët e huaja që kemi arritur t'i zëvendësojmë plotësisht me fjalë të gjuhës shqipe janë: *Abandonoj (braktis), definicion (përkufizim), devijoj (shmang), deziluzion (zhgënjim), difezë (mbrojtje), donator (dhurues), eksperience (përvojë), indirekt (jo drejtpërdrejt), insistoj (këmbëngul), konflikt (mosmarrëveshje), kreativ (krijues), obligim (detyrim), preferoj (parapëlqej), rival (kundërshtar), spostoj (zhvendos), vakant (bosh)* etj.

9.3.2 Fjalë të huazuara të cilat zëvendësohen pjesërisht ose jo në të gjitha kuptimet me fjalë shqipe

Disa nga fjalët që i përkasin këtij grupimi janë: *Akostoj, asociacion, aspiratë, evokoj, fuksionoj, identifikoj, ilaritet, imunitet, imponante, inerci, inkuadroj, kapacitet, kompetencë, kredencialet, oponent, prelud, prenotim* etj.

PËRFUNDIMET

Në këtë punim synuam të bëjmë një përbledhje të huazimeve të cilat janë futur në shqipe në periudha të ndryshme kohore, por pjesën më të madhe të studimit e kanë zënë huazimet që janë futur pas viteve '90. Shtysa për përzgjedhjen e kësaj teme ka qenë evidentimi çdo ditë e më shumë i huazimeve të panevojshme në komunikimin e përditshëm. Identifikimin e fjalëve të huaja e kemi bërë nga media e shkruar, radiofonike, televizive dhe komunikimi mes shqipfolësve. Nga i gjithë studimi kemi dalë në disa përfundime.

➤ Gjuha shqipe është ndër ato gjuhë e cila merr fjalë nga gjuhët e tjera për disa arsye, si: a) Është gjuhë e një vendi të vogël nga numri i popullsisë e i varur ekonomikisht e politikisht nga shtete më të fuqishme, b) Hapësira gjeografike ku shtrihet Shqipëria është mes dy vendeve me kulturë të madhe, si Italia e Greqia dhe ndikimi i tyre është më i madh se forca e shqipes për t'u bërë qendresë.

Ndërsa përhapja e huazimeve në gjuhën shqipe është e kushtëzuar nga disa faktorë si: globalizmi, emigrimi, arsimimi jashtë vendit, politikat e shkollimit dhe të punësimit, folësi dygjuhësh dhe martesat e përziera.

➤ Problemet që vijnë prej përdorimit të huazimeve në shqipe kanë të bëjnë me faktin se jo gjithmonë përdoren saktë, në mënyrë të drejtë apo nuk merret parasysh nëse shqipja ka nevojë për atë fjalë, pra ka hapësira boshe të pambuluara nga fjalë të shqipes. Këto ndikohen nga disa arsye si: 1. Shkalla sa e njeh folësi gjuhën e tij amtare; 2. Sa e njeh gjuhën e huaj nga e cila po merr fjalën; 3. Folësi huazues a është njohës i mirë i rregullave drejtshkrimore e drejtshqiptimore, i veçorive gramatikore të gjuhës amë, që kur të fusë një fjalë të huaj në përdorimin e tij vetjak t'ua përshtatë saktë këtyre rregullave; 4. A e shikon si mundësi të parë të krijojë një fjalë nga vetë burimi i shqipes d.m.th. dialektet, të folmet krahinore etj., apo parapëlqen ta marrë tek një gjuhë tjetër.

➤ Gjatë një akti komunikimi dërguesi dhe marrësi kanë të përbashkët kanalin dhe kodin. Sipas vëzhgimeve tona kemi vënë re se, kur përdoren fjalë të huaja gjatë komunikimit fillon edhe vështirësia për të kuptuar folësin, e cila qëndron në faktin se dërguesi dhe marrësi nuk kanë të njëjtin sistem gjuhësor, pra nuk përdorin të njëjtin kod. Si rrjedhojë dalin disa situata problemore në komunikim të tilla si: 1. Kur marrësi është folës njëgjuhësh, pra flet vetëm gjuhën amtare dhe dërguesi është folës dygjuhësh; 2. Kur marrësi dhe dërguesi zotërojnë dy gjuhë (nga një gjuhë tjetër përveç gjuhës amtare), por kjo gjuhë e dytë nuk është e njëjtë për ta; 3. Kur marrësi dhe dërguesi zotërojnë të dy të njëjtën gjuhë të huaj, por niveli dhe cilësia e përvetësimit të saj është i ndryshëm për secilin. Nga kjo del se gjatë komunikimeve ku përzihen fjalë të shqipes me huazime shpesh herë lënë hapësira për keqkuptime e mosmarrëveshje mes shqipfolësve. Në qoftë se folësi gjatë komunikimit përdor fjalë të huaja, të cilat dëgjuesit nuk ua dinë kuptimin apo e marrin kuptimin e këtyre fjalëve të shtrembëruar

sipas njohurive që kanë, mund të themi me siguri se nuk është arritur komunikimi, sepse mesazhi nuk është marrë i plotë dhe i saktë. Për këtë arsye shqipfolësit më së shumti i përdorin huazimet: *së pari*, në shoqërinë e tyre të cilët pak a shumë përkrijnë me nivelin e tyre arsimor, *së dyti*, i përdorin në media ku paramendohet se i vëzhgojnë shtresa të ndryshme shoqërore dhe nivele intelektuale.

➤ Nga studimi ynë na rezulton se për t'u bërë pjesë e leksikut të shqipfolësve fjala e huaj ndjek disa rrugë si: 1. Shtegtimi i fjalës nga një vend në një tjetër së bashku me sendin a me dukurinë; 2. Gazetarët e shtypit të shkruar e televiziv po përdorin çdo ditë e më shumë fjalë të huaja; 3. Marrëdhëniet e vendit tonë me popujt e tjerë ku shqipja është në kontakt me gjuhë të ndryshme; 4. Bisedat dhe debatet e realizuara në radio dhe TV nga individë që një pjesë të konsiderueshme të leksikut të tyre kanë huazimet e panevojshme; 5. Përkthimet e librave nga përkthyes të cilët janë të paformuar plotësisht nga ana gjuhësore; 6. Folësit që flasin dy a më shumë gjuhë, duke i përzierë sistemet gjuhësore të këtyre gjuhëve me njëra - tjetrën. Gjithashtu na rezultoi se arsyet e përdorimit të huazimeve janë disa, si: 1. Për t'u dukur më të kohës apo modernë; 2. Për t'u paraqitur të barabartë mes bashkëmoshatarëve, kolegëve veçanërisht adoleshentët e të rinjtë; 3. Folësit duan të tregojnë se dinë disa gjuhë të huaja, pra të tregohen superiorë ndaj atyre që nuk kanë këto njohuri; 4. Ndonjëherë i përdorin edhe për të mos u kuptuar nga pjesa tjetër e njerëzve që i rrethon.

➤ Në punim kemi treguar në mënyrë të përmbledhur edhe historikun e huazimeve duke i grupuar në: huazimet para periudhës së rilindjes, huazimet pas periudhës së rilindjes dhe huazimet pas viteve '90. Fjalët prej burimit të huaj, që ndeshen në shqipen e dokumentuar, i kemi ndarë në dy grupe të mëdha: 1. Fjalë prej burimit të huaj që shqipja i ka trashëguar nga "nëna" e saj; 2. Fjalë prej burimit të huaj që shqipja i ka huazuar drejtpërdrejt nga gjuhët e tjera, me të cilat ka pasur marrëdhënie historike. Pra, huazime të vetë shqipes janë vetëm fjalë prej burimit të huaj të grupit të dytë, kurse ato të grupit të parë janë huazime të "nënës" së shqipes dhe si të tilla duhen konsideruar si fjalë të trashëguara, por prej burimit të huaj. Gjatë periudhës së rilindjes u punua fort nga rilindasit për pastrimin e zëvendësimit të fjalëve të huaja me fjalë të shqipes. Pasurimi i leksikut u bë nga rilindasit në dy rrugë: a) Me fjalë "plaka" e të harruara të shqipes, të mbledhura në truallin amtar, disa prej të cilave iu dhanë edhe kuptime të reja; kështu veçoi Sami Frashëri, Naim Frashëri b) Me fjalë të reja të krijuara nga burimi i shqipes; këtë rrugë ndoqi Naum Veqilharxhi, Sami Frashëri, Jani Vreto, Kostandin Kristoforidhi, P. N. Luarasi etj.

➤ Duke pasur parasysh faktin e ngritjes së kulturës gjuhësore, shoqërore e historike, jemi të vetëdijshëm se me zhvillimin e teknologjisë, shumë shprehje dhe huazime i kemi të futura në leksikun tonë të përditshëm, ngase, hë për hë nuk kemi bërë ndonjë zbulim tonin që t'i vëmë emrin këtyre objekteve. Prandaj në gjuhën shqipe nga studimi na rezultoi se huazimet pas viteve '90 kanë hyrë duke iu mbivendosur fjalëve shqipe apo janë rikthyer fjalë të huaja, të cilat prej dekadash nuk përdorehin më, apo ishin zëvendësuar me fjalë shqipe. Edhe nëpër fusha të ndryshme të teknikës

e shkencës janë shtuar huazimet, ku futet sendi apo dukuria, së bashku me emërtimin e gjuhës së vendit që e shpik apo nxjerr.

➤ Shqetësimi i intelektualëve për hyrjen e fjalëve të huaja të panevojshme dhe ndërtimet që nuk i shkojnë përshtat gjuhës shqipe ka qenë i pranishëm gjithmonë. Mendimet e tyre i kemi dhënë përgjatë punimit, por në mënyrë të përmbledhur mund të themi se ata dyzohen në dy kahe: *e para*, nuk duhet penguar vërshimi i çfarëdolloj hyrjeje të re, edhe pse vjen nga vullnetet e veçanta gjuhësore të shqipfolësve, pasi tek e fundit këto prurje janë edhe një shteg pasurimi për shqipen; *së dyti*, qëndrimi konservator, që kërkon ta barazojë gjuhën me një normë të palëvizshme e të mos pranojë asnjë fjalë të huaj. Mendojmë së qëndrimi i duhur dhe më i logjikshëm është qëndrimi i mesëm, sipas të cilit nuk duhen pranuar fjalët e huaja, kuptimi i të cilave mbulohet plotësisht tashmë me fjalë të shqipes, dhe nga ana tjetër nuk duhet të jemi ekstremistë në pastërtinë e gjuhës duke mos pranuar asnjë fjalë të huaj. Pra, duhet të marrim fjalë të huaja që plotësojnë vendet bosh në gjuhën shqipe, por gjithmonë duke i përshtatur me strukturën e gjuhës shqipe dhe nuk duhet të pranojmë fjalë të huaja për të cilat ka gje gjegjëse në shqip.

➤ Nga studimi na ka rezultuar se huazimet janë në numër të konsiderueshëm, prandaj kemi dhënë disa rrugë për ta ngadalësuar këtë dukuri, pasi është e pamundur ta frenojmë plotësisht si p.sh: 1. Media, si pushtetin e katërt dhe një nga rrugët e hyrjes apo përhapjes në masë të gjerë të huazimeve, ta përdorim si një mënyrë për t'u treguar shqipfolësve saktë se si duhet ta flasim e shkruajmë gjuhën tonë, qartë e pastër. Transmetimi i një emisioni televiziv apo radiofonik për çështje të përditshme të gjuhës; 2. Gazetat mund t'i kushtojnë një artikull të veçantë ose një fjalorth ku të tregohet si mund të zëvendësohen huazimet e panevojshme me fjalë shqip. Mendojmë se ndikimi që ka ky fjalorth tek lexuesit do të jetë më i madh tek shtypi i shkruar i përditshëm se tek revista "Gjuha jonë", pasi gazetatat e përditshme kanë një numër më të madh lexuesish; 3. Trajnime të shpeshta të mësuesve që japin mësimin e gjuhës shqipe në arsimin parauniversitar, pasi ata janë një mënyrë e mirë për të dhënë njohuri sa më të sakta të gjuhës shqipe dhe të ngulitjes sa më mirë të saj; 4. T'u kushtohet rëndësi cilësisë së përkthyesve dhe librat që ata përkthejnë. Përkthyesi nuk duhet të dijë vetëm gjuhën e huaj, gjuhën në të cilën është shkruar libri që do të përkthejë, por duhet të ketë edhe njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, të pasurisë së leksikut, të ndërtimeve morfologjike e sintaksore, të frazeologjisë dhe njohuri të mira të rregullave drejtshkrimore; 5. Shteti nga ana tjetër duhet të ndërhyjë duke hartuar ligje më specifike për përdorimin e gjuhës shqipe dhe të caktojë masa disiplinore për shkelësit e këtij ligji.

➤ Prirjen e viteve të fundit të shqipfolësve që përdorin fjalë të huaja si pasojë e faktorëve politiko-shoqërorë e kemi vëzhguar jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e Maqedoni. Gjuhët prej të cilave janë marrë më së shumti huazimet e tri vendeve janë kryesisht nga anglishtja, italishtja dhe më pak nga frëngjishtja. Shembujt me fjalë të huazuara janë dhënë nga gazetatat e tri vendeve të cilat i kemi dhënë edhe në fjali, që të merret më mirë konteksti në të cilin ato janë përdorur. Për secilin shembull

kemi dhënë gjegjësen në shqipe, për të treguar se ato mund të zëvendësohen lehtësisht dhe pa problem, gjë të cilën botuesit e këtyre të përditshmeve nuk kanë parapëlqyer ta bëjnë apo nuk e kanë një ndër kriteret a përparësitë e punës së tyre. Nga vëzhgimet kemi dalë në përfundime se shumica e huazimeve janë nga anglishtja, frëngjishtja e italishtja që është e përbashkët për të tre vendet, por në Kosovë dhe Maqedoni ka një ndikim dhe nga gjuhët me të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm, serbishtja dhe maqedonishtja. Gjithashtu, ka mjaft fjalë të cilat janë të huazuara njëlloj si në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri, si p.sh. *obligim, inspirues, kualitative, vitale, atraktiv, preokupim, posedon, kreativitet* etj., por janë dhe disa të tjera që i kemi hasur tek gazetat e Kosovës e Maqedonisë, të cilat në Shqipëri nuk njihen fare ose shumë pak, si p.sh. *azhurnimin, revidentët, konzorciumet, enorme, deversifikoheshin, ingerencë, demolohet, disperzuara* etj.

➤ Për të vëzhguar se sa i kuptojnë fjalët e huaja shqipfolësit, sa arrijnë t'u gjejnë një gjegjëse në shqipe dhe ku e kanë hasur më shpesh atë, kemi hartuar një pyetësor me 100 fjalë të huaja. Këto fjalë janë përzgjedhur nga fusha të ndryshme, si: jeta e përditshme, sporti, politika, jurisprudenca, mjekësia etj. Pyetësi është plotësuar nga persona të moshave, arsimimeve dhe zonave të ndryshme, banorë aktualisht në qytetin e Tiranës. Duke qenë me origjinë nga vende të ndryshme të Shqipërisë e bën më gjithëpërfshirës pyetësin dhe të dhënat që kemi marrë prej tij. Sipas përfundimeve, del se televizioni dhe bisedat e përditshme zënë vendin më të madh ku përdoren huazimet e panevojshme. Ndikimi më i madh është i televizionit, i cili, për vetë funksionin që ai ka në shoqëri, është edhe një nga burimet kryesore të përhapjes së këtyre fjalëve të huaja, duke i shfaqur si prirje e kohës dhe mjaft tunduese për shikuesin. Se sa arrijnë t'i kuptojnë huazimet shqipfolësit na rezulton se 49 % e personave mbi moshën 35 vjeç dhe 70 % e personave nën moshë 35 vjeç i kuptojnë shumë mirë; Nuk ia dinë kuptimin fjalëve të huazuara 27 % e personave mbi 35 vjeç dhe 8 % e personave nën 35 vjeç; ia dinë kuptimin mirë 24 % e personave mbi 35 vjeç dhe 22 % e personave nën 35 vjeç. Fjalët më pak të njohura për të intervistuarit, të cilave nuk u kanë gjetur një gjegjëse në shqipe janë: *afeksion, strapacim, rilevim, difezë, ospitohet, konfondoje, kredibilitet* etj. Tjetër përfundim i rëndësishëm që na doli nga pyetësi ishte edhe fakti që ata persona, të cilët e kanë përfunduar apo vazhdojnë një arsim të lartë kanë më shumë mundësi për të kuptuar domethënien e këtyre fjalëve kudo që ato përdoren, kurse pjesa tjetër e cila përbën dhe pjesën dërrmuese të shqipfolësve nuk arrijnë t'i kuptojë. Kjo përforcon faktin se përdorimi i fjalëve të huaja vështirësojnë komunikimin.

➤ Sipas zhvillimit që kanë pësuar në gjuhën shqipe, huazimet i kemi grupuar: 1. Fjala e huaj nuk zhvillohet më tej, duke kaluar në periferi të gjuhës ose drejt zhdukjes, 2. Fillimisht fjala e huaj kur futet në gjuhën shqipe ka disa variante shqiptimi, por më pas reduktohen e mbetet vetëm një, 3. Fjala e huaj në gjuhën shqipe është zhvilluar me kalimin e kohës duke krijuar edhe fjalë të tjera, 4. Disa huazime kur futen në gjuhën shqipe pësojnë ndryshime duke iu përshtatur rregullave të saj.

➤ Fjalët e huazuara pësojnë disa ndryshime të kushtëzuara nga gjuha marrëse,

pasi rrugëtimi nëpër të cilin kalojnë fjalët e huazuara nga gjuha dhënëse tek ajo marrëse është i gjatë. Në shqipe huazimet kanë pasur zhvillime të ndryshme në varësi të nevojës që ka patur gjuha për ato fjalë si p.sh. 1. Nëse fjala që futet vjen për të mbushur një hapësirë boshe, 2. Fjala e huazuar del si sinonim me fjalë të burimit të shqipes, 3. Fjala e huaja vjen në një kontekst apo me një kuptim plotësues të fjalëve që janë tashmë ekzistuese në gjuhë.

➤ Huazimet në shqipe kanë depërtuar në të gjitha rrafshet e saj, diku më shumë e diku më pak, si: *fonetikë, leksik, morfologji dhe sintaksë*. *Huazimet fonetike* janë të rralla, sepse nuk kemi huazim të drejtpërdrejtë të fonemave. Deri tani në gjuhën shqipe nuk ka raste të huazimeve fonetike, por ka prirje të tilla. *Huazimet morfologjike* kanë të bëjnë më shumë me huazimet e mjeteve fjalëformuese, si parashtesa e prapashtesa. *Huazimet sintaksore* kanë hyrë në shqipe kryesisht nëpërmjet gjuhës së shkruar. *Leksiku* është rrafshi që preket më shumë nga huazimet dhe shembuj të shumtë i kemi paraqitur gjatë gjithë punimit dhe në fjalësin me fjalë të huazuara. Nga hulumtimi na del se huazimi ka depërtuar edhe në terminologjinë e fushave të ndryshme si: administrativo – juridike, gjuhësore, kulinarisë, sportive, informatike, ekonomike. Për secilën fushë shkencore kemi vjelë terma të huazuar të cilat i kemi paraqitur në fjali për të marrë më mirë kuptimin në të cilin ato janë përdorur. Gjithashtu pas viteve '90 nga studimet na rezulton se 1. Prindërit parapëlqejnë t'u vendosin fëmijëve emrat të huaj dhe emra të cilët nuk përshtaten me fonologjinë e shqipes, pra emra që ndryshe shkruhen dhe ndryshe lexohen; 2. Ndërtime të huaja tek emërtimet në radio dhe televizione dhe emisioneve që ato transmetojnë; 3. Libra të shkruar shqip e të titulluar me fjalë shqip e fjalë të huaja ose vetëm me fjalë në gjuhë të huaj.

➤ Për të hulumtuar nëse po shtohet apo po pakësohet numri i fjalëve të huaja që përdoren nëpër gazeta, kemi vëzhguar dy gazetave të përditshme në vite të ndryshme. Si kampion, kemi marrë gazetën “Tema” të viteve 2000, 2011 dhe gazetën “Shqip” të viteve 2006, 2011. Nga ky vëzhgim na doli se lexuesi shqiptar lexon afërsisht 6 fjalë të huaja për çdo faqe gazete, pa përllogaritur sa herë përsëritet e njëjta fjalë po në atë faqe. Ky numër i madh është shqetësues, sepse jemi të vetëdijshëm se gazetatat janë ndër materialet e shkruara që lexohen më së shumti nga shqipfolësit. Duke u lexuar vazhdimisht, ato bëhen padashur në mënyrë të pavetëdijshme pjesë e leksikut të gjithsecilit. Kjo ndodh, pasi lexuesi shqiptar përqendrohet të kuptojë çfarë informacioni jep gazeta dhe nuk ka prirje t'i shohë me sy kritik huazimet, por i merr si të mirëqena e madje edhe si risi që duhet përvetësuar për të qenë koherent me zhvillimet e fundit. Nga njëra periudhë tek tjetra nuk ka ndonjë diferencë të konsiderueshme, pra nuk kemi shtim të numrit të huazimeve. Çka na lë të mendojmë se jemi në pikën ku shqipja po fillon të bëjë qëndresë ndaj huazimeve.

➤ Në punim kemi hartuar një fjalës me 808 fjalë të huaja të depërtuara në gjuhë në periudha të ndryshme kohore. Ato i kemi parë nëse ndodhen në secilin prej fjalorëve të gjuhës shqipe të viteve 1954, 1980, 2002 dhe 2006. Pjesës më të madhe të fjalëve jemi munduar t'i gjejmë gjegjësen në gjuhën shqipe, të cilën e kemi shkruar përbri fjalës së

huaj. Një pjese tjetër të fjalëve nuk kemi arritur t'i shqipërojmë, prandaj herë i kemi dhënë me shënim shpjegimin që i jep ndonjëri nga fjalorët ku ajo gjendet, e herë e kemi lënë vendin bosh për studime të mëvonshme apo për sugjerime nga studiues të tjerë.

➤ Nga mënyra se si janë reflektuar në fjalorët e viteve 1954, 1980, 2002 dhe 2006 këto huazime i kemi grupuar në: 1. Fjalë, të cilat ndodhen në të katër fjalorët, 2. Fjalë, të cilat ndodhen në të katër fjalorët dhe kanë krijuar çerdhe fjalësh, 3. Fjalë, të cilat ndodhen në të katër fjalorët dhe nuk kanë krijuar çerdhe fjalësh, 4. Fjalë, që nuk ndodhen tek asnjëri nga fjalorët, 5. Fjalë, të cilat nuk ndodhen në asnjë nga fjalorët dhe kanë krijuar çerdhe fjalësh, 6. Fjalë, të cilat nuk ndodhen në asnjë nga fjalorët dhe nuk kanë krijuar çerdhe fjalësh, 7. Fjalë, që nuk ndodhen në fjalorin e vitit 1954, por janë në tre fjalorët e tjerë, 8. Fjalë, të cilat nuk ndodhen në fjalorët e viteve 1954, 1980 dhe 2002, por ndodhen vetëm në fjalorin e vitit 2006, 9. Fjalë, të cilat ndodhen në fjalorin e vitit 1954 dhe 2006, kurse në fjalorët e viteve 1980 dhe 2002 jo, 10. Fjalë të përfshira në fjalorin e vitit 1954, por jo në tre fjalorët e tjerë, 11. Fjalë, të cilat nuk ndodhen tek fjalorët e viteve 1954, 1980, por gjenden tek fjalorët e viteve 2002, 2006, 12. Fjalë, të cilat ndodhen tek fjalorët e viteve 1954, 1980, por nuk gjenden tek fjalorët e viteve 2002, 2006, 13. Fjalë, të cilat nuk kanë një zhvillim të rregull duke u bazuar tek mënyra se në cilin fjalor janë vendosur e në cilin jo, 14. Fjalë me ndryshime të një tingulli nga pasqyrimi në fjalorin e vitit 1954 dhe në fjalorin e vitit 2006, 15. Fjalë me të njëjtën formë, por u ndryshon kuptimi nga një fjalor në tjetrin, 16. Fjalë, të cilat kanë shtuar çerdhen e fjalës ose e kanë pakësuar atë, 17. Fjalë, që u ka ndryshuar numri i kuptimeve nga njëri fjalor tek tjetri, 18. Fjalë, të cilat janë reflektuar ndryshe në fjalorë të ndryshëm. Për secilin grupim kemi dhënë shpjegimin përkatës se pse janë reflektuar në atë mënyrë nëpër fjalorë.

➤ Gjatë studimit vërtetohet se janë futur në gjuhën shqipe tashmë një numër i madh huazimesh. Ky fakt sjell probleme në komunikimin e përditshëm, pasi mesazhi që përcjell folësi nuk shkon plotësisht i qartë tek të gjithë dëgjuesit, kur folësi ndërthur gjuhën shqipe me fjalë të huaja nga disa gjuhë të tjera, të cilat ai i njeh. Ky disnivel është i tillë sa mjaft njerëz shprehin shqetësimin se nuk arrijnë t'i kuptojnë disa të tjerë, të cilët flasin një lloj gjuhe shqipe të pakuptueshme për ta. Pra, mes tyre realizohet akti i folurit, por jo akti i komunikimit, pasi ata nuk arrijnë të kuptohen plotësisht mes tyre.

➤ Në ditët e sotme, me këtë nivel kulturor e arsimor që kanë arritur shqipfolësit, nuk duhet të lejojmë që gjuha shqipe të përzihet kaq shumë me fjalë të huaja, duke deformuar edhe ndërtimet morfologjike e sintaksore të saj. Shumëkujt mund t'i duket normale, meqë gjuha shqipe është gjuhë në kontakt me gjuhët e tjera dhe, si e tillë, mund të marrë fjalë nga këto gjuhë, por marrja e fjalëve nuk duhet të jetë e pakontrollueshme pa kritere, sepse mund të marrim fjalë për të plotësuar hapësirat boshe në gjuhë, por jo t'i dyfishojmë ato. Shqipfolësit duhet të shfrytëzojnë burimet e gjuhës popullore dhe të hedhim një gur në kështjellën e lashtë e të bukur të gjuhës shqipe, duke e pasuruar dhe pastruar, për ta bërë sa më të kohës e t'i përgjigjet kërkesave të sotme.

SHTOJCË 1

1.1 Pamje të përballjes së gjuhës shqipe me gjuhën e huaj në një rrugë të qytetit të Tiranës

Nëpër rrugët e Tiranës dhe jo vetëm, po shohim çdo ditë e më shumë aktivitete private të cilat emërtohen në gjuhë të huaj. Për të parë më saktë se sa emërtime janë në gjuhën shqipe dhe sa në gjuhë të huaj kemi marrë si shembull vëzhgimin e njërës anë të rrugës “Abdyl Frashëri” në qytetin e Tiranës. Mjediset janë të paraqitura me foto me poshtë dhe sipas hulumtimit del se nga 49 mjedise, 31 mjedise janë të emërtuara në gjuhë të huaj, 12 në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj, vetëm 5 janë në shqip dhe 1 është me tri emërtime.

1.1.1 Mjedise të emërtuara në shqip dhe gjuhë të huaj janë:













1.1.2 Mjedise të emërtuara në shqip:



1.1.3 Mjedis i emërtuar në tri mënyra:



1.1.4 Mjedise të emërtuara në gjuhë të huaj:











SHTOJCË 2: Pyetësor

Mosha _____
 Arsimi _____
 Profesionimi _____
 Vendlindja _____
 Vendbanimi _____

Për fjalët e mëposhtme vendosni shenjën + në një rën nga kolonat e tabelës.

Nr.	Fjala	Ç'illoj fjale është?		Ku e keni hasur?						Çfarë kuptoni?			A dini ndonjë fjalë tjetër që mund të përdoret në vend të kësaj fjale?	
		Fjalë e huazuar	Fjalë e gjuhës shqipe	Radio	Television	Gazetë revistë	Në bisedat e përditshme	Tjetër	Mirë	Shumë mirë	Nuk ia dini fare			
1	Agresiv													
2	Atribuojnë													
3	Salutoj													
4	Lancoj													
5	Imazhin													
6	Impakt													
7	Impenjuar													
8	Ingredient													
9	Inicim													
10	Insistoj													
11	Konfrontoj													
12	Dakordim													
13	Konsiston													
14	Obliguar													
15	Oponent													
16	Prezente													

BIBLIOGRAFI A

- Agim Vinca, *Përgjegjësi e shkrimtarit ndaj gjuhës*, Gjuha jonë 1-4, 1997
- Aleksandër Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1956
- Aleksandër Xhuvani, *Vepra 1*, Tiranë 1980
- Ali Jashari, *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Korçë 2007
- Anastas Dodi, *Rreth huazimeve sllave dhe vendit të tyre në gjuhën shqipe*, 1-4, 1995
- Anila Omari, *Fjala e trashëguar dhe huazime*, Gjuha jonë 1, 1989
- Arben Skëndaj, *Huazimi si një dukuri e pashmangshme e shqipes moderne*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Ardian Vehbiu, *Fjalët e huaja, neologjizma dhe ligjërimi*, Gjuha jonë 1, 1986
- Artan Fida, *Disa interference leksikore gjatë nxënies së huazimeve italiane*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Drita Rira, *Të flasësh shqip me fjalë që nuk janë shqip*, Akte të seminarit të 3-të - Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Edmond Tupe, *Fjalë e struktura të huaja: (kundër) veprimi i shqipes*, SF 1-2, 2007
- Edmond Tupe, *Për disa huazime që shprehin gjendje emocionale në shqipen e sotme*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Eliana Paco, *Vështrim i shkurtër i huazimeve në kohë*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Emil Lafe, *Gjuha e medias sot – Probleme dhe detyra*, Gjuha jonë 1, 2000
- Emil Lafe, *Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë*, SF 4, 1984
- Emil Lafe, *Mbi mjeshtërinë e gjuhës*, Vepra 1, Tiranë 1980
- Emil Lafe, *Pastërtia e gjuhës në kohën tonë si detyrë gjuhësore dhe kombëtare*, Gjuha jonë 3-4, 1992
- Emil Lafe, *Vendi i orientalizmave ndër huazimet e shqipes*, SF 1-4, 1993
- Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, Gjuha jonë 1, 1981
- Fjalor i gjuhë shqipe* 1954
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* 1980
- Fjalor i gjuhës shqipe* 2006
- Fjalor i shqipes së sotme* 2002
- Giovanni Belluscio, Shezai Rrokaj, *Fjalor me terma të gjuhësisë*, Tiranë 2011
- Gjovalin Shkurtaj, *Drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi në mediat e sotme të shkruara dhe të folme*, Gjuha jonë 1, Tiranë 2000
- Gjovalin Shkurtaj, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës shqipe*, Tiranë 2003

- Gjovalin Shkurtaç, *Kultura e gjuhës*, Tiranë 2006
- Gjovalin Shkurtaç, *Normëshkelësit duhet të përgjigjen për dëmin që i shkaktajnë gjuhës shqipe*, Aktet e Konferencës Shkencore- Zbatimi i kulturës gjuhëore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, Tiranë
- Gjovalin Shkurtaç, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë 2008
- Gjovalin Shkurtaç, *Shqipja e sotme*, Tiranë 2010
- Gjovalin Shkurtaç, *Të ndajmë mirë huazimet nga fjalët e huaja të panevojshme* (leksion)
- Gjovalin Shkurtaç, *Trysnia e huaj dhe qëndresa e shqipes*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë, Gjuha jonë 1, 1990
- Hajri Shehu, *Mbi zëvendësimin e disa huazimeve angleze*, Gjuha jonë 1, 1989
- Hajri Shehu, *Rreth anglicizmave në mjetet e informimit masiv*, SF 3-4, 2002
- Hëna Pasho, *Probleme të terminologjisë tekniko – shkencore në gjuhën e shtypit dhe të radiotelevizionit*, Gjuha jonë 1, 2000
- Isa Bajçinca, *Probleme të shqipes së sotme letrare vështruar në aspektin teorik e të zbatimit në praktikë*, Gjuha jonë, 1-4, 1993
- Ištva Shütz, *Liberalizim apo ndërhyrje në zhvillimin e gjuhës, Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë 2003
- Jani Thomai, *Për pastërtinë e fjalorit të gjuhës sonë letrare*, Gjuha jonë 1-4, 1998
- Jani Thomai, *Veçori të përdorimit të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Gjuha jonë 2, 1981
- John Lyons, *Hyrje në gjuhësinë teorike*, Tiranë 2001
- Jorgo Bulo, *Gjuha e Naimit: E tashmja dhe e ardhmja e shqipes*, Gjuha jonë 1-4, 1997
- Josif Kole, *Mbi fjalët ndërkombëtare të gjuhës shqipe*, SF 3, 1984
- Jup Kastrati, *Naim Frashëri për gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 3-4, 2000
- Kristian Monteko, *Neologjizmat e fjalorit profesional të gazetarëve shqiptarë*, Gjuha jonë 3-4, 1999
- Kristina Jorgaqi, *Mbi integrimin leksiko-semantik të italianizmave në shqipen standarde*, SF 1-2, 1998
- Kristina Jorgaqi, *Rreth përshtatjes morfologjike të huazimeve italiane në shqipen standarde*, SF 1-4, 1997
- Kristina Jorgaqi, *Sportel i hapur i shqipes*, Tiranë 2008.
- Kristina Jorgaqi, *Sprovë për identifikimin e huazimeve leksikore italiane në shqipen e sotme letrare*, SF 1-4, 1992
- Ledi Shamku, *Standard dhe neostandard*, Tiranë 2007
- Lindita Latifi, *Mbi huazimet turke në gjuhën shqipe krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit*, Tiranë 2006

- Luan Babameto, *Ta mbrojmë e pasurojmë gjuhën tonë*, Tiranë 2008
- Mehmet Çeliku, *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë 2001
- Mehmet Çeliku, *Për pastërtinë e shqipes dhe fjalët e huaja në përdorim*, Aktet e Konferencës Shkencore- Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, Tiranë
- Miço Samara, *Historia e gjuhës letrare shqiptare*, Tiranë 2000
- Mirela Papa, *Huazimet në fushën e ekonomisë*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Mustafa Ibrahim, *Krijimi i neologjizmave në gjuhën shqipe gjatë tranzicionit demokratik*, Aktet Vëllimi V, Nr. 4, Shkup 2012
- Nikollë Topalli, *Për mënjanimin e ndikimit të huaj në fjalëformimet prapashtesore*, Gjuha jonë 2, 1989
- Nikollë Topalli, *Për zëvendësimin e ndërtimeve të huaja në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 4, 1986
- Qemal Murati, *Shqipja përballë gjuhëve të huaja të tjera evropiane e rajonale-huazime leksikore dhe strukturore*, Aktet e Konferencës Shkencore- Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, Tiranë
- Raul Lilo, *Vëzhgime rreth leksikut të sotëm politiko-shoqëror*, Gjuha jonë 1-2, 1992
- Raul Lilo, *Vëzhgime rreth tipologjisë së huazimeve në shqipen e sotme*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Rexhep Qosja, *Kongresi i drejtshkrimit – tridhjetë vjet pas, shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë 2003
- Sala Ahmetaj-Çitaku, *Gjuha standarde dhe strategjia kombëtare*, Gjuha jonë 3-4, 2003
- Seit Mansaku, *Rreth elementeve të greqishtes së vjetër në gjuhën shqipe*, SF 1-4, 1996
- Seit Mansaku, *Rreth pasurimit dhe përsosjes së strukturës sintaksore të shqipes së sotme*, Gjuha jonë 1, 2000
- Silvana Vishkurti, *Përdorimi i huazimeve në reklamë. Roli dhe rëndësia e tyre*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.
- Sofia Delijorgji, *Pasqyrimi leksikografik i huazimeve greke në gjuhën shqipe*, Kërkime gjuhësore, Konferencë shkencore ndërkombëtare, 31 maj 2012, Tiranë.
- Shaban Demiraj, *A ka ndikime të huaja në strukturën morfologjike të shqipes*, Gjuha jonë 2, 1981
- Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, SHBLU, Tiranë 1988
- Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Tiranë 2007
- Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe 3*, Tiranë 2014
- Shezai Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe*, Tiranë

Shezai Rrokaj, *Disa parime teorike lidhur me dukurinë e huazimit*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.

Shezai Rrokaj, *Dy çështje për mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollë*, Aktet e Konferencës Shkencore- Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, Tiranë

Shezai Rrokaj, *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Tiranë 2005

Shezai Rrokaj, *Përse përdorim fjalën e huaj në vend të fjalës shqipe*, 23 tetor, gazeta “Panorama”

Valter Memisha, *Gjuha shqipe dhe gjuhësia sot*: Dukuri dhe sfida, Seminari VI Ndërkombëtar i Albanologjisë, Çështja shqiptare para dhe pas shpalljes së pavarësisë 20-22 shtator, Tetovë 2002

Vesel Nuhiu, *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2013

Viktor Ristani, *Kritika përkthimore dhe pastërtia e gjuhës*, Aktet e Konferencës Shkencore - Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, 16 dhjetor 2004, Tiranë

Viktor Bakillari, *Prurje frënge në shqip*, Akte të seminarit të 3-të – Rreth huazimeve në shqipen standarde, 29 prill 2004, Tiranë.

Xheladin Zymberaj, *Shqipja standarde dhe pastrimi i saj nga fjalët e huaja*, Konferenca vjetore kombëtare e shkencës “Java shkencore”, 2011, Prishtinë

Xhelal Ylli, *Ndihmesë për inventarin e huazimeve leksikore sllave të gjuhës shqipe*, SF 1, 1991

Xhelal Ylli, *Rreth vendit të sllavizmave në gjuhën letrare shqipe*, Gjuha jonë 3, 1990

Xhevat Lloshi, *Shqipja- gjuhë e hapur dhe dinamike, Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Tiranë 2003

Zarije Nuredini, Sindorela Doli-Kryeziu, Shpresa Dorda, *Ndikimet ndërgjuhësore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni*, Konferencë Ndërkombëtare “Kërkime gjuhësore”, 4 korrik, Tiranë 2013

LITERATURA E VJELJES SË HUAZIMEVE

- Gazeta “*Bota sot*”, 15 qershor 2012, Prishtinë
Gazeta “*Express*”, 15 qershor 2012, Prishtinë
Gazeta “*Koha*”, 31 gusht 2012, Shkup
Gazeta “*Lajm*”, 31 gusht 2012, Shkup
Gazeta “*Panorama*”, 23 tetor 2013, Tiranë
Gazeta “*Panorama*”, 25 korrik 2012, Tiranë
Gazeta “*Shqip*”, 14 qershor 2012, Tiranë
Gazeta “*Shqip*”, 25 qershor 2006, Tiranë
Gazeta “*Shqip*”, 25 qershor 2011, Tiranë
Gazeta “*Tema*”, 18-25 qershor 2000, Tiranë
Gazeta “*Tema*”, 23 qershor 2000, Tiranë
Gazeta “*Zhurnal*”, 31 gusht 2012, Shkup
Gazeta, “*Ekonomia*”, 29 tetor 2014, Tiranë
Gazeta, “*Ekonomia*”, 31 tetor 2014, Tiranë
Gazeta, “*Panorama sport*”, 26 dhjetor 2013, Tiranë
Gazeta, “*Panorama*”, 25 dhjetor 2013, Tiranë
Kodi penal – I përditësuar me praktikë gjyqësore, Tiranë 2009
Kodi civil, Tiranë 2010, *Kodi i procedurës administrative*, Tiranë 2009
Kodi i procedurës civile, Tiranë 2007
Kodi i procedurës penale, Tiranë 2012
Kodi i familjes dhe legjislacioni për birësimet, Tiranë 2007
Giovanni Belluscio, Shezai Rrokaj, *Fjalor me terma të gjuhësisë*, Tiranë 2011.
Lediana Bardhi, Anduela Lile, *Informatika 8*, Tiranë 2012
Lediana Bardhi, Anduela Lile, *Informatika 9*, Tiranë 2012
Vangjel Kullaj, Miço Garuli, *Arti i të gatuarit*, Tiranë 1998
Kosta Koçi, *Arti i pastiçerisë*, Tiranë 2005
Fjalor, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë 1998

Përmbledhje

Në këtë punim synuam të bëjmë një përbledhje të huazimeve të cilat janë futur në shqipe në periudha të ndryshme kohore, por pjesën më të madhe të studimit e kanë zënë huazimet që janë futur pas viteve '90. Shtysa për përzgjedhjen e kësaj teme ka qenë evidentimi çdo ditë e më shumë i huazimeve të panevojshme në komunikimin e përditshëm. Identifikimin e fjalëve të huaja e kemi bërë nga media e shkruar, radiofonike, televizive dhe komunikimi mes shqipfolësve. Në studim kemi vëzhguar edhe zhvillimin që huazimet kanë pësuar me kalimin e viteve, cilat prej tyre kanë krijuar çerdhe fjalësh, cilat nuk janë zhvilluar më tej, cilat janë futur të reja e cilat janë rikthyer në gjuhë pas disa dekadash të shmangura prej saj. Nga ana tjetër kemi vënë në dukje gjuhët dhënëse të fjalëve të huaja, që kanë depërtuar më shumë, si ka reaguar gjuha shqipe ndaj tyre, cilët faktorë favorizojnë shtimin e fjalëve të huaja në shqipe dhe rrugët që mund të ndjekim për t'i minimizuar prurjet e reja dhe zëvendësimin e huazimeve ekzistuese, qëndrimet e gjuhëtarëve ndaj huazimeve dhe disa fusha ku kanë depërtuar huazimet. Gjithashtu kemi bërë krahasimin e huazimeve në gjuhën shqipe duke vëzhguar si janë reflektuar në fjalorët e viteve 1954, 1980, 2000, 2006 dhe i kemi grupuar duke dhënë shpjegimin për mënyrë e pranisë apo jo tek secili fjalor. Në punim kemi përdorur disa metodat si: hulumtimi i studimeve të mëparshme për huazimet, anketime, vëzhgime dhe interpretime. Jemi përpjekur të sjellim një pasqyrë sa më të qartë të huazimeve në gjuhën shqipe ku metoda mbizotëruese është ajo e hulumtimit dhe vjeljes së huazimeve, ndërsa një vend me rëndësi në trajtimin e kësaj teme ka zënë edhe metoda e anketimit/pyetësorit rreth shtrirjes dhe ndikimit të huazimeve në shqipe.

Fjalë kyç: Huazim, leksik, çerdhe fjalësh, fjalor, gjuhë shqipe, fjalë, gjuhësi, leksikografi, klasifikim.

Abstract

In this paper work we aimed to collect the borrowings which have entered in the Albanian language in different periods of time but the greatest part of the study is about the loanwords introduced after the 90'. The incentive for the selection of this topic was the identification of unnecessary loanwords in everyday communication. We did the identification of loanwords from the written media, radio, television and communication among Albanian speakers.

In this study we have observed also the development of these loanwords in years, which ones have created clusters (group of words), which ones did not develop further, which are new and which were returned in language after decades.

On the other hand we have noticed the loan languages of the borrowings, that have penetrated more, how the Albanian language has reacted to loanwords, which factors favour the increase of loanwords in the Albanian language and the ways to be followed to minimize the new influx and the replacement of existing borrowings, the attitudes of linguists and some fields where the these borrowings have penetrated. Furthermore we have done the comparison of loanwords in the Albanian language observing the reflection in the dictionaries of 1954, 1980, 2000, 2006 and we have grouped them explaining their presence in each dictionary.

In this paperwork we have used some methods, such as: previous research studies for loanwords, observations and interpretations. We tried to bring a clear panorama of the borrowings in the Albanian language where the dominant method is that of the research and collection of loanwords, while an important place in the treatment of this theme was also the survey/ questionnaire method regarding the extension and influence of loanwords in the Albanian language.

Key words: borrowing, lexicon, cluster (group of words), dictionary, Albanian language, word, linguistics, lexicography, classification.